

**UNIVERSITETI I TIRANËS**

**INSTITUTI I STUDIMEVE EVROPIANE**

**MARRËDHËNIE NDËRKOMBËTARE DHE DIPLOMACI**



***Zhvillimet politiko-diplomatike në ish-Jugosllavi me  
theks të veçantë Kosova dhe Maqedonia 1981-2008***

**DIPLOMANTI**

**UDHËHEQËSI SHKENCOR**

**ISAK SHERIFI**

**Prof.asc.dr. EVA HYSKAJ-TAFILI**

**TIRANË, 2013**

## ***Mirënjohja***

*Tema e doktoratës me titull “Zhvillimet politiko-diplomatike në ish-Jugosllavi me theks të veçantë Kosova dhe Maqedonia 1981-2008” është e punuar nën mbikqyrjen e Prof. e asociuar Eva Hyskaj-Tafili. Shfrytëzoj rastin që të shpreh mirënjohjen time të thellë për përkrahjen, durimin dhe ndihmesën e dhënë nga ana e profesoreshës Eva Hyskaj, poashtu i falemenderoj edhe anëtarët e komisionit që e bënë të mundur ky punim të dal në pah.*

*Mirënjohjen time poashtu i’a dedikoj familjes time për përkrahjen e dhënë dhe durimit që patën gjatë përgaditjes së temës.*

## **PËRMBAJTJA**

ZHVILLIMET POLITIKO-DIPLOMATIKE NË ISH-JUGOSLLAVI ME THEKS TË  
VEÇANTË KOSOVA DHE MAQEDONIA 1981-2008

SHKURTESAT

ABSTRAKTI

ABSTRAKT

HYRJE

**KAPITULLI I..... 16**

POZITA JURIDIKO-KUSHTETUESE E VITIT 1980..... 16

*1.1. Kosova në prag të demonstratave të vitit 1981..... 17*

*1.2. Demonstratat e studentëve të vitit 1981..... 18*

*1.3. Qëndrimet negative ndaj kërkesave të shqiptarëve nga pushteti Jugosllav..... 19*

*1.4. Diferencimi ideo-politik në Kosovë..... 20*

*1.5. Shtypi i brendshëm dhe i jashtëm mbi ngjarjet e 1981 ..... 24*

*1.6. Mërgata shqiptare në përkrahje të demonstratave të vitit 1981..... 26*

*1.7. Organizimi i lëvizjes shqiptare në Jugosllavi shtytje drejt shpërbërjes..... 28*

*1.8. Ngjarjet në Kosovë 1989-1990..... 29*

*1.9. Shtypi evro-perëndimor për ngjarjet në ish-Jugosllavi-Kosovë..... 31*

*1.10. Reflektimi i ngjarjeve të Kosovës në Maqedoni..... 35*

*1.11. Shpallja e Kosovës Republikë e pavarur..... 42*

*1.12. Deklarata Kushtetuese..... 43*

*1.13. Prezenca e diplomacisë ndërkombëtare në Kosovë..... 46*

*1.14. Konferencat ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë..... 50*

<b>KAPITULLI I II.....</b>	<b>52</b>
SHKAQET E SHPËRBËRJES SË JUGOSLLAVISË - LUFTA NË SLLOVENI, KROACI DHE BOSNJË .....	52
2.1. <i>Shpallja e pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë.....</i>	53
2.2. <i>Lufta në Bosnjë.....</i>	57
2.3. <i>Marrëveshja e Dejtonit.....</i>	59
<b>KAPITULLI I III.....</b>	<b>63</b>
MAQEDONIA DHE POZITA E POPULLIT SHQIPTARË.....	63
3.1. <i>Historiku i shkurtër i demokratizimit të Maqedonisë.....</i>	64
3.2. <i>Referendumi për pavarësinë e Republikës së Maqedonisë.....</i>	72
3.3. <i>Shpallja e pavarësisë së Maqedonisë dhe njohja ndërkombëtare e saj.....</i>	74
3.4. <i>Opcioni alternativ i shqiptarëve të Maqedonisë (Referendumi).....</i>	76
3.5. <i>Faktori politik shqiptarë në periudhën 1997-1998.....</i>	80
3.6. <i>Formacioni ushtarak (Ushtria Çlirimtare Kombëtare) .....</i>	81
<b>KAPITULLI IV.....</b>	<b>87</b>
KOSOVA NË PERIUDHËN 1998-1999-UÇK-JA.....	87
4.1. <i>Organizimi i shqiptarëve dhe lufta e tyre e armatosur.....</i>	88
4.2. <i>Konferenca e Rambujesë- Konferenca e parë ndërkombëtare për Kosovën.....</i>	93
4.3. <i>Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë.....</i>	109
4.4. <i>Tërheqja e forcave serbe (Marrëveshja e Kumanovës).....</i>	113

<b>KAPITULLI V.....</b>	<b>116</b>
KOSOVA NËN ADMINISTRIMIN NDËRKOMBËTAR.....	116
5.1. <i>Administrimi ndërkombëtar i Kosovës.....</i>	117
5.2. <i>Negociatat për statusin final.....</i>	119
5.3. <i>Shpallja e Pavarësisë.....</i>	124
5.4. <i>Deklarata e pavarësisë.....</i>	125
5.5. <i>Njohjet e para.....</i>	128
KONKLUZAT PËRFUNDIMTARE.....	129
LITERATURA.....	131
SHTYPI I KOHËS.....	134

## **Shkurtesat**

**RSFJ**-Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë

**LPK**-Lëvizja Popullore e Kosovës

**CIA**-Shërbimi Inteligent Amerikan

**TMK**-Trupat Mbrojtës të Kosovës

**FSK**-Forcat e Sigurisë së Kosovës

**BDK**-Bashkimi Demokrat Kroat

**OKB**- Organizata e Kombeve të Bashkuara

**KFOR**-Forcat Ndërkombëtare të Sigurisë në Kosovë

**UNMIK**- Unitet Nation Mission in Kosovo

**KS**-Këshilli i Sigurimit

**PE**- Parlamenti Evropian

**BE**- Bashkimi Evropian

**OSBE**-Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë

**NATO**-North Atlantic Treaty Organization (Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior)

**EULEX**-European Union Rule of Law Mission in Kosovo

**AP**-Asambleja e Përgjithshme

**PSSP**- Përfaqësuesi Special i Sekretariatit të Përgjithshëm

## **Abstrakt**

Ky punim doktrate përmban një përmbledhje, kronologji dhe analizë të gjithë procesit që ka përshkuar Jugosllavinë me theks të veçantë Kosovën në periudhën prej demonstratave të vitit 1981 e deri tek shpallja e pavarësisë, më 17 shkurt 2008.

Fokusi i analizës studimore të këtij punimi është shpallja e pavarësisë së Republikave që ishin në kuadër të Jugosllavisë dhe si rrjedhojë kontestimi i saj nga ana e Serbisë substancë kjo që ka bërë Kosova të jetë pikë referuese si çështje aktuale e të Drejtës Ndërkombëtare.

Në gjeopolitikën e kohës dhe të historiografisë, Kosova shpërtheu si një pikë neuralgjike, ku ndërthureshin interesa të shumta rajonale e Evropiane por edhe më gjërë. Konferenca e Rambujesë e pasuar më vonë nga marrëveshja e Parisit e futën Kosovën drejt zgjidhjes së re të saj e që u kurorëzua me intervenimin e NATO-s edhe me krijimin e institucioneve të para të pasluftës. Periudha e pas luftës ishte një sakrificë plus për Kosovën dhe Institucionet e saj. Ishte periudhë që me shumë mençuri duhej pregatitur terrenin për të sendërtuar idealin e gjeneratave të shumta, atë të bërjes së Kosovës shtet.

## **Abstract**

This PHD paper contains a summary, chronology and analysis of the entire process that has traversed Yugoslavia and particularly Kosovo on the period from 1981 demonstrations up to its declaration of independence on 17 February 2008.

The focus of the analysis of this paper is to study the declaration of independence of the Republics that were part of Yugoslavia and as a result its contestation by Serbia a substance that has made Kosovo a reference point as a current issue of International Law. In geopolitical time and historiography, Kosovo exploded as a neuralgic point where numerous regional and European interests were related but also wider. Rambouillet Conference, followed later by the Paris Agreement of Kosovo towards into its new solution which culminated with NATO's intervention and the creation of the first post-war institutions.

The period after the war was a plus sacrifice for Kosovo and its institutions. It was a period that wisely the ground should be prepared to rebuild the ideal of many generations, of making Kosovo a state.



## **ARSYETIMI I PROPOZIM – TEZËS**

### **1. Lënda e hulumtimit**

Lënda e hulumtimit në këtë projekt shkencor është procesi i shpërbërjes së federatës jugosllave më theks të veçantë fati i Kosovës dhe i Republikave të tjera në këtë proces të shpërbërjes. Në kuadër të kësaj do të hulumtohet periudha kohore prej vitit 1981 e deri në shpalljen e pavarësisë më 17 shkurt 2008. Punimi do të realizohet nëpërmjet një kronologjie të ngjarjeve që pasuan këtë periudhë kohore, të mbështetur në përvojat e bartësve të këtij procesi politik historik për Kosovën të cilët fatmirësisht janë gjallë dhe po e ndërtojnë Kosovën e pavarur.

### **2. Qëllimet e hulumtimit**

Qëllimi i hulumtimit konsiston në përcaktimin e të drejtës së Kosovës për vet-përcaktimin politik të së ardhmes së vet në rrethanat e shpërbërjes së shtetit të përbashkët Jugosllav. Qëllimet hulumtuese konsideroj se u janë nënshtruar normave hulumtuese primare dhe sekondare për hartim të Tezës në fjalë.

### **Hipoteza e përgjithshme**

Ka të bëjnë me legjitimitetin e luftës politike dhe ushtarake të Kosovës në përcaktimin e fatit politik shtetëformues në kuadër të shpërbërjes së federatës Jugosllave. Të mbështetura në studime të dimensioneve akademike dhe me peshë faktike të pamohueshme.

**• Legjitimiteti i luftës së Kosovës për shtet të pavarur, në kuadër të procesit të shpërbërjes së federatës Jugosllave.**

## **Hipotezat e veçanta**

Janë të lidhura ngushtë me lëndën e hulumtimit dhe me hipotezën e përgjithshme. Hipoteza të veçanta të këtij hulumtimi janë:

- **Vitet e thellimit të krizës 1989.**
- **Luftërat në Slloveni, Bosnjë dhe Kroaci.**
- **Shpallja e pavarësisë së Maqedonisë**
- **Formimi i partive politike ne Maqedoni**

Hipotezat e veçanta veç e veç ndihmojnë dhe njëkohësisht miratojnë njëra tjetrën me një saktësi që qëndron ndaj kritikës krahasuese të ngjarjeve të hulumtuara në projektin shkencorë.

Meqë niveli i analizës është një parakusht themelor për analizën dhe sqarimin e hipotezës së përgjithshme dhe të veçante do të ja bashkëngjis edhe hipotezat ndihmese në vijim:

## **Hipotezat ndihmëse**

- **Demonstratat e pranverës së vitit 1981**
- **Lindja e lëvizjes paqësore dhe subjekteve politike në Kosovë**
- **Luftërat në trojet e ish Jugosllavisë**
- **Reflektimi i ngjarjeve në Republikën e Maqedonisë**
- **Lufta e UÇK-së dhe sensibilizimi ndërkombëtarë**
- **Intervenimi i NATO-s dhe rezoluta 1244**
- **Pavarësia e Kosovës dhe njohja ndërkombëtare e saj.**

#### **4 Mënyra e hulumtimit – metodologjia e hulumtimit**

Gjatë punës hulumtuese mbi objektin e studimit kryesisht do të përdorim metodat standarde të përgjithshme shkencore-kërkimore dhe ato hulumtuese.

Zgjedhja e metodave është bërë në bashkëpunim të ngushtë me Mentorin si dhe në konsultim me profesorë të lëmisë së hulumtimit. **Metodat që kam praktikuar janë si vijon më poshtë:**

**Metodën e intervistimit** – me anë të kësaj metode do të bëj mbledhjen e kujtimeve dhe protagonistëve sidomos atyre që kanë kontribuar për çështjen në fjalë për këtë periudhë kohore.

**Metodën e analizës**- me anë të së cilës do të bëj analiza të të dhënave të shfrytëzuara edhe atë; të dhënat arkivore, literatura dhe relevanca e saj, analize koncize të të dhënave të cilat do të fitohen nga intervistat e tjera.

**Metodën komparative** – do të shërbejë për të paraqitur rrethanat e paraqitjes së krizave si dhe mundësi për të bërë krahasimin e mënyrave të intervenimit, bashkëpunimit në ndërtimin dhe zhvillimin e proceseve në zgjidhjen e statusit të Kosovës nëpërmjet konferencave të ndryshme të organizuara nga ana e Bashkësisë ndërkombëtare.

Përdorimi i këtyre metodave është i dobishëm për arritjen e cilësive të larta shkencore, për gjurmimin e dokumentacionit, fakteve, ideve, argumenteve etj. Me metodat e lartpërmendura do të mund të futemi në problemet e veprës, të hulumtojmë objektin dhe të pasqyrojmë rezultate objektive dhe shkencore.

## **5 Rëndësia e punimit të temës**

Tërësia e arsyes që e ka ngërthyer vendimin mbi përcaktimin e kësaj teme, para se gjithash është se kjo temë është e rëndësishë së veçantë dhe në vete ngërthenë zhvillime komplekse të jashtëzakonshme. Kosova vazhdimisht në agjendën e ngjarjeve të rëndësishme të gjeopolitikës botërore vazhdon të jetë në mënyrë konstante një temë e nxehtë. Kjo gjeopolitikë, apo ky interesim për Kosovën i ka rrënjët e veta që nga kohërat e mëhershme, nga atëherë kur edhe konflikti për ta sunduar Kosovën kishte marrë përmasa botërore.

Si asnjëherë më parë, nën kthetrat pushtuese të agresorëve Kosova nuk është ndier keq dhe ngushtë ashtu sikur nën pushtimin e krijesës së quajtur Jugosllavi. Këtu me theks të veçantë do të trajtojmë edhe shpalljen e pavarësisë së Republikave tjera të ish- Jugosllavisë si dhe marrëdhëniet e tyre me shtetet fqinje. Tema në fjalë do të shtjellojë edhe daljen në sipërfaqe të çështjes së pazgjidhur të Kosovës duke përshkuar gjerësisht kohërat dhe ngjarjet politike e ushtarake deri tek akti i shpalljes së Pavarësisë së saj. Këto ngjarje në këtë studim na vijnë më gjuhën hulumtuese të emrave të njohur dhe të nderuar me peshë.

Çështja që trajton kjo temë është në interes të përgjithshëm shkencorë, shoqëror dhe kombëtarë. Arritja e rezultateve të punës dhe konkretizimi i materies hulumtuese shkencore, shpresojmë se do të japin njohuri më të sakta mbi rrugëtimin e Kosovës në mes viteve 1981 - 2008. Të njëjtat do t'i kontribuojnë shkencës në përgjithësi si dhe lëmisë përkatëse në veçanti .

## Hyrje

Viti 1981 është dhe do të mbetet pikënisja më determinante e periudhës kur shqiptarët definitivisht nisën rrugëtimin e ndarjes politike nga krijesa artificiale e ashtuquajtur Jugosllavi edhe pse kjo periudhë nuk ishte aspak e lehtë. Këtë e dëshmojnë shumë kronika të kohës së asaj periudhë e gjer më tani kur vazhdojnë të dalin në shesh njohje të reja për ato kohëra. Viti 1981 do të ndante definitivisht mendjen tek shqiptarët se mund të ketë liri dhe barazi për këtë popull nën një çati me shtetin fantom Jugosllavi. Organizimet e lëvizjeve shqiptare do të merrnin hov si kurrnjëherë më parë. Periudha e pas vitit 1981 do të njihet nga historiografia shqiptare, si periudha kur Lëvizja Ilegale në Kosovë do të bëjë përpjekje të shumta dhe do të organizohet që t'i bëjë ballë pushtimit dhe njëkohësisht të përgatis popullin shqiptar për çlirim nga pushtuesi. Këto ngjarje bënë që gazetatat dhe televizionet më me relevance botërore të merreshin intenzivisht trajtimin e tyre. Këto medime, dhe jo vetëm këto, por edhe politika perëndimore tanimë po tregonte fillet e reja të një qasjeje krejt të re ndaj shqiptarëve, Kosovës dhe në tërësi Jugosllavisë. Një situatë e tillë zgjati deri në vitin 1981, atëherë kur në Kosovë shpërtheu revolta e studentëve kosovarë e cila kishte për qëllim avancimin e pozitës juridiko-kushtetuese të Kosovës, që me fjalë të tjera do të thotë autonomi më të madhe nga Serbia, gjë që më vonë do ti jepte mundësi popullit të Kosovës edhe të drejtën e vetëvendosjes. Në dokumentet sekrete të CIA-së këto ngjarje do të zënë vend mjaft të konsiderueshëm, ngjarjet e sipërpërmendura në skenën politike do të zënë vend të rëndësishëm. Ngjarjet që pasuan më vonë shkaktuan procese retrograde të cilat u percollën me masa drakonike kundër rinisë kosovare, intelektualëve dhe në përgjithësi kundër popullit shqiptar të Kosovës. Këto ngjarje hasën në jehonën ndërkombëtare, shtypi ju kushtoi vëmendje të posaçme. Situata e këtillë do të përkeqësohet prej vitit në vit, deri në vitin 1989-1990, atëherë kur kriza politiko-shoqërore arriti kulmin, të cilën e ndjenë edhe popujt tjerë në Jugosllavi, në radhë të parë sllovenët, kroatët etj. Pikërisht në këto vite do të ndodhin reforma të mëdha edhe në vendet tjera të Evropës Qendrore dhe Lindore, me çka ra i tërë sistemi komunist. Rënia e diktaturave komuniste dhe dalja në skenë e sistemit me shumë parti, si dhe shthurja e Jugosllavisë do ti jepte mundësi edhe Kosovës të angazhohet jo vetëm për autonomi,

por tani më edhe për pavarësi të plotë, gjë që do të arrihet pak më vonë nga disa njësi tjera të Federatës Jugosllave.

Mirëpo edhe kjo pozitë hibride kushtetuese e Kosovës u kundërshtua nga Serbia dhe u ndryshua në vitin 1990. Zhvillimi i ngjarjeve në Kroaci dhe Slloveni e përshpejtoi shpërbërjen e Jugosllavisë, udhëheqja e ushtrisë Jugosllave e cila mbante anën e serbëve duke mos pasur rrugdalje tjetër u detyrua së pari të tërhiqet nga Sllovenia e pavarur duke u implikuar më pas me luftën e Kroacisë dhe të Bosnjë dhe Hercegovinës. Maqedonia poashtu ishte njëra nga këto njësi Federale e njohur brenda kufijve të Jugosllavisë socialiste e cila zhvillonte politikë joparimore. Shqiptarët në Maqedoni me 11 dhe 12 janar të vitit 1992 organizuan referendum për autonomi politike, territoriale edhe pse kjo nuk arriti të implementohet në praktikë. Me këto hapa të shqiptarëve u njoftuan qarqet ndërkombëtare me anë të një memorandumit komisionit të Arbitrazhit që vepronte në kuader të BE-së ku njohja e Maqedonisë të kushtëzohet me zgjedhjen e statusit të shqiptarëve. Me fillimin e konfliktit të armatosur në republikat tjera Maqedonia luante lojën e politikës së qarqeve nacionaliste serbe në formën e oazës së paqes që trumbetonte udhëheqja politike e Maqedonisë. Edhe në Maqedoni u formuan shumë parti politike. Zhvillimeve politike në ish-Jugosllavi i parapriu mbajtja e kongresit të XIV –të në të cilin u shpreh haptas qëndrimi Slloven dhe Kroat kundër politikës së Beogradit, filluan kontradiktat udhëheqëse të cilat kulmuan me shpalljen e pavarësisë së republikave dhe daljen në sipërfaqe të konflikteve në federatën Jugosllave.

Në procesin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë, Kosova reagoi në mënyrën e vet; shpalli pavarësinë (1990-1991), miratoi Deklaratën e Pavarësisë më 2 Korrik e cila u kontestua dhe nuk u njoh ndërkombëtarisht, por këtë akt e njohu vetëm Shqipëria. Sado fiktiv që ishte ky akt këto ngjarje sollën frymën e mobilizimit dhe vetbesimit tek popullata shumicë e Kosovës. Pas zhbërjes së federatës dhe pas zgjedhjeve për organet e Republikës së Kosovës (1992), pavarësisht kontestit që iu bë atyre, konflikti shqiptaro-serb mori përmasa të reja. Duke thyer kufijtë “çështje e brendshme e Serbisë” dhe duke marrë edhe karakter ndërkombëtar, shtimi i prezencës së diplomacisë ndërkombëtare në Kosovë, hartimin e shumë rezolutave, në veçanti diplomacia amerikane, do të ndikojë në fuqizimin e propagandës rreth statusit të Kosovës në ish federatën Jugosllave.

Gjithnjë e më shumë bëhej e qartë se, ndonëse organikisht e ndërlidhur dhe me dimensione të tjera, çështja e Kosovës objektivisht nuk do të mund të zgjidhej pa eliminimin e kornizës, në të

cilën gjendej motivimi i veprimtarisë represive të pushtetit serb ndaj shqiptarëve në Kosovë, duke tentuar të ndërrojë dhunshëm dominimin demografik dhe etnik në Kosovë. Këtë synim pati edhe agresioni serb mbi shqiptarët gjatë viteve 1998-1999, që kulmoi me dëbimin e vrasjet masive të shqiptarëve, me elemente e përmasa të theksuara të gjenocidit.

Konferencat për ish Jugosllavinë, sidomos ajo e Dejtonit, Hagës, Londrës dhe paraqitja publike e UÇK, Konferenca e Rambujes, ndërhyrja e trupave të NATO-s, po sikurse edhe zhvillimet e pasluftës u bënë pjesë e një procesi të përbërë të shtet-ndërtimit në Kosovë. Konkretisht ky proces kaloi nëpër tre faza.

**Faza e parë** ishte ajo e stabilizimit të gjendjes së krijuar me luftën e viteve 1998-1999 dhe për këtë qëllim bashkësia ndërkombëtare dha një ndihmesë të çmueshme, megjithëse stabilizimi i gjendjes nuk mund të bëhej menjëherë. Ai paraqitej si një proces i tërë i angazhimit të institucioneve ndërkombëtare dhe atyre vendore, që u krijuan si rezultat i rezolutës 1244, mbi bazën e së cilës Kosova u vendos nën administrimin e përkohshëm ndërkombëtarë.

**Faza e dytë** ishte faza e ristrukturimit të Kosovës, që u shtri në ndërtimin e institucioneve të përkohshme të vetëqeverisjes dhe demokratizimin e shoqërisë në përgjithësi. Një kohë bashkësia ndërkombëtare e ushtroi bashkë me forcat politike të Kosovës me të cilat, në të vërtetë kishte ndërtuar një strukturë të përbashkët veprimi.

**Faza e tretë** është edhe faza më e rëndësishme për Kosovën dhe shqiptarët, është ajo e përcaktimit të statusit. Kjo fazë zgjati më shumë sesa ishte menduar dhe procesin e përcollën dilema e vështirësi të shumta. Palët u ulën në një proces të gjatë e të mundimshëm negociator, nga i cili doli një dokument (plani Ahtisari) që u pranua nga shqiptarët, por jo edhe nga serbët. Shqiptarët bënë shumë koncesione dhe kompromise që më në fund të fitojnë “pavarësinë e mbikqyrur”, të cilën e shpallën më 17 shkurt 2008 në dakordim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës (SHBA) dhe një numër shtetesh evropiane me influencë. Në kapitujt pasues në këtë punim, nga kapitulli i I deri tek i V është bërë një përshkrim i ndërtuar mbi argumente, deklarata e dokumente burimore që nga periudha e luftës, ndërhyrja ushtarake e NATO-s, vendosja e administrimit ndërkombëtarë (UNMIK), negociata për statusin final, shpalljen e pavarësisë dhe ombrellën e këtij rrugëtimi si kapitull final. e që ka të bëjë me 17 Shkurti i vitit 2008 ishte mbyllja e një kaptine dhe hapja e një kaptine të re për Kosovën. Zhvillimet politike deri te kjo ditë dhe datë jam përpjekur ta shkoqis dhe piketoj në formën më të mirë të mundshme.

## **Kapitulli I**

### **Pozita juridiko-kushtetuese e Kosovës në vitin 1980**



## 1.1. Kosova në prag të demonstratave të vitit 1981

Megjithëse Kosova me kushtetutën e vitit 1974 gëzonte statusin e njësisë federale të Jugosllavisë, ajo në fakt kishte një autonomi shumë të kufizuar, duke pasur parasysh se Kosova njëkohësisht ishte edhe në kuadër të Serbisë e cila përpiquej në vazhdimësi të ushtrij kontrollë mbi organet e Kosovës. Një situatë e tillë ishte jo e qëndrueshme për shumë kohë. Përderisa ishte gjallë Tito, president i atëhershëm Jugosllav, situata politike mund të mbahej nën kontrollë, por në vitin 1980 Tito vdiq, nuk shkoi shumë kohë kur sistemi shoqëroro-politik në Jugosllavi do të hyjë në fazën e fundit të krizës, fundi i së cilës ishte shkatrimi i Jugosllavisë. Tronditja e parë e këtij sistemi ishte në mars 1981 kur studentët shqiptarë në Prishtinë u ngritën për çështjen e ushqimit të keq në menzën e Universitetit. Kjo trazirë u përhap në shumë pjesë të Kosovës dhe mori një karakter të hapur politik. Kosovarët kërkonin barazi me kombet tjera në ish-Jugosllavi dhe lëvizja e tyre në thelb ishte një rilindje kombëtare. Kërkesa kryesore e kosovarëve ishte që Krahina Socialiste Autonome e Kosovës të bëhej Republikë. Trazirat u shtypën nga ushtria dhe policia, mirëpo ky qe një problem që nuk mund të fshihej<sup>1</sup>. Autoritet federative tani po përballeshin me një situatë shumë delikate. Thirja për Kosovën Republikë bëri që të binin këmbanat e alarmit sidomos në Serbi e Maqedoni. Një pakicë komunistësh në Serbi të ndihmuar aso kohë nga mediat e Beogradit mëtonin se pakica serbe e malazeze në Kosovë (rreth 10% e popullësisë) ishte nënshtruar terrorizmit sistematik „iredentistëve shqiptarë“. Ata e arsyetonin mëtimin e tyre me numrin e serbëve që shpërngulehin nga Krahina dhe shkonin në Serbi. Vërtetë pati një eksod të serbëve në fillim të viteve të 80-ta, por ata qenë emigrant ekonomik e jo refugjatë.<sup>2</sup> Në kohën kur burokracia kosovare e propagandonte këtë liri në Beograd përgaditej „Libri i kaltërt“, që në fakt përgaditej vari i Kosovës. Ndër presionet që bëheshin mbi popullin shqiptarë padyshim nga më tragjikat është presioni ekonomik. Jugosllavia kishte investuar në Kosovë, në shfrytëzimin e kësaj lënde të parë por asnjëher në industrinë finalizuese.<sup>3</sup>

---

<sup>1</sup> *Glenny Misha, Histori e Ballkanit 1804-1999, Tiranë 2007 fq.624*

<sup>2</sup> *Vepër e cituar fq. 624*

<sup>3</sup> *Kosumi Bajram, “Pse I organizuam demonstratat në vitin 1981” Koha 13 mars 1991 fq.32*

## 1.2. Demonstratat e studentëve në Kosovë në vitin 1981

Më 11-26 mars 1981 në Universitetin e Prishtinës u zhvilluan demonstrata- protesta të studentëve. Pakënaqësia në mesin e pesëdhjetë mijë studentëve u ushqye në rradhë të parë nga fakti se një të diplomuari të universitetit nuk i hapet asnjë perspektivë profesionale.

Pra në vitin 1981 studentët jetonin në kushte, thuajse të mjerueshme për të marë racionin e darkës duhej të pritej në rend një orë e gjysëm e ndonjëherë edhe më shumë. Faji për gjendjen e rëndë të të rinjëve student kosovar dhe për tërë popullin e Kosovës, shihej se politika antishqiptare serbo-jugosllave që asnjëherë nuk e kishte përligjur vullnetin e këtij populli.

Duhet potencuar se ngjarjet e marsit të vitit 1981, patën jehonë të gjërë në të gjitha trevat shqiptare. Kështu me 31 mars, shpërthyen demonstrata në Obiliq, më 1 dhe 2 prill në Prishtinë dhe Podujevë. Në Glllogovc, Vuçitërn, Viti dhe Lipjan me kërkesat e demonstruesve u solidarizua i gjithë populli, demonstratat vazhduan në Pejë, Gjakovë, Gjilan, Mitrovicë, Ferizaj etj. Sipas të dhënave zyrtare të asaj kohe, gjatë këtyre demonstratave pati 9 të vrarë dhe 15 të plagosur, ndërsa forcat e policisë serbe patën 2 të vrarë dhe 17 të plagosur. Ato zgjatën gjatë gjithë pranverës së vitit 1981 dhe konsiderohet se ishin demonstratat më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe në Evropën Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Në to, në forma të ndryshme mori pjesë i gjithë populli shqiptar. Demonstratat e vitit 1981, ishin referendumit I më i suksesshëm dhe më bindës i nënshkruar me gjakun e popullit tonë.

Në kërkesat e demonstratave të rinisë në pranverën e vitit '81 dominuan parullat e tjera, siç ishin: "**Kosova e kosovarëve**", "**Duam Republikë**", "Republikë kushtetutë, ja me hatër ja me luftë", "**E duam flamurin kombëtarë**", "**Duam bashkimin e trojeve shqiptare**" e të tjera. Këtyre kërkesave të ligjshme udhëheqja jugosllave iu përgjigj me zjarr e me hekur. Ngjarjet e sipër-theksuara qenë një paralajmërim që shënuan kthesë në historinë e ideologjisë komuniste dhe, në fund, përmbysjen e saj.<sup>4</sup>

---

<sup>4</sup> Sabile Keçmezi-Basha: "Organizatata dhe grupet ilegale në Kosovë 1981-1989", Prishtinë, 2003, faq. 62

### 1.3. Qëndrimi negativ ndaj kërkesave të shqiptarëve nga pushteti jugosllav

Pas demonstratave të vitit 1981 udhëheqja jugosllave vlerësoi se demonstratat e vitit '81 e organizuar nga studentët dhe rinia shqiptare si dhe parullat e përdorura “cënonin” integritetin teritorial dhe sovranitetin e Jugosllavisë. Me qëllim që të luftohej kundër kërkesave të drejta të popullit shqiptarë u hartua një platformë, platforma politike për aksionin e LKJ në zhvillimin e vetqeverisjes socialiste të bashkim vllazërimin dhe të përbashkësisë në Kosovë.

Platforma kërkonte që shqiptarët të ndërprenin lidhjet kulturore e shkencore me Republikën e Shqipërisë, të heqin dorë nga aspiratat kombëtare, ndërsa kërkesa për Republikën e Kosovës u vlerësua si kërkesë reaksionare që synonte shkatërrimin e Jugosllavisë<sup>5</sup>.

Sulmet morën karakter segregacioni dhe aparthejdi që nga viti 1981 kur në Serbi sulmoheshi shitoret e shqiptarëve dhe individët. Gjatë periudhës 1981-1990 rreth 1100 ushtarë shqiptarë u dënuan me burg afatgjatë në procese të montuara politike, kurse 63 ushtarë shqiptarë u vranë nga armata e Jugosllavisë. Më vitin 1981 Serbia i izoloi intelektualët shqiptarë, izolimi i të cilëve u bë edhe më vitin 1989 kur ndërmorën masa më drastike të torturës dhe represionit ndaj 254 intelektualëve që u dërguan në burgjet e Serbisë e më pastaj edhe burgjet e Kosovës. Policia e Kosovës dhe ajo e Serbisë kishte bërë përpunimin e dosjeve për gjashtëqindmijë shqiptarë që do të thotë që çdo i treti shqiptarë u ftua në polici. U organizuan një sërë procesesh gjyqësore në të cilët vëzhguesit e huaj nuk u lejuan të merrnin pjesë. Nga njoftimet zyrtare u bë e qartë se një numër i madh të pandehurish ishin më të rijë se 20 vjet, 18 vjeçarët u dënuan me 5 deri 6 vjet burg për arsye se kishin marrë pjesë në demonstrata.<sup>6</sup>

Në fillim të vitit 1986, në përpjekje për të tërhequr mbështetjen e opinionit publik, 2000 serbë nënshkruan një peticion ku shpreheshin se serbët e Kosovës ishin seriozisht të kërcënuar. Ata u dërguan peticionin institucioneve më të larta të pushtetit serb dhe atij federal. Kjo protestë, si dhe ato të shqiptarëve të Kosovës përpara saj, u cilësuan menjëherë nga autoritetet federale si negative, si “provokim”. Udhëheqja e shqiptarëve të Kosovës duke besuar se në Kosovë tashmë ekzistonte një “shtab rebel serb” kërcënoi se do të merrte masat e veta shtypëse.<sup>7</sup>

---

<sup>5</sup> *Instituti i historisë-Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi I Kosovës (1887-1995), Prishtinë 1997 faq 67*

<sup>6</sup> *Reuter Jens; vepër e cituar, faqe 98*

<sup>7</sup> *Po aty: faq.80*

## 1.4. Diferencimi ideo-politik në Kosovë

Raporti zyrtarë shtetërorë thekson se në këto demonstrata humbën jetën 8 demonstrues dhe një milic, ndërsa u lënduan 75 demonstrues, kurse 55 u plagosën me armë zjarri. Zyrtarët theksuan se u lënduan edhe 127 milic.<sup>8</sup>

Kreu jugosllav kërkonte "armikun" jo vetëm jashta shtetit por edhe në radhët e veta. Komunistët jugosllavë në vlerësimet e tyre si shkaqe të revoltës në Kosovë theksonin edhe mungesën e vigjilencës si dhe në gabime të rënda e në shelje të ndryshme për brenda partisë. Por qëllimi kryesor i kritikës drejtohej drejt Lidhjes Komuniste të Kosovës dhe udhëheqja e saj. Për këtë qëllim më 5 maj u largua nga posti i tij në parti Mahmut Bakalli. Ai deklarohet se e njihet veten e tij fajtor. Ndërkaq kryetari i presidiumit të komitetit qendror të komunistëve jugosllav, Llazar Mojsovi u shpreh për një "diferencim" konsekuent politik në të gjitha nivelet e partisë. Me parullën diferencim ideo-politik më vonë u bë përpjekja që të pastrohej aparati i partisë dhe i shtetit nga të gjithë ata të cilët me mosveprimin e tyre bënë të mundshme trazirat ose simpatizuan nxitësit e trazirave që shiheshin si element anti jugosllav<sup>9</sup>. Pas qëndrimeve zyrtare jugosllave pasuan mbledhjet një pas një dhe të jepen kualifikime, cilësime e vlerësime gjithnjë e më të ashpra, demonstratat e vitit 1981 do t'i dënon si kundërrevolucion. I pari, revoltën e vitit 1981 e kualifikoj si kundërrevolucion pionieri i Titos, Azem Vllasi, i cili më 12 mars do të deklaroj: "...Nuk mund të flitet për një masë të mashtruar, por kemi të bëjmë me një kundërrevolucion që i ka shtrirë rrënjët thellë. Prandaj thellimi i diferencimit ideo-politik në të gjitha sferat e jetës në Kosovë është si parakusht për normalizimin e gjendjes..."<sup>10</sup>. Ndërsa më 27 prill 1981 për demonstratat Fadil Hoxha do të deklaroj: "...Ato ishin demonstrata nacionaliste të organizuara nga ana e armiqve shqiptaro-mëdhenj. Prapa tyre qëndrojnë ato forca të errëta që çdoherë nxisin krijimin e situatave të acaruar në këtë pjesë të Evropës..."<sup>11</sup> Dënimet shqiptoheshin për vepra penale politike, për nxitjen e urrejtjes, të përçarjes ose të mostolerancës nacionale, racore e fetare nga neni 134 i LPJ-së, ishin shumë të larta. Si nen më i përshtatshëm për t'i hedhur shqiptarët në burg është përdorur neni 114 (që do të thotë rrezikim kundërrevolucionar), me të cilin shqiptarët dënoheshin deri më 15 vjet burg të

<sup>8</sup> Tahiri Ramush, „Pranvera 81, Epoka mars 1991“ fq.25

<sup>9</sup> Reuter Jens, vepër e cituar fq.98

<sup>10</sup> Basha Keqmezi Sabile, vepër e cituar fq.40

<sup>11</sup> Gazeta "Rruga jonë" Lion, mars, 1995, faq.4.

rëndë. Shpesh aplikohet edhe neni 113 (për propagandë armiqësore) e ndonjë nen tjetër. Disa prej të burgosurve politik, nga burgjet i nxirrin në arkivole. Kështu, as pas sa vjetësh nuk dihet sesi u mbytën të burgosurit Afrim Abazi, në zyrat e UDB-së në Ferizaj, Zija Shemsiu, në burgun e Beogradit, Xhemajl Berisha, në burgun e Prizrenit etj.<sup>12</sup>

Tragjedia që do të bëhet më vonë me shqiptarët, nuk është vetëm pasojë e represionit serb por para së gjithash, si pasojë e politikës së dobët e të gabuar që do ta ndjekin shqiptarët pas vitit 1981 në krye me Azem Vllasin.

Të dhënat e Dolancit më 9 qershor 1981 u korrigjuan në disa pika nga ministri i Punëve të Brendshme të Jugosllavisë Herleviq, në një raport mbi gjendjen e sigurimit në Krahinën Autonome të Kosovës. Gjenerali Herleviq deklaroi se gjatë muajve mars dhe prill në njëmbëdhjetë komuna të Kosovës janë zhvilluar 16 demonstrata me pjesëmarrje masive. Demonstruesit, që nuk qenë trembur as para dhunës së ashpër, as para përdorimit të armëve të zjarrit, kishin shkatërruar ose dëmtuar më shumë se 100 automjete, kishin thyer 400 vitrina, si dhe kishin shkaktuar dëme të tjera në godina publike e private. Nëntë persona ishin vrarë e 257 ishin plagosur. Ministri i Punëve të Brendshme deklaroi se edhe mbas 2 prillit-që ta themi konkretisht- deri më 26 maj –në Prishtinë (tri herë) në Istog, Kaçanik, dhe në Suharekë kishte pasur turbullira. Përpjekje për të organizuar demonstrata të tjera në Pejë, Gjakovë, Deçan, Prizren, Rahovec e Viti dështuan. Sipas njoftimit të dhënë, kundrejt 1.700 personave qenë marrë “masa represioni dhe preventive”. Në këtë rreth personash sipas të dhënave të Herleviqit numëroheshin 29 “organizatorë të drejtpërdrejtë të demonstratave dhe 39 pjesëtarë të organizatave ilegale”.<sup>13</sup>

Demonstratat e vitit 1981 ngjallën në Serbi shqetësime dhe brengosje. Shumë serbë dyshonin se mos shqiptarët, duke përfitur nga shtegu që linte vdekja e Titos, do të përpiqeshin të shkëputeshin fare nga Jugosllavia, jo sepse e ndjenin veten të shtypur, por sepse kishin përfitur më tepër se duhej autonomi, gjë që nxiste te ta ndjenjat e “separatizmit”.<sup>14</sup>

Në analizën e 1 shtatorit të vitit 1983, CIA thotë se, problemet e shqiptarëve kanë kapacitetin më shpërthyes në Jugosllavinë e asaj kohe, ndërsa e para në listën e ngjarjeve që do të mund të destabilizonin Qeverinë në Beograd cilësohej se ishte mundësia për demonstrata të reja

---

<sup>12</sup> Dr.Sabile Keçmezi-Basha: *vepër e cituar, faq.40*

<sup>13</sup> Reuter Jens: *“Shqiptarët në Jugosllavi”, Tiranë, 2003,faq.90.*

<sup>14</sup> Gazeta “Rruga jonë” Lion, mars,1995, faq.4.

shqiptare në Kosovë<sup>15</sup>. Shqiptarët janë komuniteti më shpërthyes etnik në Jugosllavi, me shpërthimin e tyre më të dhunshëm të ndodhur në demonstratat e vitit 1981 në Kosovë, ku ata janë shumicë dominuese. Si shtesë, ata përbëjnë 20 për qind të popullatës së Maqedonisë-të përqendruar në Maqedoninë Perëndimore –dhe janë një minoritet në rritje në Mal të Zi.

Ndërsa situatën e atëhershme agjencia më prestigjioze CIA do ta përshkruajë si: Trazirat e vazhdueshme të “nacionalistëve” shqiptarë në Krahinën e Kosovës dhe në republikat fqinje, reflektojnë një pakënaqësi në rritje me Beogradin rreth kërkesave për t’i dhënë fund dominimit serb dhe për standard më të lartë të jetesës. Në këtë pikë, trazirat nuk duket se e kanë arritur nivelin e marsit të kaluar, kur rebelimet e dhunshme kanë rezultuar me nëntë vdekje dhe mbi 100 të lënduar. Marrë parasysh paaftësinë e lidërshiptit jugosllav, që të dalë me një zgjidhje të qëndrueshme për problemet ekonomike dhe të nacionalitetit në Kosovë, megjithatë, një rishfaqje e mëtejshme e trazirave nuk mund të përjashtohet.<sup>16</sup>

Në disa muajt e fundit, manifestimet e shqetësimeve në masë të madhe janë kufizuar në demonstratat të shkallës së ulët, paraqitje të parullave kundër regjimit, dhe shpërndarje të pamfleteve që bëjnë thirrje për status të republikës për Kosovën ose për bashkim me Shqipërinë fqinje. Ka pasur edhe raporte për dhunë. Sipas zyrtarëve jugosllavë, serbët dhe malazezët e Kosovës janë sulmuar në Pejë, një nga qendrat e demonstratave të vitit të kaluar. Me gjithë përpjekjet gjatë vitit të kaluar për të pastruar Universitetin e Prishtinës nga të gjithë ngatërrestarët potencialë, një numër i demonstratave të zëshme por jo të dhunshme që përfshiu midis 30 dhe 100 studentëve kanë ndodhur te godinat e konvikteve.

“Nacionalistët” shqiptarë në universitet kanë shkuar përtej thirrjes për status të republikës për Kosovën dhe e shohin bashkimin me Tiranën, si e vetmja rrugëdalje nga dominimi serb. Demonstrata që përfshin “nacionalistët” shqiptarë nuk janë kufizuar vetëm në Kosovë, por janë raportuar në rajonet kufitare të Malit të Zi dhe Maqedonisë fqinje. Që të dy këto republika kanë popullatë të madhe shqiptare. Në fillim të këtij muaji, pesë studentë shqiptarë të Universitetit të Prishtinës janë gjykuar në Shkup, kryeqytet i Maqedonisë për shpërndarje të “materialit propagandues” nga Shqipëria. Disa zhvillime do të ndikojnë pakënaqësi më akute etnike sesa që ne tash e parashiheshin për afat të shkurtër. Në një renditje sipas gjasave për të ngjarë këto do të ishin:

---

<sup>15</sup> *Koha ditore*- :Bajrami Agron :*Dosja e CIA-së për Kosovën* -33, 23 maj 2005.

<sup>16</sup> *Koha ditore*: Bajrami Agron "*Dosja e CIA-s për Kosovën(8)*", i datës 22 prill 2005 (*Vazhdojnë trazirat në Kosovë*).

### ***Demonstratat e përsëritura në Kosovë;***

Përkeqësim drastik ekonomik në jug, që krijon mungesa të rënda të cilat u japin nacionalistëve radikalë më shumë ndikim në Maqedoni, Kosovë Bosnjë e Hercegovinë dhe Serbi Jugore;

Kolapsi i programit stabilizues ekonomik që shpien në humbjen dramatike të besimit në Qeverinë federative;

Dyshimi, sikur që janë ad hoc demonstratat ose greva e rrezikshme, se agjitimi në terren, i udhëhequr nga rinia e pakënaqur, po rrëshqet nga kontrolli i udhëheqësve të tanishëm etnik;

Demonstrata të përbashkëta antiserbe nga një kombinim i kroatëve myslimanëve dhe shqiptarëve brenda Jugosllavisë;

Në përgjigje më e fortë serbe kundër agjitimit antiserb, ndoshta duke përfshirë thirrje për intervenim ushtarak për ta mbajtur rendin.<sup>17</sup>

---

<sup>17</sup> .Koha ditore: "Dosja e CIA-s për Kosovën ", 23 maj 2005- CIA më 1983 besonte se „presionet për status të Republikës në Kosovë do të vazhdojnë të rriten; nataliteti shqiptarë-më i larti në Evropë-i çiftëzuar me mërgim të vazhdueshëm të serbëve dhe malazezëve, me shpejtësi po krijon një krahinë pothuaj tërësisht shqiptare”.

## 1.5. Shtypi i brendshëm dhe i jashtëm mbi ngjarjet e vitit 1981

Shtypi Jugosllav si gazeta “**Borba**”, me 5 prill shqiptarët do ti quaj për “element armiq e kundërrevolucionarë”, që veprojnë në formë të organizuar e me veprime të vrazhdëta e të paramenduara dhe nuk prapsen edhe para veprimeve çnjerëzore, ndërsa gazeta “**Politika**” një ditë më vonë ngjarjet do ti cilëson si:

**“Në sfondin e të gjitha ngjarjeve qëndrojnë interesa ndërkombëtare. Është fjala për një veprim të planifikuar, demagogjik të nacionalistëve ekstremist, i cili qe përgaditur deri në hollësi me qëllim që të krijonte një rrëmujë një hutim, në opinionin shoqërorë dhe të nxiste mendjehetët të bashkëvepronin..... Mënyra se si u mblodhën demonstruesit tregoi se kishte një bërthamë të organizuar e cila mbante në duart e saj të gjitha fijet”.**<sup>18</sup>

Gazeta tjetër frënge, “**LIBERATION**”, ndër të tjera shkruan: “...më shumë se 800 vetë janë shpallur fajtorë, nga të cilët 400 kanë marrë dënime deri më 15 vjet burg dhe 1.300 të tjerë kanë marrë dënime që janë në kompetencën e policisë, pra më pak se një vit”.

Bota demokratike dhe shtypi i pavarur Evro- perëndimor nuk i panë këto ngjarje me syzet e Beogradit menjëherë pas gjakderdhjes ata filluan të reagojnë përmes komenteve dhe artikujve të shumtë analitik duke informuar drejtë opinionin e gjërë reth së vërtetës që kishte ndodhur në Kosovë. Po e përmendim revistën suedeze “**Tempus**”, e cila veç tjerash, shkruante: “Njerëz të pafajshëm qëllohen me armë. Më shumë se 300 vetë janë goditur, edhe fëmijë të vegjël janë qëlluar nga forcat e armatosura serbe. Asnjëherë pas Luftës së Dytë Botërore nuk ka ndodhur të jetë përdorë një dhunë e këtyllë në Jugosllavi kundër një grup njerëzish, siç ndodhi në këtë rast kundër shqiptarëve. Njerëzit qëlloheshin nga helikopteri vetëm pse protestonin kundër politikës së padrejtë të regjimit të Beogradit”<sup>19</sup>.

Gazeta e njohur gjermane « **Frankfurter Allgemeine** », vetëm gjashtë ditë pas demonstratave, më 09 prill 1981, shkruante : » Kur u vjen uji deri në fyt diktaturave fashiste të Amerikës Latine, ashtu si dhe tani vetëqeverisjes jugosllave, reagojnë siç duket në mënyrë bukur të ngjajshme ».Duke folur për kërkesat e shqiptarëve kjo gazetë, këtu e 26 vite më parë shkruante se « në demonstrata doli kërkesa Kosova republikë ! Demonstruesit kërkuan që statusi i

<sup>18</sup> Reuter Jens “vepër e cituar” faq 57

<sup>19</sup> Basha Keqmezi Sabile, ” vepër e cituar”, faq.45



autonomisë së Kosovës të jetë i njëjt me statusin e republikave tjera që përbëjnë federatën jugosllave».<sup>20</sup>

Nga ana tjetër përpjekjet e udhëheqësve jugosllav që të paraqesin gjendjen sikur demonstratat e popullit shqiptar të jenë drejtuar kundër popujve jugosllav dhe pakicës serbe në Kosovë, e njehta gazetë në një artikull tjetër të datës 27 prill 1981, i mohon kështu : »Të gjithë vrojtuesit vërtetojnë se demonstratat e shqiptarëve, përkundër karakterit nacional, nuk janë të drejtuara kundër pakicës serbe » .

Gazeta suedeze, » **Zundsvalstindling** » në një artikull me titull : »Ngjarjet në Kosovë shqetësojnë shumë udhëheqësit e Beogradit », botuar menjëherë pas demonstratave të 1 dhe 2 prillit 1981, shkruante : » Demonstruesit kritikojnë shtypjen që u bëhet shqiptarëve në Jugosllavi. Ata kërkonin liri si dhe krahina e Kosovës të shpallet Republikë. Për këtë qëllim autoritetet e Beogradit, i quajtën demonstruesit «nacionalistë», «separatistë» dhe «kundërrevolucionarë».<sup>21</sup>

Nga ana tjetër gazeta amerikane «**New-York Times**» e datës 27 prill 1981, veç tjerash ngjarjet e Kosovës i vlersonte kështu : «Shteti federativ jugosllav tashmë i ka gjashtë republika. Çfarë ndryshimi do të sillte edhe një republikë më shumë ? Pse Kosova të mos jetë republikë kur 85 % e banorëve të saj janë banorë etnik ?<sup>22</sup>

Nga ana tjetër gazeta greke «**Tovina**» bën këtë koment mbi ngjarjet në Kosovë : «Nuk duhet ta zvogëlojmë rëndësinë e ngjarjeve që po ndodhin në rajonin autonom të Kosovës, në kufi me Shqipërinë, edhe nëse kriza mbytet. Fakt është se autoritetet jugosllave nuk po i kursejnë mjetet e tyre mbytëse. Këto telashe përbëjnë një paralajmërim serioz...», shprehet kjo gazetë menjëherë pas demonstratave të vitit 1981 në Kosovë.

Ndërkaq në një koment të gjatë me titull «Kosova e varfër dhe e diskriminuar», gazetari spanjoll Torro Riesko, në gazetën spanjolle «**Avoi**» shkruante : «Shqiptarët e Kosovës konsiderohen njerëz të përbuzur në Jugosllavi. Kosova është krahina më e prapambetur e Jugosllavisë dhe e gjithë Evropës. Ekziston një pabarazi e dukshme në mes Kosovës me minerale dhe republikave tjera. Që nga mbarimi i luftës represialet atje kanë qenë të egra... »

---

<sup>20</sup> Rashiti Ismet, "Rrëfandë lirie" Prishtinë 2010 fq.18

<sup>21</sup> [www.pashtriku.org](http://www.pashtriku.org)- 27 vjetori i demonstratave te vitit '81

<sup>22</sup> Rashiti, Ismet "Pranvera e madhe" 2007 St Galen Zvicër faq 13

## **1.6. Mërgata shqiptare në përkrahje të demonstratave të vitit 1981**

Nuk do të ishte i plotë kuadri sikur këtë temë ta përfundonim pa e cekur shkurtimisht edhe aktivitetin e madh dhe shumë të rëndësishëm politik të bashkëatdhetarëve tanë që jetonin dhe vepronin në Evropën perëndimore. Opinioni ndërkombëtarë duhej sqaruar sidomos me organizimin e demonstratave nëpër qendra të ndryshme të Evropës perëndimore. Demonstrata e parë dhe shumë e suksesshme do të zhvillohet më 11 prill të vitit 1981 para ambasadës jugosllave në Bern-kryeqytet i Zvicrës edhe demonstrata e dytë u mbajt në Zvicër më 18 prill në qytetin Cyrih. Më 25 prill demonstratat vazhduan në Shtutgard të Republikës Federale Gjermane. Valën e re të dhunës dhe terrorit në Kosovë do ta pasojnë edhe demonstratat e tjera që u organizuan dhe u mbajtën në Gjenevë, para përfaqsisë së OKB-së pastaj në Francë, në Belgjikë në Suedi në SHBA, e në vende të tjera. Përmes fjalimeve të gjata dhe të rëndësishme demaskoheshin qëllimet e vërteta të demonstratave të Kosovës. Poashtu nëpërmjet peticioneve dhe memorandumëve që nga këto demonstrata u dërgoheshin forumeve më të larta shtetërore Jugosllave përfaqësive ndërkombëtare, qeverive Evropiane bëhej apel për ndërprerjen e dhunës dhe të terrorit të ushtrisë dhe të policisë në Kosovë që Kosovës ti njihej statusi i Republikës, kërkohej lirimi i qindra mijëra të burgosurve politik të mbyllur gjatë demonstratave në Kosovë etj. Kërkesat e përvokueshme para opinionit shqiptarë dhe atij botërorë ishin si vijon:

- 1. Pa u njohur statusi i Republikës në kuadër të Federatës Jugosllave.*
- 2. Pa u njohur shqiptarëve në Jugosllavi statusi i kombit dhe rjedhimisht e drejta për vetvendosje deri në shkëputje.*
- 3. Pa shpalljen e amnistisë së përgjithshme me të cilën do të liroheshin menjëherë dhe pa kusht të gjithë të burgosurit politik shqiptarë që vuajnë dënime të rënda nëpër kazamatet jugosllave.*
- 4. Pa u rivendosur dhe pa vazhduar më tej marrëdhëniet e filluara kohë më parë mes popullit shqiptarë (dhe popujve të tjerë) në Jugosllavi me shtetin dhe me popullin shqiptarë në Republikën e Shqipërisë të ndërprera në mënyrë të njëanshme arbitrare e me qëllime thellësisht antishqiptare, pa këto masa të menjëhershme rigorozisht të plota populli shqiptarë nuk do të qetësohet deri në ngadhënjimin e plotë të drejtave dhe lirisë së tij.*

Duhet pranuar se një rol të madh në nxitjen e ndjenjave kombëtare kanë luajtur valët e Radio Tiranës e të Radio Kukësit, grupet e ndryshme kulturo-artistike, intelektualët që e vizitonin Kosovën e që ishin atdhetarë të devotshëm, por meritë të jashtëzakonshme në tërë ilegalen shqiptare në Kosovë, luante emigracioni shqiptar që kishte rënë në kontakt me ish-mërgimtarë politik të mëhershëm.

Demonstratat e vitit 1981 shënojnë vazhdimësinë e lëvizjeve për çlirim kombëtar, të filluara që nga koha e Lidhjes së Prizrenit. Po cka kontestuan demonstratat e vitit ide joproduktive, johumane, shoviniste, që me procedura të legalizuara, me qëndrimet dhe vendimet e komiteteve dhe të elitave të burokratizuara i gllabëronin perspektivat kolektive, fatet individuale të shqiptarëve, një hipokrizi të madhe politike, standardet e dyfishta, një sistem të rrënuar vlerash, një despoti që s' i qëndroi sfidës së kërkesave për respektim të drejtave të njeriut.

Sa më shumë që shkileshin të drejtat e njeriut në Kosovën e pas demonstratave të vitit 1981 aq më shumë ndërkombëtarizohej çështja shqiptare dhe globalizohej kërkesa për respektim të të drejtave të njeriut.

Demonstratat e vitit 1981 dhe ngjarjet që pasuan nxorën në shesh të drejtat e rrejshme, ligjet e pavlevshme, autonominë formale. Në ato demonstrata u manifestua një vetëdije e lartë kombëtare, politike dhe qytetëruese dhe u dërgua një mesazh të qartë historik: shqiptarët nuk mund të pranojnë më këmbimin e të drejtave shtetërore.

Përfaqsesit shqiptarë nuk kishin pushtet, por ishin transmision, përcues i pushtetit të qarqeve të hirta që me ideologji komuniste e impononin interesin e tyre të zhveshur nacional, shqiptarët nuk kishin autonomi por atë e kishte oligarkia politike, shqiptarët nuk i mbronin ligjet por ato i fshikullonin me të marrë urdhrin politik..

## 1.7. Organizimi i lëvizjes shqiptare në Jugosllavi-shtytje drejt shpërbërjes

Gjatë kësaj periudhe kohore shumë organizata zhvillonin aktivitet të dendur politik-ilegal edhe pse organizatat mes veti dhe organizimet si dhe programet e tyre dallonin në nuanca shumë të vogla. Po përmend disa organizata:

- Organizata ilegale “**Grupi Revolucionar**” veprimtarinë e zhvilloi gjatë viteve 1969-74
- Organizata PKMLSHJ –“ **Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi**”- kishte degët e veta dhe strukturat organizative. Rreth vetes tubonte një numër të madh intelektualësh dhe ishte tejet masive. Sipas të dhënave që kemi, nëpërmjet një shkrese që ua drejton organeve të pushtetit, kjo organizatë madje merr përsipër organizimin e demonstratave studentore.
- Organizata “**Komiteti i Kosovës...**” gjatë punës afro katërvjeçare ndërmorën shumë aksione. Të gjitha këto organizata kishin një qëllim të caktuar që populli shqiptarë të jetojë i lirë si gjithë popujt e tjerë. Gjatë aktiviteteve të tyre do të ndërmarin edhe aksione të ardhshme për sensibilizimin e faktorit të jashtëm.
- Organizata ilegale “**Lëvizja për Republikën Socialiste të Shqiptarëve në Jugosllavi**” ose (“LRSSHJ”). Kjo organizatë dëshmohej edhe me projektprogramin dhe projektstatutin e saj, të cilëve në mënyrë të përpiktë u përmbaheshin anëtarët gjatë punës ilegale.
- Organizata ilegale “**Fronti Nacional-Çlirimtar i Kosovës**” ose (“FNÇK”) që më vonë mendonte të shndërrohej në organizatë ilegale “**Partia e Luftës së Kosovës**”, kishte një organizim të dendur dhe si fazë të tretë për realizimin e kërkesës së Kosovës-Republikë parashihte edhe luftën në terren.

Një përpjekje për një bashkim të këtyre organizatave u mbajt në Stamboll më 17-shkurt 1982, mirëpo agjenturat serbe kishin goditur shumë keq. Më 17 janar 1982 ishte vështirë të zëvendësohej roli që kanë pasur sidomos Jusuf Gërvalla dhe Kadri Zeka në këto bisedime.

Dëmi ishte i pariparueshëm dhe pas shumë orvatjesh asnjëherë nuk u arit një bashkim i mir filltë. Me kohë mbi supet e saja organizimet në Kosovë dhe jashta saj do ti marë LPRK (LPK) e cila do të jetë bartëse serioze e të gjitha organizimeve legale, ilegale dhe gjysëmilegale të kohës.

## 1.8. Ngjarjet në Kosovë 1989-1990

Pas ngjarjeve të vitit 1981<sup>23</sup>, statusi shoqëror-politik e juridik i shqiptarëve erdhi duke u zbehur. Ky fenomen u bë më i dukshëm sidomos pas ardhjes së Slllobodan Millosheviqit si president i Serbisë më 1985, i mbështetur nga forcat nacionaliste më reaksionare serbe. Millosheviqi i inkurajuar nga heshtja e Evropës dhe e republikave të tjera të ish-Jugosllavisë ndaj problemit të Kosovës, si dhe për të arritur autoritetin e tij politik, me parullën se “krahinat autonome janë dy kancere në gjirin e republikës së Serbisë” rindezi emocionet e vjetra nacionaliste serbe<sup>24</sup>. Më 23 mars 1989, nën kërcënimin e armëve dhe të votave të joparlamentarëve, parlamenti krahinor (tanimë serb) shfuqizoi statusin autonom të Kosovës. Ky ishte edhe një fillim i politikës brutale të shtypjes së popullit shumicë shqiptar<sup>25</sup>. Pas kësaj u rrëzua e gjithë struktura institucionale politike, ekonomike, gjyqësore, shëndetësore e kulturore autonome e Kosovës dhe gjithçka u vendos nën pushtetin e Beogradit<sup>26</sup>. Ndërsa në fillim të vitit 1989 në Kosovë u vendos gjendja e jashtëzakonshme, ku u pasqyrua një dhunë e pakontroll e aparatit serb kundër popullit shumicë shqiptar. Shqiptarët kundër masave shtypëse të Serbisë u përgjigjen me rezistencë paqësore<sup>27</sup>. Me tubimet masive të nëntorit të vitit 1989, Kosova hyn në një fazë të re të luftës së saj politike, luftë për të mbijetuar situatat që do të krijojnë rrethanat e reja të shpërbërjes, respektivisht ristrukturimit të Jugosllavisë. Në këtë shpërbërje, fillimisht, Kosova do të marrë goditjen më të rëndë dhe njëkohësisht barrën më të rëndë, gjithnjë derisa nuk do të shpërthej lufta në **Sllloveni, Kroaci dhe Bosnjë**.

Pavarësisht se Kosova në skenën politike jugosllave merrej nëpër këmbë në formën më brutale, në Kosovë do të krijohet një klimë dhe hapësirë që Kosova të rikrijojë identitetin e vet politik, tash në rrethana të reja dhe me një prapavijë krejt tjetër politike nga ç’kishte qenë deri

---

<sup>23</sup>Viti ‘81 ishte faza e parë e kristalizimit të idesë së luftës së armatosur, që u karakterizua nga përpjekjet për organizimin politik

dhe për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në nivelin e përgjegjesisë historike.

<sup>24</sup>Akademia e Shkencave, Kosova në Vështrim Enciklopedik, Toena Tiranë; 1999; fq.126

<sup>25</sup>Fischer Joschka, Vitet kuq-gjelbër, Koha, Prishtinë; 2008; fq.99

<sup>26</sup>Akademia e Shkencave, Vepër e cituar; fq.127

<sup>27</sup>Fischer Joschka, Vepër e cituar; fq.99

atëherë. Këto ngjarje, veçanërisht *greva e minatorëve të “Trepçës”* në fillim të vitit 1989, do ta afirmojnë Kosovën në përmasa më të gjera, përfshirë edhe ato *ndërkombëtare*<sup>28</sup>.

Kërkesat kryesore të minatorëve ishin: *ruajtja e parimeve të Kushtetutës së 1974, shkarkimi i disa funksionarëve si dhe ti jepet fund politikës diskriminuese të S. Millosheviqit*. Minatorëve u premtua se do trajtohen kërkesat e tyre, kështu pas 8 ditë grevë minatorët lëshuan zgafellat e minierës së Stari Tërgut të Trepçës me bindje se diçka kishin arritur. Por, gjithçka ishte demagogji, që atë natë, Kryesia e RSFJ-së në Beograd mori vendim për “*masa të posaçme në Kosovë*” dhe të nesërmen tanket hyjnë në Krahinë. Ndaj grevistëve filluan përndjekjet, largim nga puna dhe burgime. Populli shpejt e kuptoi se prangat e Serbisë po i shtrëngohen edhe më shumë rreth qafe. Me vënien e R. Morinës, brenda natës në krye të aparatit pushtetmbajtës, njërin ndër tradhtarët më të përbetuar, shihen qartë synimet e afërta të Millosheviqit, padrejtësitë, persekutimet, fyerjet, keqtrajtimet e mbi 500 mijë shqiptarëve vetëm prej vitit 1981 e këtej.

Para zbatimit të këtyre masave drakonike, me urdhër arbitrar u ndalua shprehja e revoltës nëpër protesta, demonstrata e manifestime, me “*konstatimin*” sepse kur bëhen nga shqiptarët qenkan nacionaliste, shoviniste, irredentiste. Duke e parë rrezikun që kërcënonte, si dhe duke parë se po mbyllen të gjitha shtigjet për të kundërshtuar prangat e Serbisë, shtypjen, shfrytëzimin dhe diskriminimin nga ana e saj, populli i Kosovës vendosi të hidhet në grevë urie. Minatorët e Kosovës dhanë shembullin më të lartë: *u futën në galeritë e minierave të Kosovës dhe vendosën që pa u plotësuar kërkesat e tyre, tashmë të njohura në mbarë botën të mos dalin gjallë nga nëntoka*. Mbi 1500 minatorë të Kosovës, Stari Tërgut, minierës së Trepçës, me aktin e tyre, sakrificën e tyre të lartë, për 8 ditë me radhë tronditën gjithë Jugosllavinë dhe opinionin botëror, së bashku me të gjithë klasën punëtore dhe popullin e Kosovës. *Edhe një herë bënë hi e pluhur politikën shoveniste e fashiste të Millosheviqit dhe të klikës së tij gjakpirëse*<sup>29</sup>. U kundërshtuan fuqishëm masat që i ndërmerre Serbia kundër Kosovës, duke kërkuar njëkohësisht që të përparohen ato të drejta që ekzistojnë dhe të zgjerohen në përputhje me kushtet reale shoqërore – historike në të cilat u formua dhe në të cilat jeton populli shqiptarë në RSFJ, kombi i tretë për nga madhësia dhe kompaktësia në Federatë.<sup>30</sup>

<sup>28</sup>Kraja Mehmet: “*Vite të humbura*”, Tiranë, 1995, faq.155.

<sup>29</sup>Mustafë Xhemali, *Pubicistika Kryengritëse (1980-2000, Prishtinë, 2010, f.89-91)*

<sup>30</sup>Po aty, f.90

### 1.9. Shtypi evro-perëndimor për ngjarjet në ish-Jugosllavi-Kosovë

Masat e dhunshme që u ndërmorën nga organet e punëve të brendshme të Federatës Jugosllave në Kosovë, shkaktuan reagime të shumta si në opinionin e brendshëm po ashtu edhe në atë ndërkombëtarë. Shtypi dhe agjenci të ndryshme botërore si **BBC, Agjencia Frans Pres, Agjencia DPA, Koriere Della Sera, Frankfurter rundeshau, Frankfurter Allgemajne Cajtung** dhe në shumë të tjera.

Shumica e mjeteve të informimit do të përpiqen që të prekin në thelbin e problemeve me të cilat po ballafaqohet Kosova. Disa nga gazetat e Austrisë do të sjellin informacione me rastin e masave më të reja të Serbisë në Kosovë, ata do të konstatojnë edhe heqjen e autonomisë së Kosovës. **Gazeta “Standardi”** thotë se “dëshmitarët kanë raportuar se Serbia ka dërguar në Kosovë tanke dhe shtojnë më tutje se një ditë më parë Kuvendi i Serbisë me procedurë urgjente ka miratuar ligjin me të cilin ”pushteti shqiptarë në Kosovë është mohuar dhe zëvendësuar me përfaqësues serbë”<sup>31</sup>. Kjo gazetë boton edhe komentimin me titull “Serbia përshëndetet” ku thuhet se marrja e pushtetit të plotë në Kosovë tregon se serbët tashmë janë pajtuar me shpërndarjen e Federatës Jugosllave.

Ndërsa **gazeta “Folkshtime”** shkruan se Kuvendi i Serbisë ka vendosur që të heq të drejtat autonome të Kosovës, ngaqë kjo krahinë është e pushtuar nga ushtria e Beogradit dhe nga policia me gjendjen e jashtëzakonshme që mbretëron atje.

Kurse **BBC-ja** thotë se: ” Ajo që ndodh tash në Kosovë nuk është gjendje e jashtëzakonshme me ndonjë emër të ri, por se rrethana të posaçme të përshkruara jo qartë që do të bënin të mundshme për Serbinë të ndërmarrë masa politike në vend të masave policore ”<sup>32</sup>.

**BBC-ja** gjithashtu thotë se sipas kushtetutës së re që po përgatitet në Serbi, Kuvendi i Kosovës do të humb shumicën e autorizimeve të veta të tashme, të gjitha kompetencat ligjdhënëse do të kalojnë në kuvendin e Serbisë. **The Boston Globe** për situatën në Kosovë në një artikull me titull “Kosova do demokraci” mes të tjerash do të shkruaj se Kosova është nën kontrollin e policisë serbe e cila ka përdorur forcën për shuarjen e protestave dhe se “në këtë krahinë ku shqiptarët përbëjnë 90 për qind të popullsisë , është zbatuar gjendja e

---

<sup>31</sup> *Rilindja 30.06.1990*

<sup>32</sup> *Po aty*

jashtëzakonshme gjatë një viti me parë”<sup>33</sup>. **Chicago Tribune** në artikullin me titull “sëmurja e fundit e Jugosllavisë do të theksojë se në mes të ndryshimeve të stuhishme në Evropën Lindore, “Jugosllavia duket si një kufomë që refuzon të kalbet”<sup>34</sup>. Pa Slloveninë, apo ndoshta edhe pa krahinën jugore të Kosovës, ku serbët ende i demonstrojnë muskujt e hekurt, Jugosllavia mbase do të mund të vazhdonte disi, porse jeta e saj nuk do të zgjatë asnjë minutë me daljen e Kroacisë. Më shumë se në çdo vend evropian jeta e përbashkët në Jugosllavi është imponuar më shumë me forcë sesa me pëlqimin e popujve të saj kjo gjë e bëri atë të quhej një “shtet sezonal”<sup>35</sup>.

Në artikullin me titull si të kontrollohet Kosova të **Agjencisë Frans Pres** në raportin e vet vlerëson se Serbia i ka dhënë grusht të rëndë Krahinës së Kosovës e cila ka gëzuar autonomi të gjërë dhe që praktikisht ka qenë edhe Republika e shtatë e Jugosllavisë dhe se këtu shihet qartë nervozizmi tek opozita shqiptare e cila armiqësisht e ka pritur vendimin e Serbisë.

**Agjencia DPA** vë në dukje se Serbia ka ndërmarr hapin e fundit në konflikt me shqiptarët e Kosovës dhe se ky vendim i Serbisë paraqet reagim ndaj shpalljes së Kosovës republikë. Mirëpo, është e pasigurt se si do ta kontrollojë Serbia Krahinën në jetën e përditshme duke pasur parasysh rezistencën evidente të shqiptarëve të Kosovës. **Organi i Vjenës “Presse”** në një koment me titull “Triumf relativ” thuhet se me shpërndarjen e kuvendit të Kosovës u shuan aspiratat e popullit të Kosovës drejt pavarësisë.

Gazeta e Milanos **“Korriere Dela Sera”** do të sqarojë prirjen e vendimeve të marrura në këtë Republikë Federative e që ndryshonin nga Republika në Republikë. Në Serbi vendimet merreshin si triumf, ndërsa në Kroaci, Slloveni e Kosovë këto vendime merreshin me indinjatë të thellë. Fletushka e Romës **“Republika”** do të konsiderojë se vendimi i Beogradit do të kontribuojë ngritjes së tensionit e atë do ta shfrytëzojnë forcat të cilat në Slloveni dhe në Kroaci do të angazhohen për shpërndarjen e Federatës Jugosllave<sup>36</sup>.

**Uashington Tajms** vlerëson se tensioni i shtuar ndërnacional dhe refuzimi politik edhe më shumë do të afrojnë perspektivën e shpërndarjes definitive të vendit edhe ashtu më jostabil në Ballkan”<sup>37</sup>. **Frankfurter rundeshau** shkruan se në rast të çintegritimit të Jugosllavisë njëri nga problemet më të mëdha do të jetë caktimi i kufinjëve në mes të republikave të tashme.

---

<sup>33</sup>Po aty

<sup>34</sup>Rilindja 17.06.1990

<sup>35</sup>Po aty

<sup>36</sup>Rilindja 08.07.1990

<sup>37</sup>Rilindja 08.07.1990



**BBC**-ja do të raportoj se çështja e Kosovës për botën do të mbetet çështje e brendshme e Jugosllavisë deri sa ajo do të rrezikojë paqen në Ballkan, gjë që mund të ndodhë lehtë. “Gjopn” do të shkruajë se në Slloveni konsiderohet se masat e tashme në Kosovë janë marrë për arsye se bindjet politike të delegatëve të Kuvendit Krahinorë të shpërndarë janë të papranueshme për pushtetmbajtësit serbë”<sup>38</sup>.

**UPI** në lidhje me situatën e krijuar në Kosovë do ta përshkruajë se Organet serbe të pushtetit kanë ndërmend që ti nxjerrin para gjyqit autorët e Deklaratës për pavarësinë e Kosovës nga Serbia<sup>39</sup>.

Shtypi i huaj si **RFI-Paris**(radio) do të përmend edhe dy ngjarjet të cilat ndodhën në vitet e 90-ta edhe ate shpalljen e autonomisë në Republikën Kroate nga ana e serbëve në një miting masiv si dhe ngjarja e dytë ishte shpallja e numrit të viktimave që pësuan në Kosovë dhe u paraqit si 28 nga ana e Parlamentit Federativ, ndërsa në të vërtetë ky numër ishte 90.

Po qese ky lajm do të jetë i saktë dhe numri 90 që pësuan do të ishte i saktë (dhe që në të vërtetë ishte i saktë) atëherë nuk ka arsye që kjo ngjarje në gjuhën standarde gazetareske duhet të quhet masakër”<sup>40</sup>. Në shpjegimin e mëtejshëm të kësaj ngjarje supozohej se policia serbe duket se është udhëhequr dobët dhe se pjesëtarët e saj kanë bërë atë që kanë dashur ose fjala është se po përgatitet një gjenocid kundër popullatës shqiptare, kundër të cilës mund të bëjnë çka të duan ose bëhet fjalë për provokimet e përgatitura kundër popullatës shqiptare me çka vetëm kryengritja e armatosur e saj do të ishte pretekst për represione me përmasa më të gjëra do të konkludojë kështu **RFI-ja**<sup>41</sup>. Agjencia italiane e lajmeve”**ANSA**” njofton se në “Kosovë shqiptarët po masakrohen dhe se mijëra të rinjë janë vrarë, torturuar dhe arrestuar”<sup>42</sup>.

Gazeta gjermano-perëndimore “**Frankfurter Allgemeine Zeitung**” në artikullin “Sot Kosova po pastaj”shkruante: “Shumica e deputetëve shqiptarë në Kuvendin e Krahinës, të detyruar votuan pro amandamenteve kushtetuese. Por e çuditshme duket se si Federata Jugosllave e shikon me duar kryq politikën shtypëse të Serbisë. Nga sa duket që disa udhëheqje të republikave mendojnë se, përderisa Millosheviqi është i zënë me pushtimin e Kosovës, do ta lërë Republikën e tyre të qetë. Kjo mund të dalë llogari e gabuar.”<sup>43</sup>

---

<sup>38</sup>Po aty 12.07.1990

<sup>39</sup>Rilindja 22.07.1990

<sup>40</sup>Rilindja 28.07.1990

<sup>41</sup>Rilindja 28-07-1990

<sup>42</sup>Krasniqi Jaku,p “Lëvizja për Republikën e Kosovës” 1981-1991 f.222

<sup>43</sup>Po aty f.223

Gazeta “**Vjesnik**” do të shkruajë: “loja politike rreth Kosovës dhe premtimet e kota që do të realizohen menjëherë pas marrjes së pushtetit, konstaton gazeta, e përjeton kulminacionin e vet. Në tërë këtë “programi shovinist shqiptarë me udhëheqësit dhe kreatorët e vet sërish mori vend, kundër milicisë i nxorri fëmijët dhe nënat, sërish i drejtoi breshëritë dhe gurët kundër shtëpive serbe dhe malazeze”<sup>44</sup>.

---

<sup>44</sup>*Flaka e vëllazërimit, 5 prill 1989*

## 1.10. Reflektimi i ngjarjeve të Kosovës në Maqedoni

Rreth situatës në Kosovë, më shumë se kurrë flitej e përflitej në të gjitha forumet më të ulëta dhe më të larta në Jugosllavi si dhe në të gjitha makineritë propagandistike të RTV-maqedonas dhe të shtypit të përditshëm dhe revial maqedonas. Mbi të gjitha dallohet propaganda shoviniste e Serbisë e dirigjuar nga pushtetmbajtësit në Beograd. Karakteristikë e gjithë kësaj propagande është se gjendjes reale në Kosovë i jepej një shpjegim përshkrues, pa ndonjë analizë adekuate dhe të gjitha këto mbeten larg zbërthimit të fakteve në aspektin shkencorë.

Duke parë se në Kosovë është shumë vështirë të “çahet akulli” testimet e para të një fushate të egër antishqiptare, do të bëhen pikërisht në Maqedoni, sepse këtu që nga nisma e një fushate të këtillë, politikanët maqedonas dhe servilët e tyre shqipfolës, publicistët maqedonas, u solidarizuan pa humbur kohë me forcat serbe për t’iu kundërvënë armikut të tyre të përbashkët – “Shqiptarëve”.

Ngjarjet më dramatike të viteve 1988-1989, pa dyshim ishin tubimet e serbëve dhe të malazezëve, të ashtuquajtura mitingje të “solidaritetit” dhe “anti-burokratike”. Në këto mitingje u vjell helm dhe vrerë, u bënë fyerjet më të rënda nga të gjitha strukturat, moshat dhe gjinitë e serbo-malazeze-maqedonase. Duke i akuzuar dhe etiketuar shqiptarët si: “Separatist”, “Tredentist” dhe shumë etiketime tjera fyese të cilat ishin gjithçka por jo të vërteta. Ndër tjerash në parullat e tyre kërkohej dëbimi i shqiptarëve, respektivisht shqiptarët duhet dëbuar përtej “Bjeshkëve të Nemura”, kërkohehin armë “shqiptarët duhet vrarë” etj. Udhëheqësia e Jugosllavisë i ka vlerësuar si pozitive këto tubime ose mitingje të serbëve dhe malazezëve në Kosovë edhe pse në ato tubime haptazi është shprehur indinjata dhe urrejtja ndaj shqiptarëve. Nga ana tjetër, protestat masovike të shqiptarëve të cilat u zhvilluan në tetor-nëntor 1998, të cilat ishin dinjitoze ku qytetarët treguan gatishmëri dhe vendosmëri ta sakrifikojnë edhe jetën e tyre që të mbrojnë *Kushtetutën e 1974*, ligjet dhe sistemin juridiko-politik të ndërtuar mbi parimet e kësaj Kushtetute, *Udhëheqësia e Serbisë* i vlersonte deri në fund si negative. Edhe pse në to nuk ka patur asnjë paraqitje kundër serbëve ose paraqitje oportune. “Serbia dhe Maqedonia nuk duan të njohin asnjë argument, asnjë të vërtetë, madje asnjë të drejtë që kërkojnë shqiptarët”. Serbia i

ishte kthyer mitologjisë mesjetare serbe të kultit të Sveti Savës dhe vizioneve prosllave mbi Kosovën dhe shqiptarët.

Në fjalimin që ish-kryetari i Kryesisë së R. së Serbisë e mbajti më 5 shtator 1988, deklaroi se “*në Kosovë sundon terrori, keqtrajtimi dhe pastrimi i përhershëm i pakicës serbe, kërcënojnë të shndërrohen në një larje masive hesapesh dhe në konflikte të drejtpërdrejta nacionale*” (lajmëron agjencia Tanjug më 5 shtator 1988). Këto gënjeshtra dhe propaganda nuk hasën në mirëkuptim tek sllovenët demokratik dhe përparimtarë. Jozhe Smeshmel në mbledhjen e Këshillit për politikën e brendshme në Kuvendin e RSFJ-së, theksoi se peshën e luftës për zgjidhjen e problemeve në Kosovë e mbajnë organet e punëve të brendshme. *A mos vall shteti i Kosovës- vazhdon ai – funksionon vetëm në sferën represive?*<sup>45</sup> Po ashtu Bozho Kovaç nga Sllovenia në këtë mbledhje theksoi se “*nga programi Jugosllav për Kosovën po realizohen vetëm ato detyra që kanë të bëjnë me policinë dhe me represaljet, kurse detyrat tjera nuk po realizohen*”<sup>46</sup> Akademia e shkencave dhe arteve të Serbisë më 1986 e hartoi memorandumën shoven kinse për “*pozitën politike, ekonomike dhe kushtetuese të rrezikuar të Serbisë në ish-Federatën Jugosllave*”. Njëra prej pjesëve të këtij memorandumë i referohet Kosovës duke thënë: “*Kosova është çështja më jetike e popullit serb*”. Si konkluzë nga ky memorandum doli se Kosovës dhe Vojvodinës t’ju merret statusi autonom i përcaktuar me Kushtetutën e vitit 1974. Pas një iniciative të tillë represive dhe regresive të “*shkencës*” serbe edhe Kuvendi i Serbisë në vitin 1988 hartoi dhe lëshoi në diskutim publik *Amandamentet* në Kushtetutën e R. së Serbisë.

Udhëheqësia politike e Kosovës nga viti 1981 e deri më 1989 ishte një instrument në duart e politikës serbe.<sup>47</sup> Ajo më vonë filloi ta kuptonte lojën për suprimimin e autonomisë së Kosovës. Në diskutimin për ndryshimin e Kushtetutës në Kosovë, ku morën pjesë mbi 400 mijë veta, punëtorë, fshatarë dhe intelegjencia shqiptare u deklaruan kundër propozimeve që impononte Serbia dhe kërkuan ruajtjen dhe forcimin e autonomisë. Ky qëndrim u mbështet nga lëvizja e fuqishme gjithpopullore e nëntorit 1988, ku u shquan minatorët e Trepçës. Grevat e minatorëve të Stari-Tërgut janë protestat e minatorëve shqiptarë të zhvilluara gjatë muajit shkurt 1989, kundër ndryshimeve të statusit të deriatëhershëm kushtetues të Krahinës Autonome të Kosovës dhe reagim ndaj të ashtuquajturave tubime të *Solidaritetit*, të serbëve, ku ishin kërkuar armë për të luftuar kundër shqiptarëve. Tani, pas një distance kaq të madhe kohore, studiuesi e

<sup>45</sup> *Gazeta “Rilindja” Prishtinë 8 Dhjetor 1988*

<sup>46</sup> *Basha Keçmezi Sabile-vepër e cituar f.63*

<sup>47</sup> *Dervishi Nebi-Greva e minatorëve të Trepçës në shtypin maqedon (II) Lajm 24.02.2012 f. 29*

dëshmitari i gjallë i këtyre ngjarjeve të merr në mënyrë kronologjike të përshkruaj rrjedhën e ngjarjeve që nga 1981 e kënde, menjëherë do të bindet se sa në mënyrë të përpiktë janë harmonizuar skenarët e përbashkët të veprimit. Dhe jo rastësisht Maqedonia atëbotë do të shërbej si poligon i sprovave të para “për të zbuluar”, “irendentistët, nacionalistët” etj. Redaksitë maqedonase: “Nova Makedonija”, “Flaka e Vëllazërimit” - që dilte me shkronja dhe fjalë shqipe, “Veçeri”, Radio dhe TV maqedonas, do të veprojnë ato vite edhe me rastin e grevës së Minatorëve të Stari Tërgut të Trepçës, në Shkurt 1989, me “Detyra partiake”, për të krijuar një fushatë dhe atmosferë të paparë anti-shqiptare!<sup>48</sup>

Për një kohë shumë të shkurtër, mediumet maqedonase elektronike dhe të shkruara, pa përjashtim, do të vihen në shërbim të plotë të politikës antishqiptare serbo e maqedonase. Detyra partiake, do të kryejnë tërë ato vite dhe në ditët e grevës së minatorëve më 1989, do të bëjnë edhe redaksitë e Radios dhe TV-Maqedonia, në gjuhën sllavomaqedonase, gazeta: “Trudbenik”, “Prosveten rabotnik”, e sidomos “Nova Makedonija” dhe derivati i saj “Flaka e Vëllazërimit” që dilte me shkronja e fjalë shqipe, por në asnjë mënyrë nuk dallonte në përmbajtje me të parën. Këtë fushatë të egër në Maqedoni, pa kurrfarë mbulese reale e vazhduan edhe gazetatat tjera dhe radiot lokale në tërë Maqedoninë për vite të tëra. Në këtë mënyrë do të rekrutohen edhe penat e para gazetareske, të cilat më vonë do të specializohen për komente e artikujt “analitik”, që do të trajtonin “armiçësinë shqiptare” në të gjitha viset e ish-Jugosllavisë, por me theks të veçant në Maqedoni<sup>49</sup>.

Për të mbështetur me fakte atë që e theksova më lartë, në vazhdim do të bëj përpjekje që në mënyrë kronologjike të jap pasqyrën e shkrimeve, artikujve dhe “analizat” e gazetave, “Veçer”, “Nova Makedonija” e “Flaka e Vëllazërimit” që kanë shkruar në shkurt-mars të 1989 për grevën e Minatorëve në Stari Tërg ( 20-28 shkurt) dhe për ngjarjet që u zhvilluan pas saj në Kosovë.

E përditshmja “Veçer”<sup>50</sup> sipas Tanjugut boton një artikull me titull – Situata gjithnjë e më e rëndë” pas debatit kuvendarët në Kuvendin e RSFJ-së për mosrealizimin e Programit mbi Kosovën, ku në mes tjerash thekson se “Mardhëniet ndërnacionale dhe situata politike dhe e sigurisë në KSA të Kosovës është përkeqësuar së tepërmi, krahasuar me gjendjen që ishte kur u soll Programi për Kosovën si dhe Protestat masovike në tubimet dhe demonstratat të pjesëtarëve të kombësisë shqiptare në nëntor 1989, thellësisht ndikuan në përkeqësimin e situatës”.

---

<sup>48</sup> Alush Kamberi, *Përndjekjet e mëdha, Shkup, 1999, f.14-15*

<sup>49</sup> *Po aty, f.16*

<sup>50</sup> *Revista Veçer, 17.02.1989, fq.2*

Për ngjarjet e grevës së minatorëve gazeta “Veçer” publikon lajmin në faqen e parë, më 22 shkurt 1989 me titull “Kosova përsëri në tension“ gjegjësisht në brendi të gazetës në faqe 3-4, ku në mes tjerash lexojmë: “Grevën fillimisht e nisën minatorët e ndërrimit të parë, të minierës së Stari Tërgut dhe me kalimin e kohës, arrinin lajme të shumta për ndërprerjen e punës në shumë organizata punuese. Në shumicën e organizatave punuese në Kosovë, është ndërprerë prodhimi dhe u organizuan tubime protestuese të punëtorëve nga kombësia shqiptare, të motivuar politikisht. “Epiqendra” e këtyre protestave të reja, si edhe shumë rasteve të tjera, ishte xeherorja e plumbit e zingut “Trepça” në Stari Tërg. Është e dukshme se këto revolta të reja, në mesin e punëtorëve, më të zëshëm janë personat dhe grupet e njëjta, të cilët si edhe në tubimet e mëparshme të ngjashme, ishin më zhurmuesit. Grevat e tanishme politike në Kosovë, në shikim të parë spontane, duke gjykuar sipas gjitha gjasave, përsëri janë të parapërgatitura dhe të organizuara<sup>51</sup> – përfundon artikulli.

Gazeta “Nova Makedonia” – Organi i L.S.P.P. të Maqedonisë në vigjilje të grevës së minatorëve në Stari Tërg, në spikamë boton një artikull të gjatë “Derisa vazhdon diferencimi, në Gostivar ndëgjohe refrene nacionaliste nga Kosova“. Autorët në mes tjerash shkruajn: “Edhe sot, pas luftës disavjeçare intensive për çrrënjosjen e nacionalizmit dhe iredentizmit shqiptarë, në Komunën e Gostivarit edhe më tej përkeqësohen marrëdhëniet ndërnacionale. Autorët e shkrimit e përfundojnë artikullin me konstatimin se: “Në Komitetin Komunal dëshmojnë se luftën kundër nacionalistëve shqiptarë, munden ta fitojnë para të gjithëve, vetëm vetë shqiptarët. Vetëm atëherë kur ato do të flasin hapur, për këtë të keqe, do të mund të shthuret rrjeta e imët, të cilën ndër dhjetëvjeçarë e kanë ngritur nacionalistët në gjithë jetën e gjithmbarshme në Komunën e Gostivari do të jetë qytet për lakmi të marrëdhënieve ndërnacionale, ashtu siç ishte dikur“ etj.

Në artikullin ”Vazhdon vala e protestave në Kosovë” thuhet: “Ndërprerja e punës dhe tubimet protestuese në shenjë solidariteti me punëtorët e Minierës së Stari Tërgut, të cilët nga zgafellat nuk po dalin tashmë tri ditë dhe përkrahja e kërkesave që i parashtruan ata, po vazhdojnë në mbarë Krahinën e Kosovës. Në shumë mjedise refuzohet marrja e ushqimit të ngrohtë. Diçka pas orës 15, në shtëpinë e Rinisë “Boro Ramiz” u tubuan mbi 7 mijë student të cilët nuk e përfillën kërkesën e Kryetarit të Këshillit Ekzekutiv të Kuvendit të Kosovës, Nazmi Mustafës dhe të profesorit të tyre Suija Pupovcit për t’u kthyer në mësim”. Në faqen 5 të gazetës botohet informata “Dhoma Federative e Kuvendit të RSFJ -së miratoi

---

<sup>51</sup> Gazeta, ”Start” 23.02.1989 fq.13-Tanjug

konkluzat për realizimin e programit për Kosovën”- ku në mes tjerash kërkohet që më së voni, brenda një muaj, të vlerësojë ç’ka është arritur me detyrat e Programit dhe në bazë të saj, ta propozoj caktimin e përgjegjësive kolektive dhe individuale. U rekomandua që të njëjtën gjë në suazat e kompetencave vetanake të bëjnë kuvendet e komunave në Kosovës. Përgjegjësia duhet të caktohet për të gjithë ata të cilët nuk i realizojnë detyrat, ose këtë nuk e bëjnë plotësisht.

Gazeta “Veçer” në faqe të parë ka një foto nga greva e minatorëve në Stari Tërg të cilët gjashtë ditë refuzojnë të lëshojnë zgafellën. Në vazhdim janë artikujt: “Krizë arrin pikën e vlimit”; Stipe Shuvari dhe S. Millosheviq para aktivitet politik të Kosovës dhe punëtorëve të Stari Tërgut dhe Elektro-ekonomisë së Kosovës; Minatorët nuk heqin dorë nga kërkesat e tyre dhe vendosin një ultimatum të ri, Krahina thuajse është paralizuar nga tubimet greviste etj. Informon gjërësisht në artikullin “Krizë arrin pikën e vlimit”, sidomos për takimin e Shuvarit e Millosheviqit me aktivitet politik të Kosovës, ku nxirren disa përfundime: Rrjedha e ngjarjeve na çon në rrezikimin e rendit e qetësisë publike dhe rendit Kushtetues; Është i papranueshme çfarëdo kushtëzimi, nënvlerësimi dhe presioni, si dhe zgjidhja e situatës është në interes të drejtë dhe përparuese.

Gazeta “Veçer” gjithashtu tërësisht i kushtohet situatës në Kosovë. Në Artikullin “Stipe Shuvari” në xehëroren e Stari Tërgut – Asnjë nuk ka të drejtën e ultimatimit”, në mes tjerash thuhet: “Diçka pas 13.30 në minierën e Stari Tërgut arriti Stipe Shuvari – Kryetari i Kryesisë së KQ të LKJ, i shoqëruar nga Remzi Kolgeci dhe funksionarë të tjerë të Kosovës. Në bisedën që u zhvillua në ambientet e Xeherores nuk morën pjesë minatorët grevist, të cilët nuk pranuan të lëshojnë zgafellat e minierës. Drejtori i minierës, Buron Kavaja – shtoi se ka biseduar personalisht me 1300 minatorët, të cilët që 5 ditë janë në zgafellë dhe gjendja e tyre është e tillë, që refuzojnë të bisedojnë me atë dhe me Stipe Shuvarin. “Ato – vazhdoi Kavaja, kërkojnë vetëm realizimin e kërkesave të tyre, të cilat i paraqitën që në ditën e parë të grevës. Por, te minatorët ka mundësi të përhapet epidemia, nuk kanë kurrfarë kushtesh higjienike, ndihen mjaft të këputur dhe shpesh herë refuzojnë ushqimin”. Fjalë të ngjashme tha edhe Aziz Abrashi- Kryetari i Këshillit punëdrejtues i punëtorëve në “Trepçe“, i cili shtoi se i kishte shterur të gjitha mundësitë për t’i bindur minatorët të dalin nga zgafellat, por në këtë nuk ka pasur sukses. Ata janë të revoltuar tha Abrashi, sepse që nga nëntori e deri tani, askush nuk është përgjigjur për zgjedhjen e pozitës të vështirë që sot mbretëron në Krahinë.

*“Nuk më pëlqejn këto intonacione- tha Shuvari. Ju kërkua të vija dhe jamë këtu, por me cilin të bisedoj? Jam këtu e jam i gatshëm të takohem e të bisedoj me minatorët. Nuk frigohem t’ua them në sy të vërtetën, e cila ndoshta atyre nuk do t’u pëlqej. Asnjëri, pra edhe minatorët nuk kanë të drejtë të vëndojnë ultimatum në këtë vend“. Pas bisedimeve gati dy orë me minatorët, rreth orës 17.00, ata pranuan të bisedojnë me Shuvarin, i cili së bashku me ekipin e TV Prishtinës dhe një gazetari të “Tanjugut” zbritën në zgafellat e minierës. Edhe pas bisedës me Stipe Shuvarin në zgafellën e Stari Tërgut, minatorët grevistë refuzuan të dalin jashtë. Stipe Shuvari fuqishëm mbeti në qëndrimin se mitingjet dhe grevat s’mund t’i ndërrojnë udhëheqjet partiake. Për këtë ekzistojnë organe legale partiake dhe Statuti, tha ai. Me rastin e kërcënimit se minatorët do t’u drejtohen Kombeve të Bashkura, Shuvari tha: ”Në daç hidhërohuni në daç mos u hidhërohuni në mua, mendoj se kjo nuk është në rregull. Kjo flet se ju nuk i besoni Jugosllavisë“.*

Pasi që minatorët ndërhyjnë se fara e përçarjes në Jugosllavi është hedhur pikërisht nga KQ i LKJ-së, Shuvari u përgjigjet se shqiptarët në demonstratat e nëntorit brohoritnin “Jetën e japim Kosovën nuk e japim” duke harruar se Kosova nuk është vetëm e shqiptarëve. “Më s’kam se ç’tju them” tha pastaj Shuvari dhe ua përsëriti apelin minatorëve që të dalin nga zgafella në sipërfaqe, ta ndërpresin grevën dhe dramën që e tronditi Kosovën. Biseda përfundoi në një atmosferë mjaftë të rëndë.

Gazeta “Flaka” botoi **Deklaratën e Sindikatës së Sllovenisë për Kosovën**, me të cilën shprehin solidarizim të plotë me minatorët. Lidhur me ngjarjet në Kosovë, Kryesia e RS të Sllovenisë i dërgon telegram Kryesisë së RS të Serbisë dhe Kryesisë së KSA të Kosovës. Në telegramin shprehet brengosja e madhe e banorëve të Sllovenisë me rastin e grevës së urisë të minatorëve të “Trepçës” dhe me zhvillimin e ngjarjeve, të cilat po ashpërsojnë marrëdhëniet ndërnacionale dhe thellojnë krizën politike në Krahinë e në mbarë vendin.

Në faqet e shtypit në Maqedoni në këtë periudhë, lexojmë informacione dhe artikuj të ndryshëm, si: “Pas ngjarjeve të fundit në Kosovë – **Miting protestues në Beograd e Shkup**. Në mitingun e Beogradit u kërkua dorëheqja e Stipe Shuvarit dhe Sh. Koroshecit. Të emërohen organizatorët e demonstratave të nëntorit në Kosovë, të mos përkrahët dorëheqja e R. Morinës e H. Azemit dhe A. Shukriut. Edhe vëllezërit e vegjël të serbëve, sllavomaqedonët pa humbur kohë me bekimin e **KQ të LK të Maqedonisë** organizuan Tubimin e Studentëve të Universitetit të Shkupit, më 28 shkurt. Rreth 5000 studentë të Universitetit Kiril e Metodi të tubuar në platonë



para Fakultetit Juridik në Shkup, si pasojë e situatës së re të krijuar në Jugosllavi, kërkuan që të mbisundojë arsyeja... Midis të tubuarëve dalloheshin këto pankarta: “Mësojmë, punojmë, e nëse duhet do të luftojmë”, “Përgjegjësi për të gjithë ato që na ndanë”, “Nuk duam shantazh”, “Turpëroheni sllovenë” etj.<sup>52</sup>.

Në artikullin e parë “Zëri i arsyes qorton”<sup>53</sup> të Rexhep Zllatku thuhet: “Drama Kosovare e gjatë tetë vjet dhe e gjërë sa Jugosllavia, këto ditë ngriti në këmbë mbarë vendin tonë, të gjithë kombet dhe kombësitë tona”<sup>54</sup>. Ky shqetësim e kjo brengosje janë fare të kuptueshme, sepse në një pjesë të vendit u rrezikua integriteti i tij. Nacionalizmi dhe separatizmi shqiptar, i ushqyer edhe me dyftyrësinë politike, i acaroi sa s’bëhet marrëdhëniet ndërnacionale. Atij i shkoi ndoresh të krijojë një përçarje të paparë, të tendos gjendjen, të mos lërë skutë të kësaj treve pa lagur me benzinë dhe të përgatitet t’ia japë flakën mbarë Kosovës. Në këto çaste kritike Jugosllavia e bashkuar e Titos mori hapa vendimtare, hapa të cilët ishin të detyruar t’i ndërmarrë për të mbrojtur rendin kushtetues dhe fatin e kombeve e të kombësive të vendit, para të gjithë shqiptarëve, serbëve, malazezëve e të gjithë të tjerëve që ngjajnë në këtë Krahinë.

Është krejtësisht e natyrshme që masat e posaçme u përkrahën nga të gjithë edhe në R. Maqedonisë janë të shumta shkaqet e kësaj indinjate: “nacionalizmi shqiptar vepron edhe në RSM, ai është i ndërlidhur me veprimin e këtij nacionalizmi në Kosovë e më gjërë. Hendeku ndërnacional duhet të rrafshohet dhe do të rrafshohet me zbatimin e politikës së LKJ-së si e vetmja rrugëdalje, përfundon komentin kryeredaktori Rexhep Zllatku”<sup>55</sup>

---

<sup>52</sup> “Flaka”, 01.03-1989.

<sup>53</sup> “Flaka”, 01.03.1989

<sup>54</sup> “Flaka”, 01.03.1989

<sup>55</sup> Gazeta Lajm 24.02.2012 f. 29

### 1.11. Shpallja e Kosovës Republikë e pavarur

Në kushtet e okupimit serb, më 2 korrik 1990 deputetët e KSA të Kosovës të ndaluar të hynë në godinën zyrtare, e lexuan deklaratën e pavarësisë, duke e shpallur kështu Kosovën Republikë, anëtare të federatës Jugosllave<sup>56</sup>. Shpallja e pavarësisë u pasua edhe me miratimin e Kushtetutës më 7 shtator të po atij viti<sup>57</sup>. Mirëpo në pamundësi për të ushtruar pushtet efektiv dhe e përndjekur nga forcat okupatore serbe, qeveria e Kosovës u largua në ekzil në Gjermani. Në këto procese rol kyç luajtën forcat politike të Kosovës që sapo ishin themeluar në veçanti Lidhja Demokratike e Kosovës. Pak më vonë më 1991 u zhvillua Referendumi mbarëpopullorë që zyrtarisht e shpalli Kosovën të pavarur dhe sovrane. Menjëherë pas referendumit Kuvendi i Republikës së Kosovës në pajtim me këshillin koordinues të partive politike në Kosovë formoi qeverinë e përkohshme të koalicionit tetor 1991, një hap më tej u bënë zgjedhjet presidenciale të organizuara me 24 maj 1992. Në ngritjen e institucioneve paralele LDK-ja fitoi një rëndësi të veçantë<sup>58</sup>. Pas zhvillimit të këtyre proceseve kryetari i Lidhjes Demokratike u zgjodh Ibrahim Rugova edhe kryetarë i Republikës së Kosovës i cili zgjodhi rrugën e rezistencës paqësore për të arritur deri tek pavarësia e shtetit të Kosovës. Gjendja e popullsisë shqiptare në Kosovë gjatë viteve të 90-ta mbeti jashtëzakonisht e vështirë. Gati të gjithë të punësuarit në sektorin publik u dëbuan, u mbyll universiteti dhe shkollat e mesme në gjuhën shqipe, poashtu edhe shtypi e radiotelevizioni në gjuhën shqipe u mbyll. Për tu përballuar me këtë sfidë shqiptarët lëshuan shtëpitë e tyre për të zhvilluar arsimin dhe ndihmuan hapjen e klinikave mjekësore. Ndërkohë u burgosën, u keqtrajtuat e u vranë me mijëra shqiptarë, ndërsa me qindra e mijëra u detyraun ta lëshojnë vendin dhe të kërkojnë ekzil në Evropën perëndimore<sup>59</sup>.

---

<sup>56</sup>Stavileci Esat, *Kosova dhe shqiptarët-ndërmjet kërcnimeve të brendshme dhe premtimeve të jashtme*, Prishtinë, 1991, f.24

<sup>57</sup>Eva Hyskaj Tafili- *Tranzicioni politik në Evropën qendrore dhe lindore*, Tiranë 2008, f.110

<sup>58</sup>Ashsh *VEPËR E CITUAR* faqe 19.

<sup>59</sup>Revista *ekskluziv Dosja-K*, Prishtinë 2001, f.40

## 1.12. Deklarata Kushtetuese

Deklaratë Kushtetuese-Për Kosovën si njësi të pavarur dhe të barabartë të federatës (konfederatës) së Jugosllavisë dhe si subjekt i barabartë me njësitë e tjera në Jugosllavi.

Me këtë deklaratë shprehet dhe shpallet qëndrimi burimor kushtetues i popullsisë së Kosovës dhe i këtij Kuvendi, si akt i vetëvendosjes politike në kuadër të Jugosllavisë;

Ky Kuvend, duke e shpallur nga ana e tij dhe në nivel të tij Kosovën si njësi të barabartë në Jugosllavi, mbi bazë të parimeve të demokracisë autentike, për respektimin e vullnetit të njerëzve dhe kolektiviteve njerëzore dhe kombëtare, pret konfirmimin e aktit konstituiv të tij në Kushtetutën e Jugosllavisë me mbështetje të plotë të opinionit demokratik në Jugosllavi dhe të opinionit ndërkombëtar.

Ky Kuvend, Kosovën dhe pozitën e re kushtetuese të saj e konfirmon si bashkësi politike-kushtetuese të përbashkët të qytetarëve dhe të nacionaliteteve të barabarta të Kosovës, ku shqiptarët, si shumicë e popullsisë së Kosovës dhe një ndër popujt më numerik në Jugosllavi, si dhe serbët e tjerë në Kosovë, konsiderohen popull-komb dhe jo kombësi (pakicë kombëtare).

Ndërkohë, deri në aplikimin definitiv juridik të kësaj Deklarate Kushtetuese, Kuvendi dhe organet e pushtetit të Kosovës, marrëdhëniet e tyre në rendin kushtetues të Jugosllavisë, i mbështesin në Kushtetutën në fuqi të Jugosllavisë dhe jo në amendamentet e Kushtetutës të RS të vitit 1989, me këtë rast bëhet edhe anulimi i vendimit të Kuvendit të Kosovës i datës 23 mars 1989 mbi dhënien e pëlqimit mbi këto amendamente.

Kuvendi i Kosovës, deri në nxjerrjen e Kushtetutës së Kosovës, tash e tutje do të komunikojë publikisht me këtë emërtim, duke emërtuar njëkohësisht bashkësi shoqërore politike, organ i së cilës është vetëm si Kosovë<sup>60</sup>.

Njësitet speciale të Serbisë të armatosura deri në dhëmbë, rrethuan ndërtesën e Televizionit të Prishtinës dhe sulmuan duke u futur brenda lokaleve të tij me forcë. Një akt të tillë dhune mbi median kryesore në Kosovë bëri jehonë të jashtëzakonshme në botë. Pamjet e pakta filmike, që u shfaqën në televizionet e botës, tregonin aksionin barbar të Serbisë mbi Televizionin e Kosovës: Arrestimi i kameramanit Lulëzim Shasivari në derën e Televizionit, hyrja me armë në studion e transmetimit, shkyçja e kablllove të stabilimenteve. Pastaj kërcënimet me armë ndaj gazetarëve,

---

<sup>60</sup>Revista "Ekskluziv-Dosja K", Prishtinë, 2001.

redaktorëve, regjisorëve, montazhierëve, moderatorëve nëpër studiot e përgatitura për realizime emisionesh dhe në fund, flakja e të gjithë atyre në rrugë. Nga puna u larguan 1300 punëtorë, sa kishte Televizioni, Radioja dhe Produksioni, më 1990.

Ekrani i TVP-së u errësua dhe i tillë mbeti, për 9 vjet me radhë.

Më 7 shtator 1990, në Kaçanik, u mbledhën delegatët e Kuvendit të Kosovës dhe mbajtën mbledhjen historike për shpalljen e Kosovës Republikë dhe nxjerrjen e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe dokumenteve tjera përcjellëse juridike.

Mbledhjen e kryesuan: Iljaz Ramajli, Qemal Sahatçiu, nënkryetar i kryesisë të ish Kuvendit të mëparshëm, Halit Muharremi, sekretar i ish Komisionit Kushtetues të Kosovës dhe Maliqe Bojku, delegate.

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës u zgjodh Iljaz Ramajli<sup>61</sup>.

Në Prishtinë u mbajt një takim me përfaqësuesit e partive politike të Kosovës, me përfaqësuesit e Parlamentit të Sllovenisë. Shqiptarët e thanë prerë mendimin dhe qëndrimin e tyre: ose njësi e barabartë federale, ose do të vendosim vetë.

Duke u mbyllur viti 1991 e duke u hapur viti 1992, në Prekaz të Ulët, ndodhi ngjarja që do të tërhiqte vëmendjen e opinionit përfundimisht nga qendra e Kosovës, Drenica. Deri në fund të vitit 1992 rreth 82% të institucioneve shëndetësore u goditën rëndë nga pushimi prej pune 2000 mjek dhe personel tjetër mjekësorë<sup>62</sup>.

Në fakt, ç'kishte ndodhur në Prekazin e ulët, ku pikërisht para dhjetë vjetësh 1981, po në atë vend, Tahir Mehaj kishte vlarë 5 policë serbë të njësisë speciale, në betejën e njohur brenda kullës së tij, deri në flijim.

Më 30 dhjetor 1991, policia, në përcjellje edhe të reparteve të ushtrisë jugosllave, rrethoj Prekazin e Ulët, shtëpinë e Shaban Jasharit. Madje, kjo forcë e jashtëzakonshme, kishte në përbërje edhe helikopterë. Rrethimi u bë për shkak të dëshirës për të zënë e burgosur Adem Jasharin, kryengritës. Ai, vazhdimisht, e kishte kundërshtuar me forcë policinë serbe. Baza e organizimit shoqëror pas heqjes së autonomisë dhe mënjanimit të shqiptarëve nga qeverisja ishte ndërtimi i strukturave paralele politike dhe shoqërore. Në ngritjen e institucioneve paralele LDK-ja fitoi një rëndësi të veçantë<sup>63</sup>.

<sup>61</sup>Ismaili Osmani: "Partitë politike shqiptare dhe çështja e Kosovës 1989-1998", Prishtinë, 2001, faq.162.

<sup>62</sup>Rrullman Peter Hans; "Ikje masive." Tiranë 1997, fq. 46

<sup>63</sup>A.SH.SH. "Kosova nën vështrimin enciklopedik" Tiranë 1999.

Qeveria shqiptaro-kosovare, e cila më 1992 e kishte vendosur selinë e saj në Bon, përgjigjej për financimin dhe bashkërendimin e këtyre institucioneve. Emigrantët kosovarë dërgonin tre për qind të të ardhurave të tyre mujore në fondin e krijuar për këtë qëllim<sup>64</sup>.

Por, një pjesë e madhe e të hollave për financimin e strukturave paralele vinte nga vetë Kosova, ku për shqiptarët u krijua një sistem tatimor mbi bazën e të ardhurave. Sasia më e madhe e të ardhurave shkonte për financimin e sistemit të pavarur arsimor (rreth 90%). Më 1993, prej këtij fondi u financuan rreth 20.000 mësues, ligjërues dhe profesorë për arsimimin e 317.000 nxënësve dhe 12.000 studentëve.

Në maj të po atij viti në Beograd u mor vendimi që të mbyllej gjysma e shkollave të mesme dhe të pushoheshin nga puna 6.000 mësues shqiptarë. Kur në fillim të vitit shkollor 1991-1992 shumë shqiptarë u përjashtuan nga shkollat e Kosovës, në krahinë u zhvilluan protesta të ashpra dhe greva.

Ajo që nga shumë vëzhgues u quajt si një rezultat i madh i angazhimit qytetar dhe shoqëror, nga ana tjetër u kritikua ashpër. Shqiptarët u akuzuan se po tërhiqeshin tërësisht në institucionet e tyre dhe duke përforcuar përmbajtjen kombëtare në mësimdhënie, po përforconin edhe veçimin nga serbët dhe malazezët.

---

<sup>64</sup>Petriç Wolfgang-Pihler Robert: "Rruga e gjatë në luftë-Kosova dhe Bashkësia ndërkombëtare 89-99", Prishtinë 2002,faq 65.

### 1.13. Prezenca e diplomacisë ndërkombëtare në Kosovë

Pas shpalljes së deklaratës kushtetuese të kuvendit të Kosovës (1990), pasuan reagimet e diplomacisë perëndimore, në radhë të parë të asaj amerikane. Senati amerikan miratoi rezolutën mbi shkeljet e të drejtave të njeriut të kombësisë shqiptare në Jugosllavi, me të cilën” shprehet brengosja” dhe kërkohet nga qeveria Jugosllave dhe qeveria serbe që të ndërpresin përdorimin e forcës në Krahinën e Kosovës dhe të mbrojnë të drejtat themelore dhe liritë demokratike. Kërkohet gjithashtu që Qeveria Jugosllave t’i hulumtojë rastet e vrasjeve të qytetarëve nga forcat policore<sup>65</sup>.

Në konferencën për dimensionin njerëzorë të KSBE (Këshilli për Sigurim dhe Bashkëpunim Evropian) të mbajtur në Kopenhagë në qershorë të vitit 1990, shefi i delegacionit amerikan, **Maks Kampelman** tha se “bregos dhuna në Jugosllavi” dhe e këshilloi qeverinë e Jugosllavisë se problemet e Kosovës nuk do të zgjidhen pa dialog me organizatat demokratike shqiptare.

Në suaza të mbajtjes së Konferencës së KSBE-së për dimensione njerëzore në Kopenhagë KMLDNJ iu drejtua me anë të një memorandumit ku thuhet se „duke u nisur nga rëndësia e madhe që ka Konferenca e KSBE-së mbi dimensionin njerëzorë në Kopenhagë se çështjet e barazisë së minoriteteve do të tërhiqim vëmendjen tuaj sidomos rreth gjendjes së rëndë të krijuar në Krahinën e Kosovës, Jugosllavi të banuar kryesisht nga shqiptarët pas reduktimit drastik të autonomisë së saj për shkeljet masive të të drejtave dhe të lirive kolektive dhe individuale të shqiptarëve<sup>66</sup>. Në këtë Konferencë gjithashtu u diskutua në lidhje me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në Kosovë e cila ndodhi tre herë dhe gjatë shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme për të tretën herë u bënë edhe ndryshimet kushtetuese në Serbi, kur u rrënuar autonomia e Kosovës e cila ishte e garantuar me kushtetutën jugosllave të vitit 1974.

Nga qeveria Jugosllave kërkohet që të respektojë vullnetin politik të shqiptarëve në rregullimin Kushtetues të Jugosllavisë në pajtim me konventat ndërkombëtare për të drejtat e popujve për vetëvendosje dhe të garantojë realizimin e kësaj të drejte në formën e proceseve

<sup>65</sup>*Ndreca Mikel 87 vjet terror dhe gjenocid shtetërorë (1912-1999), Prishtinë 2001 f.309*

<sup>66</sup>*Rilindja 20.06.1990 f.3*

demokratike pluraliste në Evropë. U kërkua gjithashtu nga Qeveria Jugosllave që menjëherë të ndërpritet represioni policor që Serbia ushtronte në Kosovë edhe pas heqjes së gjendjes së jashtëzakonshme me përkrahjen e qeverisë Jugosllave. Njëkohësisht u kërkua që të formohet një komision ndërkombëtarë nga Këshilli i Evropës i cili drejtpërdrejt do të verifikonte se gjendja në Kosovë është e këtillë siç është prezantuar në këtë memorandum<sup>67</sup>.

Departamenti amerikan më 30 qershor, pasi shpreh shqetësimin për gjendjen e rëndë të krijuar dhe tensionet në Kosovë konstaton se zgjedhja nuk mund të bëhet me kërcënime<sup>68</sup>.

Senatori amerikan, **Lary Presler** pasi dëgjoi për shpalljen e Kosovës subjekt të pavarur e dhe demokratik i shkroi një letër sekretarit amerikan të shtetit, **Xhejms Bejker** dhe kërkoi që Qeveria amerikane të gjejë mënyrën dhe ti japë përkrahje aktit të pavarësisë dhe lëvizjes së fuqishme demokratike në Kosovë, si dhe mundësinë që qytetarët e Kosovës të vetëqeverisin. **Rezoluta e parë** që u paraqit para Dhomës së përfaqësuesve të Kongresit Amerikan është rezoluta e **nëntorit 1991**, e sponsoruar nga senatori **Alfonso d'Amato** dhe kongresisti **Lari Presler**. Kjo rezolutë në një mënyrë “ndërpret kontinuitetin” e “trembëdhjetë rezolutave të para” (1986-1991), sa i përket njohjes së mëtejme të RSFJ-së.

Rezoluta D'Amato-Presler shtron qasjen e re ndaj hapësirës së ish-Jugosllavisë<sup>69</sup>.

Në vitin 1992, para Dhomës së Përfaqësuesve të Kongresit Amerikan u paraqit vetëm një projekt-rezolutë e veçantë për Kosovën, kjo ishte Rezoluta -21 e sponsoruar nga Kongresmeni Tom Lantosh. Kërkesa e kësaj Rezolute ishte “**Njohja e Republikës së Kosovës nga ana e Presidentit të SHBA-ve**”<sup>70</sup>.

Kërkesa për “njohjen e Republikës së Kosovës” arsyetohej me faktin se Kosova është përcaktuar si sovran në Konferencën e parë nacional-çlirimtare e mbajtur më 1 janar të vitit 1944, si dhe me Kushtetutat e RSFJ-së të vitit 1946 dhe të vitit 1974, si njëri nga konstituentët e federatës Jugosllave. Serbia shkatërroi autonominë më 23 mars të vitit 1989 pa pëlqimin e popullit të Kosovës, ndërsa Kuvendi i Kosovës më 2 korrik të vitit 1990 proklamoi Republikën e Kosovës dhe aprovoi Kushtetutën e Republikës së Kosovës më 7 shtator të vitit 1990 duke u bazuar në parimin e vetëvendosjes, barazisë dhe sovranitetit.

---

<sup>67</sup>Po aty

<sup>68</sup>Ndreca Mikel Vepër e cituar- f.309

<sup>69</sup>Reka Blerim Kosova në dokumentet e Kongresit Amerikan (1986-1995), Prishtinë 1995 f.95

<sup>70</sup>Reka Blerim Vepër e cituar f.97

Kjo rezolutë kërkonte garantimin e të drejtave dhe të lirive të njeriut sipas standardeve ndërkombëtare dhe mbështetej në parimin se të gjithë popujt kanë të drejtën që plotësisht të lirë të vendosin për statusin e tyre politik të brendshëm e të jashtëm<sup>71</sup>.

Parlamenti Evropian në Strasburg miratoi më 13 korrik një rezolutë me të cilën dënon shpërndarjen e Kuvendit të Kosovës, kontrollin e pushtetit të Serbisë mbi mjetet e informimit në gjuhën shqipe dhe kërkoi pezullimin e menjëhershëm të masave të jashtëzakonshme në Kosovë.

**Parlamentarët Evropian** kërkuan që të respektohet kushtetuta e vitit 1974, kurse dhoma e Përfaqësuesve të **Kongresit Amerikan miraton Rezolutën për Kosovën** me të cilën i bëhet thirrje Qeverisë së Kosovës që të ndalë dhunën, frikësimin dhe përdorimin e forcës si dhe të zgjidhë krizën politike dhe ekonomike në Krahinë<sup>72</sup>.

Më 27 maj 1990 në Prishtinë një grup kongresistësh amerikanë si **Tom Lantos, Joseph Dio Guardi** u takuan me **Ibrahim Rugovën** dhe anëtarë të tjerë të kësaj partie, turma të mëdha njerëzish i prisnin, por edhe këtu policia i shpërndau me dhunë. Gjatë një interviste të dhënë për të përditshmen “Rilindja”, kongresisti amerikan Tom Lantos tha “**Do të interesohemi deri në fund për Kosovën**”<sup>73</sup>. Kjo vizitë e kongresistëve amerikanë u cilësua nga Beogradi si një cenim i sovranitetit të Jugosllavisë dhe Serbisë.

Një vizitë tjetër e senatorëve amerikanë e cila do të nxjerr në pah qëllimin gjakatar të Beogradit dhe regjimin e Milosheviqit do të jetë vizita e senatorit **Robert Bob Dole**. Senatorin e prisnin një turmë e madhe e njerëzve të cilët gjenin një lloj mbështetje tek amerikanët, por edhe kjo turmë u keqtrajtua nga ana e policëve serb<sup>74</sup>. Në këtë rast u lënduan rëndë shumë pjesëmarrës dhe më pas u burgosën edhe shumë prej tyre me procedura të shpejta gjyqimi. Senatorët i këshilluan dhe ua tërhoqën vërejtjen liderëve shqiptarë që të jenë më të kujdesshëm dhe t’i shmangen çdo provokimi të serbëve<sup>75</sup>.

Në vitet vijuese dhuna serbe po rritej vazhdimisht në trojet e Kosovës, por në anën tjetër edhe **diplomacia ndërkombëtare ajo e SHBA-së dhe e Evropës** po rritej në mundësinë e gjetjes së një rruge për zgjedhjen e e përshtatshme të problemit për të dyja palët. Serbia kishte adoptuar Armatën Jugosllave me 70% në përbërje serbe e malazezë, për nënshtrimin e popujve të

---

<sup>71</sup>Reka Blerim Vepër e cituar f.97

<sup>72</sup>Ndreca Mikel; 87 vjet terror dhe gjenocid shtetërorë (1912-1999): Prishtinë 2001 f.310

<sup>73</sup>Ndreca Mikel; Vepër e cituar- f.310

<sup>74</sup>Gllareva Fitim "Diplomacia amerikane në konfliktin e Kosovës 1989-1999 ., Prishtinë 2004 f.95

<sup>75</sup>Po aty: f.311



tjerë të Jugosllavisë. Serbia nuk pranonte më biseda me shqiptarët, por edhe me diplomacinë perëndimore për çështjen e Kosovës<sup>76</sup>.

*Mbi ngjarjet në Kosovë reagoi edhe Amnesty Internatioanl* - e cila theksoi se kriza politike dhe ekonomike në Kosovë u thellua, në shkurt pati greva masive të shqiptarëve etnik, së paku 4.500 njerëz janë burgosur për shkaqe politike<sup>77</sup> gjatë vitit 1989.

Shumica e të arrestuarëve ishin shqiptarë etnik, prej këtyre 1.700 ishin të burgosur të ndërgjegjes e nga të cilët afër 1.000 u burgosën deri në 60 ditë burg për pjesëmarrje në protestat e qeta dhe në grevat që ndodhën në Krahinë gjatë shkurtit<sup>78</sup>. Së paku 27 njerëz u vranë dhe më shumë së 1.000 u burgosën gjatë demonstratave në mars, nëntorë dhe dhjetor, që u bënë nga shqiptarët etnik të cilët protestonin kundër ndryshimeve kushtetuese. Të burgosurve poashtu u është mohuar e drejta për gjykim të drejtë dhe sipas deklaratave të të burgosurve bëhet e ditur se të burgosurit janë keqtrajtuar. Poashtu bëhet e ditur se nga keqtrajtimi një person ka vdekur në rrethana të paqarta<sup>79</sup>. Trajtimi në burgje ishte i nivelit shumë të ulët, por dhe kushtet e burgut poashtu e rëndonin gjendjen e të burgosurve. Amnesty International ka ndikuar në lirimin e të burgosurve të ndërgjegjes si dhe në ndalimin e praktikës së izolimit që përdorej në ato vite.

Pas gjendjes më të re të krijuar në Kosovë me rastin e suspendimit të Kuvendit të Kosovës nga ana e Serbisë FKADNJ i bëri këtë apel administratës së Xhorxh Bushit në lidhje me veprimet e fundit nga ana e qeverisë Serbe, të cilët po sforconin konfrontimin mes shqiptarëve etnik në Krahinën e Kosovës me Jugosllavi dhe forcave serbe që kontrollonin këtë rajon. Anëtarët e fondacionit kongresial për të drejtat e njeriut i bëjnë apel administratës së Bushit që të shpreh shqetësimin e madh se aktet armiqësore që ka ndërmarrë qeveria Serbe mund të çojnë në shkatërrimin e Jugosllavisë. Anëtarët e Kongresit bëjnë thirrje për një rishqyrtim të politikës amerikane ndaj Jugosllavisë duke futur kriterin e të drejtave të njeriut në përcaktimin e politikës amerikane<sup>80</sup>. Anëtarët e Kongresit gjithashtu do të shprehin shqetësimin e tyre se me çthurjen e Jugosllavisë do të destabilizohet rajoni e Ballkani, do të çojë drejt konflikteve etnike.

---

<sup>76</sup>Ndreca Mikel; 87 vjet terror dhe gjenocid shtetërorë (1912-1999): Prishtinë 2001 faq 273

<sup>77</sup>Një organizatë prestigjioze ndërkombëtare për të drejtat e njeriut

<sup>78</sup>Rilindja 22.07.1990 f.6

<sup>79</sup>Po aty

<sup>80</sup>Rilindja 12.07.1990 f.4

Edhe shqiptarët në këto situata u përpoqën që të bëjnë diplomaci, në maj të vitit 1990 Dr. Ibrahim Rugova shkoi në SHBA për një vizitë dhe iu organizua një pritje e “rangut të lartë”. Ai këtu mori zotime të forta se do t’i ndihmohet Kosovës dhe popullit shqiptarë për një zgjidhje paqësore të çështjes së Kosovës<sup>81</sup>.

#### **1.14. Konferencat ndërkombëtare për ish-Jugosllavinë**

Në gusht 1992, në Londër, nën drejtimin e OKB-së, u zhvillua një konferencë për Jugosllavinë e organizuar nga vendi mikpritës, në të cilën përveç palëve ndërluftuese, morën pjesë edhe shumë përfaqësues të BE-së dhe OKB-së. Në të ishte ftuar edhe një delegacion i nivelit të lartë nga Kosova, por anëtarët e tij nuk u lejuan të merrnin pjesë drejtpërdrejt në Konferencë. Kosovarët i drejtuan një memorandum Konferencës, ku kërkonin trajtimin e Kosovës në mënyrë të barabartë me njësitë e tjera konstitutive të Federatës Jugosllave<sup>82</sup>. Në të theksohej se heqja e autonomisë së krahinës kishte qenë një akt antikushtetues, ndaj të cilit kosovarët kishin reaguar me vetëpërbajtje dhe në kuadër të ligjeve ekzistuese. Por me vazhdimin e shkëljes së të drejtave të tyre politike dhe njerëzore nga ana e regjimit serb, shqiptarëve të Kosovës nuk u kishte mbetur rrugë tjetër përveç pavarësisë politike. Kosova i përmbushte të gjitha parakushtet juridike për t’iu njohur e drejta e vetëvendosjes. Këto parakushte e përligjinin trajtimin e Kosovës në mënyrë të barabartë me republikat e tjera të ish-Jugosllavisë në kuadrin e konferencës.

**Por sipas pikëpamjes së bashkësisë ndërkombëtare BE-së dhe SHBA-së** gjendja paraqitej ndryshe. Dy krahinat autonome, Kosova dhe Vojvodina, nuk ishin njohur si pjesë sovraane të Federatës jugosllave dhe për këtë arsye nuk u njohën si palë në çështjen e trashëgimisë së Jugosllavisë. **Ky vendim bazohej në përfundimet e të ashtuquajturit Komision i Badinterit**, i cili u krijua nga BE-ja më 1991 për sqarimin e çështjes së trashëgimisë shtetërore të Jugosllavisë. Sipas kriterëve të këtij komisioni, krahinave autonome, në ndryshim nga republikat, nuk iu njoh e drejta e shtetësisë. Ky përfundim rridhte nga arsyetimi i mëposhtëm.

Shpallja e njëanshme nga Sllovenia dhe Kroacia më 1991 dhe njohja e tyre ndërkombëtare u bënë precedentë në të mirë të së drejtës së vetëvendosjes. Në rastin e Jugosllavisë, ky vendim u

---

<sup>81</sup>Ndreca Mikel; *Vepër e cituar* faq 270

<sup>82</sup>Hasani Enver “*vepër e cituar*”, 43

përligj me faktin që, në bazë të Kushtetutës së RSFJ-së, republikave u njihej e drejta e shtetësisë. Sipas kësaj pikëpamjeje, në këtë rast nuk bëhej fjalë për shkëputjen e një pjese nga tërësia shtetërore, por për shpërbërjen e plotë të një federate. Por e drejta e vetëvendosjes iu njoh vetëm etniteteve që kishin statutin e kombit.

Edhe fakti që autonomia u hoq me dhunë dhe se që atëherë në krahinë të drejtat e njeriut u shkelën në mënyrë drastike nuk u mor parasysh në vendimin e komisionit.

Shqiptarët e pritën me zhgënjim të hidhur rolin që u ishte caktuar në Londër. Zhgënjyese ishin edhe përfundimet e bisedimeve jozyrtare për zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme. Në deklaratën e kryesuesve të Konferencës, Serbisë i kërkohet që të rivendoste të drejtat qytetare dhe kushtetuese të popullsisë së Kosovës dhe Vojvodinës. Veç kësaj kërkese të vakët u formua Grupi i posaçëm për Kosovën (**Kosovo Special Group**), i cili kishte për detyrë të ftonte të dyja palët për të marrë qëndrim për çështjen e statusit dhe në vijim t'ia hapte udhën procesit të bisedimeve mbi këtë çështje. **Grupi i posaçëm i kryesuar nga ambasadori gjerman Gert Ahrens**, e përqendroi vëmendjen në çështjet praktike, si mundësi për përmirësimin e kushteve të jetesës në Kosovë<sup>83</sup>.

Në Konferencën e Londrës u bë qartë qëndrimi i bashkësisë ndërkombëtare për çështjen e Kosovës, qëndrim i cili në vitet në vijim praktikisht do të mbetej i pandryshuar. Me shpërthimin e luftës në Kroaci dhe në Bosnjë e Hercegovinë ngjarjet e Kosovës kaluan në plan të dytë. Vetëm kur edhe në Kosovë shpërthyen veprimet e dhunshme dhe grupet militante radikale filluan të fitonin në terren ndaj përfaqësuesve të forcave të moderuara, Kosova u bë përsëri përparësi e politikës perëndimore. Deri atëherë kjo e fundit ishte mjaftuar me gjysmë zemre të kërkesës së Beogradit “të rikthente autonominë e krahinës në kuadër të Serbisë”. Ky qëllim duhej të arrihej me “dialog” dhe me marrjen e “masave të krijimit të besimit”. Në vijim ky fjalor do të gjendet në shumë deklarata të politikanëve perëndimor.

Nacional-shovinizmi serbomadh ishte lëshuar si kalë i tërbuar mbi të gjithë popujt e RSFJ-së. Pas disfatave që pësoi ai në Slloveni, në Kongresin e 14-të të jashtëzakonshëm të LKJ-së dhe pamundësisë për të kontrolluar gjendjen në Kosovë, vërshimi i egërsisë shoviniste nuk kishte të ndalur. I plagosur keq nga grushtet që i dhanë popujt, shovinizmi serb përgatitej të shkatërroj gjithçka që gjente përpara.

---

<sup>83</sup>*Qosja, Rexhep: "Çështja shqiptare, historia dhe politika". Tiranë, 1998, fq. 280*

***Kapitulli II***  
***Shkaqet e shpërbërjes së Jugosllavisë-Lufta në Slloveni,***  
***Kroaci dhe Bosnjë***

## 2.1. Shpallja e pavarësisë së Sllovenisë dhe Kroacisë

Jugosllavia socialiste u themelua nga komunistët jugosllavë, në Jajce të Bosnjë-Hercegovinës, më 29 nëntor, 1943. Ajo u ndërtua mbi baza të sistemit federal. Në krye të Jugosllavisë socialiste u zgjodh J. B. Tito, një komunist jugosllav me prejardhje kroate. Sistemin politik në këtë vend e drejtonte vetëm një parti politike, Lidhja Komuniste e Jugosllavisë. Pas vdekjes së Titos, në Jugosllavi filloi kriza e rëndë ekonomike dhe politike, e cila u bart edhe brenda Lidhjes Komuniste. Në janar 1990, u mbledh Kongresi i XIV i jashtëzakonshëm i Lidhjes së Komunistëve jugosllavë. Kongresi i zhvilloi punimet në atmosferë tensionesh të mëdha midis përfaqësuesve serbë nga njëra anë dhe atyre sllovenë e kroatë nga ana tjetër. Akoma pa i përfunduar punimet, Kongresi u shtur e me këtë u shtur edhe Lidhja e Komunistëve të Jugosllavisë. Delegacioni slloven i pari i lëshoi punimet e Kongresit. Me këtë kriza jugosllave hyri në fazën e saj përfundimtare dhe më tragjike. Pikërisht gjatë kësaj periudhe u legalizua sistemi i ri pluralist, u formuan partitë e shumta politike dhe u mbajtën zgjedhjet shumëpartiake në të gjitha njësitë federale të Jugosllavisë socialiste.

Në Slloveni dhe Kroaci, në zgjedhjet shumëpartiake, fituan forcat politike që angazhoheshin për shkëputje nga Jugosllavia. Në Slloveni, ato udhëhiqeshin nga Milan Kuçani, ndërsa në Kroaci nga Franjo Tuxhmani.

Zgjedhjet e para shumëpartiake, në Kroaci, u zhvilluan në fillim të vitit 1990. Në këto zgjedhje fitoi Bashkësia Demokratike Kroate - HDZ<sup>84</sup> në krye të së cilës ishte Franjo Tuxhman<sup>85</sup>. Me fitoren e saj, u konstitua parlamenti (Sabori) i Kroacisë, i cili miratoi një numër amandamentesh të Kushtetutës kroate, me të cilat u ndryshuan simbolet kroate. Pak nga pak rriteshin tensionet ndëretnike në Kroaci dhe situata sa vinte e ndërlikohej. Krahas vendosjes së pushtetit të ri kroat, që doli nga zgjedhjet parlamentare në Kroaci rritej edhe rrezistenca e serbëve të Kroacisë, të cilët nuk pranorin të bashkoheshin me pushtetin e ri kroat<sup>86</sup>. Duke i kundërshtuar vendimet e organeve më të larta të Kroacisë, udhëheqësit serb të Kroacisë, në qershor 1990, në Knin, thirrën “Konventën e Parë Serbe” dhe miratuan Deklaratën për sovranitetin dhe

<sup>84</sup> “HDZ” - Hrvatska Demokratska Zaednica (Bashkësia Demokratike Kroate).

<sup>85</sup> Franjo Tuxhman, në prill, 1990, u zgjodh kryetar i Bashkësisë Demokratike Kroate (HDZ)

<sup>86</sup> Jasmina Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, NewYork, 1998, 153.

autonominë e popullit serb të Kroacisë. Në gusht 1990, filluan luftimet e para. Policia kroate u përpoq të çarmatoste forcat rezerve të policisë serbe në Benkoc. Por, serbët e fshatrave përreth u tubuan dhe e shpërthyen stacionin policor, duke i marrë të gjitha armët. Autoritetet kroate u përpoqën t'i dërgojnë forcat speciale, por Armata jugosllave (APJ) i ndaloi këto përpjekje. Të mbrojtur nga Armata jugosllave, serbët e Kroacisë e realizuan referendumin për Autonomi dhe më 1 tetor 1990, u shpall Rajoni Autonom Serb i Krahinës.

Në fillim të vitit 1991 pushteti kroat në krye me Tuxhmanin përpiquej të organizojë një forcë ushtarake të veten, duke blerë armë jashtë vendit. Për këtë arsye udhëheqësit ushtarakë jugosllavë vendosën të vinin nën kontrollë të drejtpërdrejtë njësitë e Mbrojtjes territoriale kroate. Njëkohësisht, Armata jugosllave filloi të armatoste haptazi serbët e Kroacisë. Kjo i nxiti kroatët në demonstrata, të cilët në Split, më 6 maj 1991, e rrethuan komandën e Marinës jugosllave. Në rrëmujë e sipër policia kroate dhe Ushtria jugosllave shtinë kundër njëra-tjetrës<sup>87</sup>.

Shkëndijat e konfliktit të armatosur u shpërndanë edhe në Slloveni. Në Maribor shpërtheu një konflikt i hapur midis njërive të Mbrojtjes territoriale sllovene dhe Armatës jugosllave. Kjo e fundit nxorri tanket në rrugët e Mariborit, por kjo nxiti demonstrata të sllovenëve, ku u vra një qytetar. Pas këtij momenti e tërë Sllovenia u ngrit në këmbë.

Zhvillimi i ngjarjeve në Kroaci dhe Slloveni e përshpejtoi copëtimin e Jugosllavisë. Më 16 qershor 1991, Parlamenti i Sllovenisë e shpalli pavarësinë e Republikës së Sllovenisë<sup>88</sup>, ndërsa më 25 qershor, 1991 edhe Parlamenti i Kroacisë e shpalli Deklaratën e pavarësisë dhe sovranitetin e plotë të Republikës së Kroacisë<sup>89</sup>.

Një ditë pas shpalljes së pavarësisë së Sllovenisë njësitë speciale të saj në vendkalimet kufitare me Italinë, Austrinë dhe Hungarinë, i hoqën tabelat dhe flamurin e Jugosllavisë dhe i vëndosën tabelat dhe flamurin e Republikës së Sllovenisë. Afër vendkalimeve kufitare të Sllovenisë me vendet fqinje ishin vendosur njësitet e Mbrojtjes territoriale sllovene. Përpjekjet e Armatës jugosllave për t'i penguar këta procese nuk patën sukses. Prandaj, ajo i sulmoi njësitet e Mbrojtjes territoriale sllovene, gjë që nxiti shumë incidente në vendkalimet kufitare. Armata jugosllave u përpoq t'i vërë nën kontrollë aeroportet dhe ta izolojë Slloveninë nga bota. Ministri i Mbrojtjes i Republikës së Sllovenisë, Janez Jansha, deklaroi: “ *prej sot për Slloveninë fillojnë ditët e luftës, ngase për këtë kemi paralajmërim nga vetë Armata jugosllave, sipas planit*

---

<sup>87</sup>Po aty, 137

<sup>88</sup>Jasminka Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, New York, 1998, 137.

<sup>89</sup>Po aty, 159.

ushtarak të Armatës Popullore Jugosllave >BEDEM 91< por, ne dhunës do t'i kundërvihemi me dhunë”<sup>90</sup>. Sipas deklaratës së gjeneralit të Armatës Popullore të Jugosllavisë, Bllagoje Axhiq, vendimi për intervenimin e Armatës në Slloveni ishte marrë nga qeveria federale. Sipas tij, “Ishte dhënë urdhër për të pushtuar 137 pika përgjatë kufirit jugosllav, brenda territorit të Republikës së Sllovenisë dhe për të siguruar që shërbimet doganore kufitare të rifillonin detyrimet e tyre në pikë-kalimet e kufirit”<sup>91</sup>. Nuk ka dyshim se me këtë intervenim Armata jugosllave përpqej të rivendosë kontrollë mbi doganat federale dhe ta kthenin Slloveninë me forcë në kuadër të Jugosllavisë dhe në këtë mënyrë të paralizojnë përpjekjet tjera për shthurjen e Jugosllavisë. Por, njësitë e mbrojtjes territoriale sllovene i bllokuan garnizonet e ushtrisë jugosllave duke i paralizuar ata. Duke mos pasur rrugëdalje tjetër, Komanda e lartë ushtarake e Armatës jugosllave, më 18 qershor 1991, urdhëroi tërheqjen e të gjitha efektivave të ushtrisë nga territori i Republikës së Sllovenisë<sup>92</sup>. Shumica e këtyre efektivave ushtarake, siç do të shihet më vonë, u stacionuan në Kroaci dhe Bosnjë e Hercegovinë. Me largimin e Armatës jugosllave, Sllovenia u shkëput nga Jugosllavia. Nga ky moment filloi faza përfundimtare e shthurjes së Jugosllavisë socialiste.

Qarqet luftënxitëse serbe, nën udhëheqjen e Millosheviqit, me lehtësi “lejuan” shkëputjen e Sllovenisë, sepse kjo shkëputje do të nxiste edhe shkëputjen e njësive tjera federale, që do të shkaktonte luftën e përgjakshme. Ata qarqe, duke u bazuar në forcën ushtarake, nën komandën e të cilëve ishte edhe Armata Jugosllave, pikërisht luftën kërkonin si mjet për të vendosur raporte të reja shoqërore për një Jugosllavi të tretë, ku do të dominonin serbët.

Ndërkohë, udhëheqësi kroat, Franjo Tuxhman, punonte për të konsoliduar forcat e tij të armatosura, Gardën Popullore të Bashkuar. Stërviçet e saj ushtarake bëheshin në vende të fshehura, ndërsa armët silleshin përmes rrugëve sekrete. Me fillimin e luftimeve forcat ushtarake kroate u rritën shumë shpejt. Sipas >>Raportit të Politikave Strategjike të Mbrojtjes dhe të Punëve të Jashtme Amerikane<<, Gjermania i kishte shitur Kroacisë një numër të madh llojesh të ndryshme të armëve, si aeroplanë luftarakë MIG, raketa tokë-ajër dhe tanke të prodhimit të fundit<sup>93</sup>.

---

<sup>90</sup>Po aty, 13.

<sup>91</sup>Jasminka Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, New York, 1998, 138.

<sup>92</sup>Po aty, 139.

<sup>93</sup>Po aty, 140.

Luftimet në Kroaci vazhduan me intensitet të lartë, gjatë verës së vitit 1991. Sipas shembullit slloven edhe këtu u bllokuan garnizonet ushtarake të Armatës jugosllave. Mirëpo, për dallim nga Sllovenia, në Kroaci kishte mjaft serbë. Prandaj, kur policia kroate ngatërrohej me popullatën serbe, Armata jugosllave fitonte shkas për të ndërhyrë, me qëllim të mbrojtjes së popullatës serbe. Për një kohë të shkurtër mënyra e këtillë e të vepruarit në Kroaci u shkallëzua në luftë të vërtetë.

Në fillim të shtatorit 1991, Lord Peter Carrington<sup>94</sup>, në cilësinë e kryetarit të Konferencës Ndërkombëtare të Hagës, u përpoq të zgjidh kaosin që mbretëronte në Jugosllavi. Por, Konferenca përfundoi pa sukses.

Kah fundi i shtatorit 1991, filluan operacionet ushtarake të Armatës jugosllave drejt qytetit të Vukovarit. Sipas ekspertëve ushtarakë jugosllavë, ky qytet konsiderohej si “shtyllë kurrizore e ushtrisë kroate”. Revista e Armatës Popullore të Jugosllavisë, >>Narodna Armija<< shkruante se: “*Vukovari me dekada të tëra përgatitej të mbështeste depërtimin ushtarak gjerman nëpërmjet Danubit*”<sup>95</sup>. Edhe pse beteja për Vukovarin nuk kishte ndonjë strategji të veçantë ushtarake, sulmi kundër këtij qyteti vazhdoi për dy muaj rresht, duke e shkatërruar tërësisht atë qytet.

Në dhjetor 1991, u bombardua edhe Dubrovniku<sup>96</sup>, me ç’rast pjesa e vjetër e qytetit pësoi nga bombardimet e Armatës jugosllave. Bombardimi i Dubrovnikut shpaloste plotësisht përpara syve të botës marrëzinë dhe kapriciozitetin e plotë të luftës në Ballkan.

---

<sup>94</sup>Lord Peter Carrington, kryetar i Konferencës Ndërkombëtare të Hagës për Jugosllavinë, Jasmina Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, New York 1998, 144.

<sup>95</sup> >>Narodna Armija<<, 20 nëntor, 1991. (Marrë nga libri, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, New York, 1998).

<sup>96</sup>Jasminka Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, New York, 1998, 147.



## 2.2. Lufta në Bosnjë

Republika e Sllovenisë dhe e Kroacisë u njohën si shtete të pavarura. Por, njohja e tyre nga Komuniteti ndërkombëtar, e la Bosnjë-Hercegovinën në një situatë pa rrugëdalje. Presidenti i saj, Alija Izetbegović<sup>97</sup> u gjend përpara dy alternativave, të kërkonte pavarësinë ose t'i bashkohej Jugosllavisë së Millosheviqit. Në fakt, qysh në mars 1991, udhëheqësit serbë dhe kroatë, Millosheviqi dhe Tuxhmani kishin lidhur një aleancë të pashpallur kundër Bosnjë-Hercegovinës, në Karagjorgjevo<sup>98</sup>. Kjo marrëveshje ishte një komplot për ndarjen e Bosnjës dhe Hercegovinës.

Pas zgjedhjeve shumëpartiake në Bosnjë dhe Hercegovinë, në tetor 1991<sup>99</sup>, në parlamentin e saj përfaqësuesit myslimanë dhe kroatë aprovuan vendimin për shkëputjen e Bosnjë-Hercegovinës nga Jugosllavia. Por, me këtë vendim nuk u pajtuan përfaqësuesit serbë, të cilët u larguan nga parlamenti. Një muaj më vonë, udhëheqja e serbëve të Bosnjës organizoi referendum me popullatën serbe të republikës, më 9-10 nëntor 1991. Serbët e Bosnjë-Hercegovinës në referendum u deklaruan për të mbetur në Jugosllavi. Duke mos marrë parasysh referendumin e serbëve të Bosnjës, kryetari, Alija Izetbegović kërkoi nga Bashkësia ndërkombëtare njohjen e pavarësisë së Bosnjë-Hercegovinës. Por, Komuniteti Europian u përgjigj se do ta njohë Bosnjën e pavarur nëse populli i saj konfirmonte, me anë të referendumit për këtë vullnet. Andaj në shkurt 1992, myslimanët dhe kroatët, përmes referendumit votuan për pavarësinë e Bosnjë-Hercegovinës. Nga ky moment, tensionet në Bosnjë dita-ditës rriteshin. Më 1 mars 1992, në një lagje me shumicë myslimane, në një dasëm serbe shpërtheu konflikti. Në dasmë valëvitëshin flamujt serbë, ndërsa një njeri i armatosur qëlloi mbi turmën duke vrarë të atin e dhëndërrit dhe plagosi një dasmor. Kjo ishte shkëndija që i vuri zjarrin Bosnjë-Hercegovinës<sup>100</sup>.

---

<sup>97</sup> Alija Izetbegović, . *Ai promovonte idenë se Bosnja duhet të mbetet e bashkuar dhe ishte i mendimit se zgjidhja më e mirë do të ishte një qeveri e koalicionit, ku do të përfaqësoheshin të tri partitë ( të myslimanëve, serbëve dhe kroatëve).*

<sup>98</sup> Jasminka Udovički dhe James Ridgeway, *Makthi etnik i Jugosllavisë*, New York, 1998, 169.

<sup>99</sup> *Po aty*, 174.

<sup>100</sup> *Po aty*, 177.

Komuniteti European e njohu pavarësinë e Bosnjë e Hercegovinës më 6 prill 1992<sup>101</sup>. Njohja e pavarësisë së Bosnjë-Hercegovinës, e vuri Armatën jugosllave para faktit të kryer, si një forcë e huaj brenda territorit të saj. Mirëpo, në Bosnjë-Hercegovinë, serbët e kishin formuar parlamentin e tyre dhe Republikën serbe, në krye me Radovan Karaxhiqin. Banja Luka u shpall kryeqendra e Republikës serbe të Bosnjë-Hercegovinës. Ndërkaq, Armata jugosllave e stacionuar në Bosnjë-Hercegovinë u vu nën komandën e gjeneralit Ratko Mlladiq<sup>102</sup>. Ushtria e tij gjatë vitit 1992/93 arriti që të zotërojë rreth 70 % të territorit të Bosnjë-Hercegovinës.

Por, forcat e Republikës serbe të Bosnjës, nuk ishin e vetmja ushtri që luftonte në këtë shtet të pavarur. Aty luftonte edhe Këshilli Kroat i Mbrojtjes (HVO), si krah i Franjo Tuxhmanit dhe që mbante nën kontrollë shumë territore<sup>103</sup>. Më 5 qershor 1992, kroatët e Bosnjë-Hercegovinës, ngjajshëm sikurse serbët e shpallën Republikën e pavarur të Herceg-Bosnjës.

Ushtria e Bosnjë-Hercegovinës që luftonte për një shtet të bashkuar, ishte nën komandën e presidentit të Bosnjë-Hercegovinës, Alia Izetbegoviqit. Përpjekja për ta armatosur këtë forcë ushtarake, në vitet 1992/93, minohej nga embargoja e armëve, sidomos nga fakti se të gjitha rrugët, prej nga mund të kalonin armatimet e rënda, duhej të kalonin përmes Kroacisë. Megjithatë, gjatë vitit 1994, ushtria boshnjake u tregua shumë e organizuar dhe mori nën kontrollë shumë hapësira territoriale.

Lufta në Bosnjë e Hercegovinë mori përmasa të gjera. Ajo ishte tragjedia më e madhe që ndodhi me rastin e shthurjes së Jugosllavisë socialiste. Kjo luftë përfundoi me ndihmën e Bashkësisë ndërkombëtare me Marrëveshjen e Dejtonit.

---

<sup>101</sup>*Po aty*, 179.

<sup>102</sup>*Jasmina Udovički dhe James Ridgeway, Makthi etnik i Jugosllavisë, New York, 1998, 149.*

<sup>103</sup>*Po aty*.

### 2.3. Marrëveshja e Dejtonit

Marrëveshja e Paqes së Dejtonit (MD), e nisur në Dejton, Ohajo të SHBA-ve, më 21 nëntor 1995 dhe e nënshkruar në Paris, më 1 dhjetor të po atij viti, midis udhëheqësve të grupeve etnike Myslimane, Serbe dhe Kroate, i dha fund zyrtarisht luftës tre vjeçare në Bosnjë-Hercegovinë (BH).

Kjo luftë me karakter etnonacionalist e fetar, kulmoi përplasjet e tendencave etnonacionaliste dhe fetare që gjalluan fuqishëm në territorin multietnik të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë, me fillimin e shpërbërjes së saj në fillim të viteve '90, si pasojë e lëvizjeve separatiste të republikave ish jugosllave, për krijimin e shteteve kombëtare.

Për më tepër, në rastin e BH-së, këto faktorë u përforcuan, për shkak të karakteristikave të saj etnofetare dhe raporteve të krijuara për rrjedhojë me republikat fqinje. BH-ja, përse i përket etnive mbizotëruese, në mënyrë specifike përbëhej nga etnia e ashtuquajtur boshnjakomyslymane, krahas asaj serbe dhe kroate. Asnjë nga këto etni nuk mbizotëronete në mënyrë absolute nga pikpamja numerike. Konfiguracioni gjeo-etnik i BH-së ishte jashtëzakonisht heterogjen dhe territori i saj karakterizohej kryesisht nga zona të përziera etnike, sidomos ato urbane. Kjo situatë etnike, momentet shtetformuese dhe parimet etnonacionaliste, nxitën Kroacinë dhe Sërbinë të ngrinin pretendime territoriale mbi territorin e Republikës së BH-së.

Për rrjedhojë, në luftën në BH u përfshinë jo vetëm tre etnitë brenda territorit të BH-së, por dhe Republika e Serbisë në kuadrin e Federatës së Jugosllavisë, si dhe Republika Kroate.

Kjo luftë ishte e paparë në Evropë që prej luftës së dytë botërore për pasojat tragjike në aspektin human dhe material. Vetëm nën presionin e SHBA-ve dhe NATO-s, u arrit ndërprerja e luftës dhe nënshkrimi i marrëveshjes së paqes – Marrëveshjes së Dejtonit.

**Marrëveshja u hartua me qëllim garantimin e një paqeje afatgjate dhe hedhjen e bazave për riintegrimin e komuniteteve të përçara etnike në vend.**

Marrëveshja e Dejtonit përbehet nga dispozita ushtarake, politike dhe civile.

Në **aspektin e saj ushtarak** marrëveshja detyroi armëpushimin mes palëve ndërluftuese në BH dhe mundesoi angazhimin e forcave të NATO-s nën një mandat të papërcaktuar, në zbatimin e marrëveshjes (forca IFOR) dhe më pas stabilizimin e situatës në vend (forca SFOR).

Nga **pikpamja politike**, marrëveshja siguroi unitetin shtetërorë të BH-së (Republika e BH-së), të përbërë prej dy etniteteve – Federata Myslimano-Kroate (zyr. Federata e BH-së), e cila do të administronte 51% të territorit të BH-së dhe Republika Serbe (Republika Sërbska), e krijuar nga serbët e Bosnjës, e cila do të kontrollonte pjesën tjetër prej 49%. Marrëveshja formuloi një kushtetutë të re kombëtare e cila përcaktoi marrëdhëniet ndërmjet myslimanëve, serbëve dhe kroatëve, sanksionoi modelin e ri shtetëror, siguroi një qeveri kombëtare të strukturuar, sikurse kishte qenë në legjislacionin e mëparshëm – një presidencë gjithëpërfshirëse treantarshe, në përputhje me përbërjen kryesore etnike, një legjislaturë dydhomëshe qendrore dhe një qeveri qendrore me autoritet të kufizuar brenda vendit, me kompetenca të përqendruara në tregti dhe punët e jashtme. Marrëveshja siguroi përfaqesimin në pushtet të të tre kombësive, si dhe struktura shtetërore të shpërndara për të dy etnitetet. Të gjithë funksionet qeveritare, të pa përqendruara shprehimisht në qeverinë qendrore, iu përkisnin këtyre etniteteve. Marrëveshja, gjithashtu mundesoi zhvillimin e zgjedhjeve në të gjithë vendin, për t'i hapur rrugën normalitetit.

Në **aspektin civil**, marrëveshja përmbante dispozita në lidhje me ndihmën humanitare, rindëritimin ekonomik dhe nxitjen e të drejtave të njeriut. Si pjesë e këtyre dispozitave, të gjithë qytetarët, parashikohet të kenë të drejtën e lëvizjes së lirë në të gjithë vendin, refugjatët të drejtën për t'u kthyer në shtëpitë e tyre dhe subjektet politike të angazhoheshin të bashkëpunonin me Gjykatën Kriminale për ish-Jugosllavinë, për vënien para drejtësisë të të akuzuarve për krime lufte. OKB-ja caktoi një përfaqësues të posaçëm për të lehtësuar zbatimin e aspektit civil të kësaj marrëveshjeje.

**Efektiviteti i marrëveshjes u kushtëzua ndjeshëm prej konsideratave kontradiktore të palëve ndaj interpretimit dhe kuptimit të qëllimit të MD-së, konsiderata që përkonin me synime të pastra për ruajtjen e karakterit monoetnik të entiteteve që ato përfaqësonin, duke penguar efektin e saj paqtues dhe qëllimin e saj final për përfundimin e një BH-je me karakter multietnik, me siguri dhe stabilitet të qëndrueshëm dhe funksionale në aspektin politik, ekonomik dhe social.** Për rrjedhojë, ndërsa të tre palët e zbatuan komponentin ushtarak, zbatimi i komponentit politik dhe civil ka rezultuar problematik. Institucionet shtetërore qendrore janë të dobët në krahasim me ato të etniteteve, në pushtet kanë mbizotëruar rregullisht

forcat nacionaliste, qytetarët nuk gëzojnë të drejta të barabarta në të gjithë vendin, nuk ekziston liria e rrezidencës dhe nacionalistët serb e kroat, sidomos gjatë kohëve të fundit ata serb i kanë bërë rrezistencë riintegrit të komuniteteve të përçara nga lufta.

**Në aspektin politik** impakti i marrëveshjes lë shumë për të dëshiruar. Konfiguracioni politik në vend, karakterizohet nga dominimi i elementit nationalist ekstrem, çka kushtëzohet prej sensibilitetit të popullsisë ndaj interesave etnike, si rrjedhojë e pritshme e një konflikti etnik të egër dhe rrezikut të tij potencial, rolit udhëheqës, i elementit nationalist në mbrojtjen e këtyre interesave gjatë konfliktit të armatosur, si dhe presionit të faktorit të jashtëm po aq ekstrem në ekzigjencat nacionaliste (ndrydhja në darën serbo-kroate). Me gjithë presionin ndërkombëtar për ndërprerje të ndihmave ekonomike dhe mosmbështetje të mëtejshme të vendit në përmbushjen e prioriteteve në politikën ndërkombëtare, partitë nacionaliste kanë ruajtur pozitat e tyre në pushtet, duke arritur në përgjithësi rezultate të mira në zgjedhje në krahasim me partitë e tjera të përfaqësimit liberal, multietnik, apo demokratik, çka ka shkurajuar përhapjen e demokracisë civile në vend dhe ka ndihmuar konsolidimin e ndarjes etnike të vendit. Dominimi i faktorit politik nationalist në vend konsiderohet gjithashtu si një potencial i rrezikshëm pasojash për stabilitetin e vetë rrajonit. Vendi vazhdon ende të mbetet peng i strukturave triare që pengojnë seriozisht reformat drejt tranzicionit multietnik dhe ato drejt integritit Euro Atlantik.

**Në aspektin civil**, MD nuk duket të ketë impaktin e dëshiruar, megjithëse zbatimi i saj në këtë aspekt është përshpejtuar dy vitet e fundit. Në këtë aspekt MD ngrihet mbi një objekt jashtëzakonisht të komplikuar. Lufta dhe rrjedhojat e saj e transformuan realitetin etnoheterogjen të integruar të BH, në një realitet pothuaj etnohomogjen fragmentar. Rikonfigurimi etnik i mëparshëm - kthimi i refugjatëve – deri tani ka ndodhur në një masë të konsiderueshme, megjithëse jo të kënaqshme në ato zona ku pas luftës, përkatesia e tyre etnike është në minorancë. Procesi gëzon mbështetjen e deklaruar të forcave politike, por problematika e avancimit efektiv të tij qëndron më tepër në aspektin financiar. Autoritet lokale në përgjithësi kanë penguar këtë proces, ndërkohë që vërehet promovimi prej tyre i projekteve kulturore etnocentrike. Ndërkohë, pavarësisht dhe presionit ndërkombëtar, asgjë nuk është bërë lidhur me kërkesën për bashkëpunim të udhëheqësve të etnive me Gjykatën Kriminale për ish Jugosllavinë, për procedimin e të dyshuarve për krime lufte, të cilët vazhdojnë të mbeten të lirë.

**Në aspektin ekonomik**, MD lejoi realizimin e rimëkembjes ekonomike të BH, megjithëse kjo u realizua pothuaj tërësisht prej ndihmës ndërkombëtare. Megjithëse u arrit një farë

rimëkëmbje ekonomike, ekonomia e BH vazhdon të mbetet e pastrukturuar, me kapacitete prodhuese të ulta, e karakterizuar nga centralizimi, informaliteti, arbitrariteti dhe korrupsioni. Ndarja e vendit në dy etnitete autonome, ka sjellë një pengesë të madhe ndaj procesit të rimëkëmbjes ekonomike. Megjithë përpjekjet e qeverisë qendrore për efektivizimin e vendimarrjes në nivelin makroekonomik, në shumë aspekte të rëndësishme të jetës ekonomike, janë qeveritë e entiteteve që marrin vendime.

E parë nëpërmjet optikes së *status quo*-së si rrjedhojë e MD-së dhe efekteve të munguara të saj, perspektiva e BH-së, megjithë konsiderimin e deklaruar të faktorit ndërkombëtar për destinacionin euro-atlantik të saj në kuadrin e Europës Juglindore është tepër e papërcaktuar. BH aktualisht karakterizohet nga përçarja e theksuar etnike, produkt i së cilës është mbizotërimi i nacionalizmit politik ekstrem, i tendencave separatiste që nxitën direkt ose indirekt prej faktorëve nationalist rajonal, sidomos prej Serbisë me pretendime territoriale dhe frenimi i alternativave politike liberalo-multietniko-demokratike. Kjo përçarje duket të jetë përforcuar prej formatit shtetëror aktual të ofruar prej MD-se, me pesë nivele pushtetesh dhe pushtetit të fortë të etniteteve. Në këto kushte janë hedhur teza se MD është një marrëveshje e tejkaluar dhe si rrjedhojë duhet zëvendësuar.

Megjithë këto rezultate dhe vlerësime, deri tani MD ka garantuar një situatë paqësore në BH dhe kjo duhet parë me optimizëm. Nëse analizohen me kujdes proceset e stabilizimit të BH-së në kuadër të MD rezulton se në përgjithësi MD është një marrëveshje e domosdoshme për ecurinë e mëtejshme të proceseve demokratike dhe integruese në BH. Arritjet dëshmojnë se MD nuk duhet braktisur, por duhet shfrytëzuar më efektivisht dhe më energjikisht, ndërsa procesi i zbatimit duhet përshpejtuar. Mbi të gjitha duhet vullnet politik i brendshëm dhe një rol më i fuqishëm i komunitetit ndërkombëtar në BH. MD realisht i garanton hapësira të mjaftueshme këtyre dy faktorëve, të veprojnë në mënyre të suksesshme në drejtim të centralizimit pozitiv të strukturave qeverisëse, si dhe në drejtim të zbutjes së tensioneve etnike nëpërmjet promovimit të projekteve të bashkëpunimit komunitar dhe rregullimeve të nevojshme juridike. E rëndësishme është që MD duhet mbështetur, duhet nxitur, duhet shfrytëzuar. Çdo tentativë për të vepruar jashtë saj është e papranueshme madje e rrezikshme. Proceset integruese dhe prosperuese në BH janë të pakthyeshme dhe proceset drejt demokracisë multietnike duhet vazhduar. MD e garanton suksesin e tyre.

## **Kapitulli i III**

### **Maqedonia dhe pozita e popullit shqiptar**

### 3.1. Historiku i shkurtër i demokratizimit të Maqedonisë

Fundi i vitit 1989 ishte viti i shturjes së komunizmit, shturje kjo që do të flak tutje regjimet totalitare të Evropës Lindore pas katër dekadash shtypje. Pjesa më e madhe e këtyre popujve nuk e kishte pasur kurrë të mundur të merrte pjesë në zgjedhje demokratike e t'i shprehte lirshëm mendimet e veta. Me miliona njerëz u ndanë dhe për një kohë të gjatë nuk u panë edhe vëllai me vëllanë, me miliona njerëz jetonin gjithnjë nën frikën e policisë sekrete. Viti 1989 do të jetë shpresë për çlirim nga ky ankth, se do të fillojnë revolucionet spontane që nga Gjermania e deri në Shqipëri. Revolucionarët e vitit 1989 përbënin një kategori të përzier mes tyre, kishte komunist, reformatorë, shumë anakronistë, studentë, punëtorë, anëtarë të pakicave kombëtare të persekutuar, gjithashtu edhe njerëz që asnjëherë më parë nuk kishin marrë pjesë aktive në politikë. Brenda një kohe të shkurtër rrugët e tyre përsëri do të ndaheshin, por ata ishin të bashkuar në bindjen se për ta nuk kishte të ardhme, po të mos mposhtej rendi i vjetër. Kjo situatë revolucionare do ta gjej Jugosllavinë, e bashkë me të edhe shqiptarët në një pozitë krejt tjetër. Shqiptarët, ndryshimet që do të ndodhin në kampin socialist, do t'i presin me autonomi të suspenduar. Edhe kësaj radhe praktika socialiste nuk ishte treguar e drejtë duke lejuar aplikimin e parimeve që dilnin nga Internacionalja Komuniste<sup>104</sup>, sidomos atë të vetëvendosjes. Si Bashkimi sovjetik ashtu edhe Jugosllavia në brendi të vet mbanin të shtypur shumë popuj edhe atë josllov, si rusët ashtu edhe serbët udhëhiqeshin nga politika pansllaviste e hegjemonizmit sllav mbi popujt e tjerë. Prandaj rrethanat e reja që do të krijohen do t'u mundësojnë shkëputjen e popujve dhe krijimin e shteteve të pavarura.

Procesi i shturjes së Jugosllavisë edhe pse filloi nga Kosova, do të shfrytëzohet nga Sllovenia e cila më 25 qershor 1991 do të shpall pavarësinë e saj. Serbia e pezmatuar do ta sulmoj ushtarakisht Slloveninë më 1 korrik, por pas një kohe të shkurtër duke mos pasur interes, do të largohet për të vepruar në Kroaci.

Kroacia, si Sllovenia, edhe ajo më 21 maj 1991 mbajti referendumin për pavarësi. Në qershor do të shpall pavarësinë për t'u sulmuar ushtarakisht më 3 korrik nga Serbia. Në të njëjtën

---

<sup>104</sup> Uollter Laker, "Evropa në kohën tonë 1945-1992", Tiranë 1996, fq.441



mënyrë do të ndahen edhe Bosnja dhe Maqedonia. Derisa me Bosnjën konflikti do të jetë shumë i ashpër, me Maqedoninë do të ndahet shumë qetas dhe në mënyrë vëllazërore. Maqedonia është njëra nga shtetet e ish Jugosllavisë që fitoi autonominë në mënyrë të qetë e paqësore. Ushtria Jugosllave në bazë të marëveshjes për tërheqje paqësore u realizua pa ndonjë incident . Vlen të theksohet se edhe zgjedhjet e para pluraliste, shpallja e pavarësisë si dhe Kushtetuta e shtetit kaloi në mënyrë të qetë .<sup>105</sup>

Zgjedhjet e para parlamentare të vitit 1990 ishin edhe zgjedhjet e para shumpartiake në Republikën e Maqedonisë. Përbërja e parlamentit e dalë nga këto zgjedhje miratoi aktet themelore dhe ligjet kyçe për funksionimin e shtetit. Deklarata për sovranitetin e Maqedonisë (1991), vendimin për mbajtjen e referendumit për shtet Sovran dhe të pavarur, kushtetuta e Republikës së Maqedonisë, deklarata për njohje ndërkombëtare të Republikës së Maqedonisë .Me kushtetutën e vitit 1991 Republika e Maqedonisë definohet si shtet me sistem parlamentar të qeverisjes bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve. Sipas kushtetutës së Republikës së Maqedonisë, vendi nuk ka pretendime territoriale ndaj asnjë vendi fqinjë dhe sa I takon kësaj çështje ajo nuk pati asnjë konflikt me shtetet fqinje rreth kufijve. Megjithatë fqiu I saj jugor-Greqia do të bëhet një pengesë e vazhdueshme rreth pranimit të saj në OKB, edhe pse komisioni I Badenterit të BE-së bëntë thirrje për njohjen e shtetit ndërkombëtarisht.<sup>106</sup>

Kjo ndarje kaq e qetë len dyshimin mos vallë janë marrë vesh në mënyrë sekrete se edhe vetë përkufizimi i tekstit të referendumit kishte aneksin që sipas dëshirës shteti i ri mund të bashkohet me një shtet tjetër<sup>107</sup>.

Me shthurjen e Jugosllavisë populli shqiptar tani do të ngel i ndarë në mes tri republikave, asaj serbe, maqedone dhe malazeze. Si popujt që i përbënin këto republika që vetëvendosën për çështjen e demokracisë dhe të pluralizmit edhe shqiptarët, ndonëse me vështirësi dhe pengesa nga serbët dhe maqedonasit, të cilët assesi nuk mund të pajtoheshin me vetëvendosjen e shqiptarëve për demokraci e pluralizëm. Edhe pse në rrethana shumë të rënda politike, shqiptarët do të përqafojnë pluralizmin politik, që në thelb nënkupton lirinë e plotë politike dhe pavarësinë për të krijuar e anëtarësuar në parti të ndryshme politike. Por, për çfarë lirie mund të flitet, kur ato vite ishin vitet më të rënda për shqiptarët ku krahas tankeve e automatikëve u përdorën edhe helmet luftarake.

<sup>105</sup> Grup autorësh Ballkani i jugut Tiranë (2001), fq.61

<sup>106</sup> Shkariq S. "Parliamentarian elections in the Republic of Macedonia in 1990 and 1994,

<sup>107</sup> Po aty, fq.443

Me gjithë këto rrethana shumë të vështira, shqiptarët formuan disa parti politike si: Lidhjen Demokratike të Kosovës, Partia Fshatare, partia Social-Demokrate, partia Demokristiane dhe parti të tjera në Kosovë. Në Maqedoni u formuan dy parti, Partia për Prosperitet Demokratik dhe partia Demokratike Popullore, ndërsa shqiptarët e Luginës së Preshevës formuan Partinë për veprim demokratik. Gjithashtu, në Mal të zi u formua Lidhja Demokratike për Mal të Zi<sup>108</sup>.

Pikërisht, në kohën kur në Kosovë formoheshin partitë politike, kundër shqiptarëve ushtrohej dhuna e madhe, ku kishte me dhjetëra të vrarë dhe me qindra të plagosur. Në kohën kur shqiptarët formonin partitë politike e populli në to shihte udhërrëfyesit e bashkimit kombëtar, do të ndodhin tragjeditë më të mëdha në ish-Jugosllavi.

Kur e gjithë rinia shqiptare tentonte të bënte homogjenizimin e shqiptarëve, duke marrë aksionin e pajtimit të gjaqeve, që u shndërrua në një lëvizje mbarëpopullore, e në ballë të kësaj lëvizjeje do të vihen intelektualët e dalluar Anton Çetta dhe Zekiria Cana, themeluesit e partive të ndryshme shqiptare do të sanksionojnë ndarjen, që na e bënë sllavët.

Prej këtij momenti çështja shqiptare në Jugosllavi do të marr kahe tjetër. Më nuk do të kemi zgjidhje të përgjithshme të problemit shqiptar në Ballkan, po do të kemi zgjidhje parciale të çështjes shqiptare në republikat që do të dalin nga Jugosllavia.

Në Kosovë do të nis rruga e mëvetësimit të Kosovës, rrugë kjo e vështirë dhe me sakrificat të mëdha. Që në qershor të vitit 1989, Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës, do t'i drejtohet Kuvendit të KSA të Kosovës që t'i jep ndihmesë për hartimin e dokumenteve për pozitën e re kushtetuese të Kosovës<sup>109</sup>. Në rrethana të tilla të brendshme dhe të jashtme, kur popujt e Jugosllavisë përgatiteshin të shpallin pavarësinë nga Federata jugosllave, Kosova tani e vonuar shpejtonte t'i arrijë republikat e tjera. Atë që duhej ta bënin delegatët në Kuvendin e Kosovës në Prizren më 1945, apo më 1981, do ta bëjnë më 2 korrik 1990, por jo në Kuvendin e Kosovës, por në parkun e tij. Edhe ky fakt i delegatëve të Kosovës do ta rris revoltën të udhëheqësia nacional-shoviniste serbe me përkrahjen e qeverisë federative, e cila pas tre ditëve do ta shpërndaj kuvendin e Kosovës, qeverinë, organet administrative e gjyqësore, do ta pushtojnë Radiotelevizionin në gjuhën shqipe, do ta godas rëndë sistemin arsimor, shkencor, kulturor, shëndetësor, bankar etj<sup>110</sup>.

---

<sup>108</sup> Hysni Myzyri, "Historia e shqipërisë dhe shqipëtarëve", Prizren 2001, fq.385

<sup>109</sup> Vinca Agim, "Populli I pandaluar", Prishtinë 1992, fq.117

<sup>110</sup> Myzyri Hysni, "Historia e Shqipërisë dhe shqipëtarëve" Prizren 2001, fq.384

Për ta çuar vullnetin e popullit deri në fund dhe duke u nisur nga e drejta e vetëvendosjes delegatët e Kosovës të cilët ishin gjithmonë nën ndjekje të policisë serbe, në mënyrë tepër sekrete do të arrijnë të tubohen më 7 shtator 1990 për të shpallur Kushtetutën e Republikës së Kosovës në Kaçanik, që në popull njihet si kushtetuta e Kaçanikut<sup>111</sup>. Me këtë do të mbyllet faza fillestare e formimit të shtetit të Kosovës për të vazhduar më tej me rrethana tjera.

Në Maqedoni, shqiptarët formimin e partive politike e menduan dhe e kuptuan si momentin e kthimit të shpresës, si momentin e zgjedhjes së çështjes kombëtare, bile populli në përgjithësi duke mos e kuptuar si duhet pluralizmin do të lidhet aq shumë pas partive politike, sa që menduan se me shembjen e komunizmit dhe me themelimin e partive politike, do të shemben kufijtë ndërshqiptarë dhe do të bëhet bashkimi i trojeve shqiptare.

Shteti maqedonas nuk ishte aspak i disponuar që shqiptarëve t'u jep hapësirë për të formuar parti politike. Ai në fillim do të mundohet t'i bind shqiptarët që ata të inkorporohen në partitë maqedone, krahas kësaj kërkesë të pushtetarëve maqedonas nuk do të ndalet edhe dhuna që ushtrohej me vite dhe që do të vazhdojë me të njëjtin intensitet dhe në të ardhmen. Mjafton të përmendet vetëm moslejimi i themelimit të partive shqiptare, ndonëse në Maqedoni ishte miratuar ligji për partitë politike, pushteti maqedonas nuk do të lejoj formimin e tyre, rast ky që nuk ndodhte as në Kosovë e cila ishte e pushtuar në mënyrë klasike. Për ta treguar tërë nacional-shovinizmin, partia e parë shqiptare PPD do të jetë e detyruar që ta mbaj Kuvendin themelues në Poroj e rrethuar nga të gjitha anët me polici maqedonase. Kjo pra ishte "demokracia" e proklamuar për shqiptarët, të cilës "demokraci" më vonë verbërisht do t'i besojnë të gjitha partitë që do të themelohen dhe do të arrijnë të marrin hise nga kulaçi maqedonas.

Në kohën e shthurjes së Jugosllavisë së Dytë, zëri i shqiptarëve në instanca më të larta republikane e ndërkombëtare do të çohet përmes dy partive më të mëdha shqiptare, asaj të LDK-së që tubonte rreth 700 mijë anëtarë e simpatizues dhe PPD-së që kishte në atë kohë rreth 180 mijë anëtarë. Aktiviteti i këtyre partive do të vazhdoj në kushte tepër të rënda dhe në rrethana të ndryshme. Derisa LDK kurrë nuk do ta pranoj pushtetin serb, PPD do ta pranoj atë maqedonas pa kurrfarë kushtesh në kurriz të popullit shqiptar.

Më vonë do të aktivizohen edhe disa parti të tjera, si në Kosovë ashtu edhe në Maqedoni, por aktiviteti i tyre politik do të jetë nën hijen e dy partive të para, jo se këto dy parti do të dallohen për nga veprimi politik mbi të tjerat, por për arsye se këto dy parti si më të mëdha dhe si

---

<sup>111</sup> Po aty, fq 384

më të njohurat si jashtë ashtu edhe brenda vendit, do t'i përkrah bashkësia ndërkombëtare, për arsye se platforma politike e këtyre dy partive që në pajtueshmëri të plotë me strategjinë politike të bashkësisë ndërkombëtare për ruajtjen e statusit qos në Ballkan. Këtë do ta pranoj më vonë Nevzat Halili ish-kryetar i PPD-së, i cili në gazetën “koha jonë” të 17 nëntorit 1994, do të thotë se, PPD që në fillim nuk punoi asgjë pa konsultimin e Ibrahim Rugovës dhe të Sali Berishës. Me ndarjen e kësaj partie në dy fraksione në fund të vitit 1993, njëri krah i saj nën udhëheqjen e Abdurahman Halitit do të jetë gjithmonë nën ombrellën e presidentit të Maqedonisë, antishqiptarit më të madh, Kiro Gligorov, ndërsa krahu tjetër me Arbër Xhaferin në krye, do të kërkonte përkrahjen gjithmonë nga shteti Shqiptarë. Ndonëse krahu i Arbër Xhaferit pretendonte për radikalizëm, por praktika e saj politike nuk dallohej për asgjë nga ajo e krahut të Halitit sepse në fund ë fundit të dy krahët kishin një qëllim, të ruani status –quon e Maqedonisë.

Përkundër të gjithë këtyre veprimtarive, partitë politike shqiptare do të ndërmarrin disa hapa që do ta çojnë popullin shqiptar me të vërtetë të mendoj seriozisht se punët ecin mbarë. Zgjidhja e çështjes shqiptare në Jugosllavi, që me të madhe debatohej nga intelektualët në kohën e shthurjes së Jugosllavisë, ku shiheshin katër opsione për zgjidhjen e çështjes shqiptare, dhe ato janë:

Opsioni i parë dhe më i preferuar nga partitë politike ishte ai që do të pranohet edhe nga Trupi Koordinues i subjektit partiak shqiptar që në takimin e parë në Prishtinë në vitin 1991, do t'i përfshijë këto parametra:

1. Pavarësia e Kosovës
2. Shqiptarët në Maqedoni të kenë statusin shtetformues, dhe
3. Njohja e të drejtës të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës, si dhe të malit të Zi për autonomi më të lartë me të drejtë bashkimi me Kosovën<sup>112</sup>.

Opsioni i dytë do të jetë ai i autonomisë për shqiptarët jashtë Kosovës, dy opsionet e para do të gjejnë më tepër hapësirë në angazhimin e partive shqiptare në ish-Jugosllavi. Opsioni i tretë dhe ai i katërti do të kenë më tepër përkrahje nga populli dhe intelektualët e mirëfilltë. Si opsion i tretë ishte ai i përmirësimit të padrejtësisë që i është bërë popullit shqiptar pas Luftës së dytë Botërore, me ndarjen e shqiptarëve në katër njësi federale (Serbi, Mali i Zi, Kosovë e Maqedoni) dhe meqenëse Jugosllavia si shtet gjendej në fazën e rikonstruimit të vet politik, që sillej midis dy kaheve kryesore e të konfrontuara: ai federativ dhe konfederativ, apo edhe në prag të

---

<sup>112</sup> Maliqi Nazmi, "Gjurmë politike" Shkup 2001, fq.42

shpërbërjes të vet të plotë, shqiptarët jashtë Kosovës do të mund të dilnin edhe me një kërkesë tjetër, të tretë, pak më radikale se dy të parat: me kërkesën për bashkim me Kosovën. Ndarja e padrejtë e shqiptarëve në kuadër të Jugosllavisë, që ka pasur për qëllim dekompozimin dhe dobësimin e tyre si popull, në këtë mënyrë do të korrigjohej. Shqiptarët do të kishin njësinë e tyre konfederate në kuadër të Jugosllavisë si bashkësi shtetesh-republika e Kosovës, që do të përfshinte viset ku mbizotëron popullata shqiptare, kurse çështja shqiptare do t'i afrohej zgjidhjes së saj përfundimtare. Ky opsion do të ishte shumë i drejtë edhe në rastin e shthurjes së plotë të Jugosllavisë. Dhe opsioni i fundit që është edhe më i natyrshëm është ai i bashkimit të trojeve etnike shqiptare të cilët padrejtësisht mbetën jashtë kufirit të shtetit amë “Shqipërisë”, si shkak i vendimeve të padrejta të Fuqive të Mëdha në Konferencën e Ambasadorëve në Londër më 1913, dhe në Konferencën e Versajës në Paris më 1918, posaçërisht ky opsion vlen më tepër nëse Jugosllavia si shtet do të shpërbëhet dhe nuk do të ekzistojë më. Bashkimi i trojeve etnike shqiptare, në të cilat si në të kaluarën edhe sot mbizotëron popullata shqiptare, në një shtet të përbashkët në Ballkan do të ishte siç ka thënë akademiku Rexhep Qosja, zgjedhje e vetme e drejtë, globale dhe e përhershme e çështjes shqiptare<sup>113</sup>. Kjo do të ishte në të vërtetë e vetmja zgjidhje historikisht e drejtë, që do të korrigjonte një padrejtësi të madhe historike, ndarjen në dysh të tokave dhe të popullit shqiptar, i cili më vonë do të copëtohet edhe më, kuptohet pa dëshirën e tij e për t'i kënaqur apetitet e pushtuesve fqinjë.

Shqipëria është i vetmi vend në Evropë që në tërë kufirin e vet tokësorë kufizohet me popullin e vet, domethënë me shqiptar. E drejta për të jetuar i bashkuar është e drejtë legjitime e çdo populli, kurse për popullin e ndarë shqiptarë ajo është një aspiratë historike dhe një dëshirë e ide e pashuar. Në qoftë se në të kaluarën kjo ide ka mundur të pëshpëritet vetëm nëpër familje dhe në rrethe të ngushta miqsh, tani ka ardhur koha për të, të flitet lirisht dhe të mendohet dhe veprohet seriozisht.

Për fat të keq të popullit shqiptar, partitë politike duke u mbështetur gjithmonë në faktorin e jashtëm të cilët dëshironin të ruanin status-quon në Ballkan, do të zgjedhin opsionin e parë që mendonin se do të jetë opsioni më i lehtë për ta bërë. Rruga që do të zgjedhin liderët e këtyre partive, Ibrahim Rugova e Nevzat Halili, e që do t'i pasojnë Abyrahman Haliti e Arbër Xhaferi, do të jetë rrugë e cila popullit do t'i sjell progres i cili nuk do të jetë aq i mjaftueshëm. Liderët shqiptarë nuk kthyen kokën pas t'i shohin sukseset e udhëheqësve të popujve tjerë sllav që e

---

<sup>113</sup> Qosja Rexhep “Çështja shqiptare dhe Jugosllavia” Zëri I rinisë” Prill 1991

përbënin Jugosllavinë. Përderisa ata e bashkuan popullin për të arritur aktin final si Tugjmani te kroatët, Gligorovi te maqedonasit, Izetbegoviqi te boshnjakët, këtë bashkim nuk e bënë pala shqiptare. Udhëheqësit shqiptar kishin iluzione se çështja jonë kombëtare do të zgjidhet pa kurrfarë sakrificash, duke e lënë punën që ta zgjedh Perëndimi.

Por, edhe pse u zgjodh opsioni më i lehtë ai i zgjedhjes së problemit veç e veç, përsëri rruga deri në ato zgjedhje gjysmake do të jetë tepër e vështirë. Kosovës tani do t'i lihet vetë të sendërtoj ardhmërinë e vet, si republikë në vete, kurse shqiptarët e tjerë jashtë Kosovës do të duhet ta ndihmojnë e të mos e pengojnë. Kësisoj shqiptarët në Maqedoni duhet të punojnë për arritjen e statusit për barazi të plotë me maqedonasit dhe njëkohësisht duhet me sa munden ta ndihmojnë Kosovën. Kjo “ndihmesë” që do t'i bëjnë partitë shqiptare në Maqedoni, Kosovës do t'i shërbejë si arsytim për dështimet që do t'i bëjnë ato rresht. Gjithashtu, edhe shqiptarët e Luginës së Preshevës dhe të Malit të Zi do të angazhohen për arritjen e një statusi special-autonomia kulturore dhe me ngulm do të punojnë për arritjen e këtyre qëllimeve. Në periudhën e jetës pluraliste, shqiptarët në Maqedoni u ballafaquan me një injorim politik nga pala maqedonase dhe u krijua një ambient i papërshtatshëm politik dhe i sigurisë, që paraqisnin pengesë për veprim politik të shqiptarëve për avancimin e statusit juridiko-kushtetues.

Për këtë arsye shqiptarët që në fillim nuk votuan në referendumin e 8 shtatorit 1991, për pavarësinë e Maqedonisë dhe njësoj nuk votuan edhe për Kushtetutën e Maqedonisë e sjellë në nëntor të vitit 1991<sup>114</sup>. Subjektet politike të bllokut maqedonas e vazhduan kontinuitetin e veprimtarisë së tyre politike të praktikës moniste, për injorimin e kërkesave të shqiptarëve dhe në të njëjtën kohë, u injoruan vlerat dhe parimet demokratike. Ky është edhe shkaku pse në periudha të ndryshme u krijuan situata të paqarta, situata konfliktuoze, afera, vrasje, burgosje etj.

Populli shqiptar gjithmonë dukje i mbështetur partitë politike shqiptare që do të veprojnë në Maqedoni me masivitet do t'i përgjigjet referendimit për Autonomi Territoriale Kulturore e politike të shqiptarëve në Maqedoni, ku u deklaruan pro, mbi 300 mijë shqiptarë. Para mbajtjes së këtij referendumi duhet për endur edhe tubimin e mbi 100 mijë shqiptarëve i mbajtur në qendër të Shkupit, aty ku para gjysmë shekulli ishte lagjja më vjetër shqiptare, pranë urës së gurit.

Në këtë tubim gjithëshqiptar, krahas promovimit të Platformës me kërkesat shqiptare nga kryetari i PPD-së Nevzat Halili, po nga ai dhe stafi udhëheqës partiak u shpalos me krenari

---

<sup>114</sup> Maliqi Nazmi, “Shpalosje” Shkup 2001 fq.16

flamuri shqiptar i ruajtur në zemër dhe në vatrat shqiptare, i ndrydhur nga sfidat e kohës por i ruajtur në ndërgjegjen kombëtare<sup>115</sup>.

Ky aktivitet politik në popullatë krijoi bindje se filloi të jetësohet amanetin i të gjithë atdhedashësve, që në të kaluarën nuk e kursyen edhe jetën për të drejtën e bashkëkombasve të vet në këto troje. Mirëpo, pas një periudhe relativisht të shkurtër, pas referendumit për autonomi territoriale politike të shqiptarëve në Maqedoni, dy partitë tona përmes deputetëve të tyre në parlament do të prononcohen me një Deklaratë tjetër me titull: “Për Status të Barabartë të Shqiptarëve në Maqedoni”. Kjo deklaratë edhe pse aspak nuk është kontestuese për nga përmbajtja, por në mes rreshtave ishte fshirje e konceptit politik të shqiptarëve për Autonomi. Ky ndërrim i qëndrimeve politike ishte sa i pakuptueshëm aq edhe i dëmshëm. Pas këtij prononcimi do të vjen edhe një iniciativë tjetër e PPD-së e përkrahur me 320 mijë nënshkrime të shqiptarëve për ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë. Iniciativa të cilat asnjëherë nuk u evidentuan në Arkivin e Parlamentit të Maqedonisë, apo madje, edhe nuk kishte iniciativë serioze që të vihet në rend dite në parlament.

Pas këtyre dështimeve dhe lajthitjeve të shqiptarëve, pushteti maqedonas do të vazhdoj me avazin e vjetër. Do të shtoj dhunën dhe sistematikisht do të provokoj gjendje të tensionuar brenda shtetit, për t'i disiplinuar shqiptarët e organizuar dobët nga partitë politike ekzistuese të kohës së PPD-së dhe PDP-së. Në një varg të pandalur do të ndodhin ngjarje me të cilat do të ballafaqohet populli shqiptar me qeverinë e Maqedonisë. Ndër ndodhitë që lanë vrage më të rëndë në ecurinë e rimëkëmbjes shqiptare mund të numërohen me sa vijon: Ngjarjet e Bit Pazarit, organizimi i shqiptarëve në Maqedoni për vetëmbrojtje, afëra e armëve, ngjarjet në Ladorishtë, ngjarjet në Reçicë të Vogël me aktin e themelimit të Universitetit të Tetovës, ngjarjet e Gostivarit rreth aktivitetit të legalizimit të flamurit kombëtar, helmimet e nxënësve, ngjarjet e Haraçinës dhe në fund si pasojë e gjithë këtyre konflikteve i armatosur shqiptaro-maqedonas.

---

<sup>115</sup> *Po aty, fq.17*

### 3.2. Referendumi për pavarësinë e Republikës së Maqedonisë

Maqedonia si shtet do të shfaqet nga përfundimi i Luftës së Dytë Botërore edhe atë u formua nga komunistët jugosllavë si njësi federale nën kufijtë e Jugosllavisë. Në pozitën që gjendej nuk kishte ndonjë peshë apo rol vendimtar. Prandaj për ta nxjerë veten në pah apo thjesht për tu njohur më gjërë maqedonasit shpallën një referendum gjithpopullor ku populli do të shprehte vullnetin e tyre edhe pse në hapsirat tjera të ish Jugosllavisë (Republikat kishin përgaditur terrenin e tyre për mëvetësi nga federata Jugosllave). Populli i cili jetonte në këtë vend do të duhej që të vendos për pavarësi. Maqedonasit mendonin që sa më shpejt të fitonin të drejtën e tyre të formimit të shtetit të pavarur por nga ana tjetër, ata anashkalonin popujt tjerë që jetonin në këto troje. Më 8 shtator të vitit 1991, në Maqedoni u organizua referendumi për pavarësi por në kushtetutën e vitit 1991 shqiptarët i humbën të drejtat të cilat formalisht i gëzonin me kushtetutën e vitit 1974<sup>116</sup>. Referendumi i shtatorit të vitit 1991 u bojkotua nga ana e shqiptarëve, me këtë bojkotim ata siguruan të drejtën e tyre historike për të vendosur vetë në të ardhmen. Por qeveria e asja kohe –Qeveria e Klusevit mendohej që me procedurë të përshpejtuar të sjell vendimin për referendum si dhe miratimin e kushtetutës së re të vitit 1991. Faktori politik shqiptarë në atë kohë nuk kishte ndonjë qëndrim unik për çështjen e kushtetutës, prandaj edhe Kryetari i Maqedonisë Kiro Gligorov e kishte më të lehtë që mos të përgjigjet ndaj kërkesave të politikanëve shqiptarë.

Referendumi u përcaktua të mbahet më 8 shtator 1991. Pyetja që u shtrua për popujt e Maqedonisë në këtë referendum ishte: *“A jeni për Maqedoninë si shtet sovran me të drejtë që të hyhet në Lidhjen e shteteve sovrane të Jugosllavisë”*<sup>117</sup>. Rezultatet e referendumit të 8-shtatorit ishin të dyshimta sepse të dhënat për daljen e popullatës në referendum përfshinin shifra jo reale në përqindje kjo dalje në referendum ishte mbi 71% të popullatës në Maqedoni, mirëpo duke marrë parasysh se shqiptarët e bojkotuan kjo shifër nuk mundej të jetë reale. Prandaj edhe ky referendum nga ana e shqiptarëve të Maqedonisë gjithmonë ka qenë dhe do të mbetet i dyshimtë. Në kohën e sjelljes së kushtetutës aktuale të Maqedonisë ishte formuar ekipi negociues tripalësh i

<sup>116</sup> Shala Xhavit “Ballkani gjeoploitika dhe siguria-I” Tiranë 2009, faq 411

<sup>117</sup> Rexhepi Zeqirja, “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarëve në Maqedoni, 1990-2001” Tetovë 2005 fq. 44



përfaqësuar nga shqiptarët, maqedonasit dhe përfaqësues të BE-së si palë e tretë e udhëhequr nga ambasadori Gert Arens. Takimet në lidhje me kushtetutën u mbajtën në Shkup, Gjenevë dhe Hag. Në të gjitha këto takime nuk u përfillën kërkesat e përfaqësuesve shqiptarë dhe nuk u arit ndonjë marrëveshje afatgjate për kthimin e e lementit konstituiv të shqiptarëve në Maqedoni.<sup>118</sup>

Kushtetuta si akt më i lartë juridik i Republikës së Maqedonisë, u miratua nga Kuvendi republikan më 17 nëntor 1991<sup>119</sup>.

Në të thuhet:

*Duke u nisur nga trashëgimia historike, kulturore, shpirtërore dhe shtetërore e popullit maqedonas dhe nga lufta e tij shekullore për liri nacionale dhe sociale dhe për krijimin e shtetit të vet, e veçanërisht nga traditat shtetërore juridike të Republikës së Krushevës dhe vendimeve historike të KAÇKM<sup>120</sup>-së dhe kontinuitetit kushtetues juridik të shtetit maqedonas si Republikë sovraane në Federatën Jugosllave, nga vullneti lirisht i shprehur i qytetarëve të Republikës së Maqedonisë në Referendumin e 8 shtatorit 1991, si dhe nga fakti historik se Maqedonia është konstituuar si shtet nacional i popullit maqedonas në të cilin sigurohet barazia e plotë qytetare dhe bashkëjetesa e përhershme e popullit maqedonas me shqiptarët, turqit, vllahët, romët dhe kombësitë e tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë<sup>121</sup>, e me qëllim që:*

- Republika e Maqedonisë të konstituohet si shtet sovran dhe i pavarur dhe si shtet qytetar dhe demokratik;
- të vendoset dhe ndërtohet sundimi i së drejtës si sistem themelor i pushtetit;
- të garantohen të drejtat e njeriut, liritë qytetare dhe barazia nacionale;
- të sigurohet paqja dhe bashkëjetesa e popullit maqedonas, me kombësitë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë; dhe
- të sigurohet drejtësia sociale, mirëqenia ekonomike dhe përparimi i jetës personale dhe të përbashkët.
- Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, miraton KUSHTETUTËN E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.<sup>122</sup>

<sup>118</sup> Maliqi Nazmi, "Gjurmë politike" Shkup 2001 fq. 68

<sup>119</sup> Rexhepi Zeqirja, "Vepër e cituar" fq. 44

<sup>120</sup> KAÇKM-Komiteti Antifashist i Çlirimit Kombëtarë Maqedonas

<sup>121</sup> Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, dokument me numër 08-4642/1

<sup>122</sup> Po aty

Kushtetuta e 8 shtatorit do të jetë poashtu një gjenerator destabilizues i gjendjes politike dhe marrëdhënieve ndëretnike në vend. Këto mosmarrveshje ndëretnike do të thellohen edhe më shumë gjatë viteve vijuese, gjë që do të manifestohet me shpërthimin e konfliktit të armatosur në Maqedoni në vitin 2001, pra 10 vite pas miratimit të Kushtetutës gjë që na bën të ditur se shqiptarët asnjëherë nuk u pajtuan me statusin e tyre të imponuar nga establisti politik maqedonas.

### 3.3. Shpallja e pavarësisë së Maqedonisë dhe njohja ndërkombëtare e saj

Pas zgjedhjeve të para plurale në Maqedoni do të pasojë akti i Deklaratës së pavarësisë që do të jetë edhe akti i parë pas shpalljes së pavarësisë së Republikës së Maqedonisë. Deklarata u soll në Kuvendin e Maqedonisë, më 25 janar 1991<sup>123</sup>. Ky akt i rëndësishëm ishte hapi i parë politik drejt mëvetësisë së Maqedonisë. Mbi baza të saj u ndërtuan të gjitha aktet e mëvonshme të shtetit të ri, të pavarur në Ballkan.

Deklarata e pavarësisë së Maqedonisë ishte pikënisje për themelimin e një shteti të ri, të pavarur në hapësirat e Gadishullit Ballkanik. Përcaktimet bazë të Deklaratës për pavarësi e shtrembërojnë realitetin historik dhe etnik mbi të cilat duhej të themelohet shteti i ri në Ballkan. Sipas këtyre përcaktimeve, projekti për shtetin e pavarur të Maqedonisë mbështetet mbi *“integritetin territorial të shtetit maqedonas”* dhe mbi *“të drejtën e popullit maqedonas për vetëpërcaktim”*<sup>124</sup>. Ky formulim në mënyrë shumë të qartë përcakton karakterin e shtetit të ri si shtet nacional maqedonas, duke përjashtuar mundësinë e themelimit të një shteti multietnik, ku do të përfshiheshin shqiptarët dhe popujt tjerë që jetonin në Maqedoni.

Deklarata e pavarësisë nga ana e faktorit politik shqiptarë do të pritet me mëdyshje të madhe. Partia në pushtet e asaj kohe- Partia për Prosperitet Demokratik e shihte me mëdyshje këtë Deklaratë mirëpo nuk qe dhe aq e guximshme ta pranojë para popullit shqiptarë që kjo Deklaratë nuk ishte në favor të tyre. Kjo gjë më së shumti ndodhi ngaqë situata ndikohej nga

---

<sup>123</sup> Rexhepi Zeqirja - *“Vepër e cituar”* fq.31

<sup>124</sup> Po aty fq 32

rrethanat politike në ish-Jugosllavi. Në Koferencën e Dytë të Partisë për Prosperitet Demokratik, të mbajtur në Teatrin e Kombësive në Shkup, më 19 maj 1991, në raportin e kryesisë së kësaj partie, lidhur me Deklaratën për sovranitet dhe pavarësi të Republikës së Maqedonisë thuhet: “ajo duhet të trajtohet si akt politik e kurrësesi si akt juridik dhe kushtetues. Sipas raportit, Deklarata përmban thënie parimore dhe nuk është vendim. Kjo, popullit maqedonas nuk i jep të drejtë të vendosë për popujt tjerë të Maqedonisë, veçanërisht për shqiptarët”<sup>125</sup>.

Me rastin e miratimit të Deklaratës u demaskua haptas mashtrimi politik ndaj shqiptarëve. Mirëpo në anën tjetër faktori politik maqedonas dalngadalë ariti ta rumbullaksojë formësimin si shtet dhe se Maqedonia do të përfshihet nga njohjet diplomatike të njëpasnjëshme si që janë Bullgaria, Turqia, OKB-ja, Shqipëri, Sllovenia, Kroacia, Bosnja dhe Hercegovina, Lituania, Rusia, Bjellorusia etj.<sup>126</sup>

**Bullgaria** - ishte shteti i parë që e njohu Maqedoninë, më 15 janar 1992, si shtet të pavarur.  
**Turqia** - Republika e Maqedonisë më 24 dhjetor 1992, shpalli Dekretin për ratifikimin e Ligjit për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike me Republikën e Turqisë.

**Organizata e Kombeve të Bashkuara** - më 9 prill 1993<sup>127</sup>, Republika e Maqedonisë u pranua si anëtare e 181 pranë Organizatës botërore dhe kjo Republikë u emërua si: “ISH REPUBLIKA JUGOSLLAVE E MAQEDONISË” – I R J M

**Shqipëria** - e njohu pavarësinë e IRJM pak ditë pas njohjes së saj nga Organizata e Kombeve të Bashkuara, më 26 prill 1993 ndërsa më 24 dhjetor 1993, Shqipëria dhe IRJM vendosën marrëdhënie diplomatike.

**Greqia** - nuk e njohte Maqedoninë si shtet me emrin e saj, Republika e Maqedonisë.

Por, më 13 shtator 1995, në Njujork u nënshkrua Marrëveshja e përkohshme midis Republikës së Greqisë dhe Ish Republikës Jugosllave të Maqedonisë.

**Jugosllavia** - vendosi marrëdhënie diplomatike me IRJM më 8 prill, 1996 .

<sup>125</sup> Rexhepi Zeqirja - “Vepër e cituar” fq.33

<sup>126</sup> Aziri Etem, “Organizimi politik I shqiptarëve në Maqedoni” Shkup 2004, faq.181

<sup>127</sup>>>Flaka e vëllazërimit, 11 prill, 1993.

### 3.4. Opcioni alternativ i shqiptarëve të Maqedonisë (Referendumi)

Referendumi maqedonas i 8-shtatorit si dhe aprovimi i kushtetutës së vitit 1991 nxiti popullatën shqiptare për të gjetur rrugë alternative për përmirësimin e statusit politiko-juridik me anë të deklarimit për shpalljen e mbajtjes së një referendumi për Autonomi politiko-teritoriale të shqiptarëve të këtyre trojeve-Maqedonisë.

Në Referendumin e mbajtur më 11-12 janar 1992 shqiptarët duhej të deklarohen se a janë për Autonomi politiko territoriale të shqiptarëve në Maqedoni. Referendumit ju përgjigj pothuajse e tërë popullata shqiptare e këtyre trojeve me shpresë se kjo zgjidhje do të jetë njëra nga rrugëdaljet për të gëzuar të drejtat dhe liritë kombëtare. Ky referendum do të quhet si i suksesshëm.

*Raporti i Kuvendit të Autonomisë të datës 16 janar 1992, iu dërgua edhe institucioneve ndërkombëtare: Bashkësisë Evropiane, kryetarit të Konferencës së Paqes për Jugosllavinë, z. Lord Kerington, kryetarit të Parlamentit Evropian, kryetarit të Komisionit të Arbitrazhit për Jugosllavinë, sekretarit të përgjithshëm të Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Kongresit, Senatit dhe Departamentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.*<sup>128</sup> Sipas raportit të dërguar deri te këta institucione del se referendumi për autonomi politiko-teritoriale demaskoi politikën denigruese të autoriteteve udhëheqëse. Nga gjithësejt 383.539 votues, sa përfshinte lista e votuesve, për autonomi votuan 360.298 ose 99.9%, kurse vetëm 57 votues kanë votuar kundër (prej atyre që dolën në referendum). Policia maqedonase gjatë procesit të votimit është përpjekur të pengojë duke bastisur vendvotimet si dhe duke bërë konfiskimin e materialit votues. Gjatë këtij procesi dolën në shesh edhe të dhëna të tjera për numrin e popullatës shqiptare. Sipas statistikave përqindja e shqiptarëve ishte shumë më e madhe e jo ashtu siç pretendohet nga organet qeverisëse. Edhe pse Bashkësia ndërkombëtare vuri një parim që të mos ndryshohen kufijtë egzistues shqiptarët ngelën jashta shtetit të tyre amë- Shqipërisë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, me Kushtetutën e vitit 1974, shqiptarëve të Maqedonisë iu njoh statusi shtetformues. Ndryshimet e mëvonshme kushtetuese e reduktuan statusin shtetformues të shqiptarëve të Maqedonisë. Kushtetuta e vitit 1991, shqiptarët në Maqedoni i vuri në pozitë të pakicës nacionale, me çka populli shqiptar nuk mund të pajtohej, andaj vendosi

---

<sup>128</sup> Rexhepi Zeqirja “ Zhvillimet politiko-shoqërore te shqiptarët në Maqedoni 1990-2001 ” faq. 56

të shpreh vullnetin e vet politik për vetëvendosje, përmes referendumit që duhej të shpiente drejt Autonomisë shqiptare, në Maqedoni.

Pas përfundimit me sukses të referendumit, Kuvendi i Autonomisë e emëroi njësinë e re politike territoriale, me emrin ILIRIDA. Ilirida duhej të përfshinte: Kumanovën me rrethinë, disa komuna të Shkupit, Tetovën me rrethinë, Gostivarin me rrethinë, Kërçovën me rrethinë, Dibrën me rrethinë dhe Strugën me rrethinë. Në territorin e Republikës së Iliridës do të jetonte rreth 1/3 e popullatës së Maqedonisë, e banuar me shumicë shqiptare.

Gjatë zhvillimit të procesit të referendumit të popullit shqiptar u hartua edhe një projekt që parashihte zgjidhjen e çështjes shqiptare në Maqedoni, përmes Autonomisë politike territoriale. Projekti parashikonte një periudhë tranzitore për Autonominë nën mbikqyrjen ndërkombëtare me qëllim të krijimit të kushteve për formimin e njësisë federale shqiptare brenda një shteti federativ shqiptaro-maqedonas. Sipas këtij projekti zgjidhja e çështjes shqiptare në Maqedoni, parashihej me formimin e shtetit binacional federativ me dy njësi federale, shqiptare dhe maqedonase. Në projekt, gjithashtu përmendeshin dukuritë negative të cilat shpiejnë në dëm të çështjes kombëtare shqiptare në Maqedoni, si: dialogu jo serioz shqiptaro-maqedonas pa ndonjë rezultat konkret, pjesëmarrja e përfaqësuesve shqiptarë në pushtetin ekzekutiv. Në të, gjithashtu flitej për shtruarjen e çështjes shqiptare në planin e jashtëm dhe të brendshëm; për mundësinë e themelimit të një komisioni ekspertësh që do të merrej me studimin e çështjes nacionale shqiptare në vendet e ish-Jugosllavisë, i cili do të ndihmonte në zgjidhjen e drejtë të saj; opcionet e mundshme të politikës ditore maqedonase dhe qëndrimin ndaj çështjes shqiptare; krijimin e mekanizmave për avancimin dhe jetësimin e Autonomisë politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni; për rolin e madh të diasporës shqiptare ndaj çështjes kombëtare shqiptare; koordinimin e faktorit politik midis hapësirave shqiptare të ish-Jugosllavisë; angazhimin e shtetit amë për zgjidhjen e çështjes shqiptare; dialogun serioz shqiptaro-maqedonas për zgjidhjen e të gjitha çështjeve të hapura; avancimin dhe përbërjen e kornizës së Autonomisë politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni; sigurimin e Autonomisë shqiptare dhe në fund edhe ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë.

Kuvendi për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni hartoi propozimin për ndryshimin e Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë<sup>129</sup>. Në pjesën hyrëse të këtij dokumenti thuhet:

*“Duke marrë për bazë kërkesat plebishitare dhe aktivitetet e shumta të popullit shqiptar, të partive politike dhe të asociacioneve tjera shoqërore të tyre të mbështetura në vendosmërinë e Bashkësisë Evropiane dhe të Kombeve të Bashkuara për zgjidhjen e krizës jugosllave në mënyrë paqesore, me metoda demokratike, duke respektuar të drejtën e çdo populli për vetëvendosje, kërkesa këto që u kurorëzuan me Referendumin e mbajtur më 11 e 12 janar 1992, si dhe duke u nisur nga përcaktimet e Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë me të cilën “garantohen të drejtat dhe liritë e njerëzve dhe qytetarëve dhe barazia nacionale”, në bazë të nenit 130 të Kushtetutës të Republikës së Maqedonisë, ne qytetarët e nënshkruar të Republikës së Maqedonisë i paraqesim Kuvendit të Republikës së Maqedonisë PROPOZIMIN PËR NDRYSHIMIN E KUSHTETUTËS TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË”*

Në pjesën e parë të këtij dokumenti të Kuvendit të Autonomisë shtrohen shkaqet për ndryshimin e Kushtetutës, ku si arsye kryesore potencohet pabarazia e popullit shqiptar dhe pozita e papërshtatshme juridike kushtetuese e tij në Republikën e Maqedonisë.

Në pjesën e dytë përshkruhet qëllimi për ndryshimin e Kushtetutës, ku potencohet se zgjidhja e çështjes shqiptare mund të bëhet përmes federalizimit të Republikës së Maqedonisë.

Në pjesën e tretë të këtij dokumenti propozohet ndryshimi i Preambulës së Kushtetutës dhe disa nene të saj, përkatësisht neni 3, neni 5, neni 7, neni 48, neni 51, dhe neni 52, të cilat në Kushtetutë do të inkorporonin Autonominë shqiptare, Republikën Autonome të Iliridës.

Gjithashtu, propozohet pjesa shtesë e Kushtetutës, e cila do të titullohej: REPUBLIKA AUTONOME ILIRIDA, në të cilën do të përcaktohej definicioni i saj si bashkësi autonome politike territoriale demokratike, në të cilën populli shqiptar dhe nacionalitetet e tjera realizojnë të drejtat e tyre sovraane përveç atyre që në interes të përbashkët, me vullnetin dhe pëlqimin e tyre në Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë i bartin dhe realizojnë në Republikën e Maqedonisë dhe me një dispozitë tjetër të përcaktohej territori i Republikës Autonome Ilirida.

Në fund të këtij dokumenti, thuhet: **“Po qe se Kuvendi i Republikës së Maqedonisë nuk e aprovon propozimin për ndryshimin e Kushtetutës së Maqedonisë dhe nuk i përcakton**

---

<sup>129</sup>Dokumenti mban vulën e Kuvendit për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni dhe muajin Mars, 1992, Gostivar.

**dhe garanton kërkesat për Autonomi politike territoriale të shqiptarëve në Maqedoni, do të detyrohemë që ta avancojmë përcaktimin tonë politik në përputhje me të drejtën natyrore, etnike dhe historike të popullit shqiptar për vetëvendosje”**

Si u zhvilluan proceset politike në periudhën vijuese?

Për aktualizimin dhe jetësimin e referendimit për APTSH<sup>130</sup> u ndërmorën një varg aktivitete diplomatike nga organet e kuvendit dhe partitë politike. *Më 14 shkurt 1992 i dërgohet letër komisionit të arbitrazhit që vepronte në kuadër të BE-së, ku u kërkuar njohja e Maqedonisë që të kushtëzohet me njohjen e statusit të shqiptarëve. Më 12 mars 1992 me një letër u njoftuan shtetet anëtare të BE-së, Lordi Kerington, shumë ambasada të shteteve perëndimore SHBA-të, Turqia dhe Shqipëria për pozitën e shqiptarëve në Maqedoni dhe kërkesën për APTSH. Më 15 shkurt 1992 me një letër iu shpreh mirënjohje kongresistit amerikan Tom Lantosh për angazhimin e tij dhe për paraqitjen e propozim rezolutës në Kongresin amerikan lidhur me kërkesën për APTSH në Maqedoni<sup>131</sup>.*

Brenda vetë faktorit politik shqiptar nuk kishte marrëveshje unanime për çështjen e referendimit dhe të Autonomisë. Kjo mund të vërehet nga deklaratat publike dhe dokumentet e aprovuara nëpër mbledhje të faktorit politik. Nga ana tjetër, faktori politik shqiptar nuk ishte serioz, sepse përderisa në njërin anë angazhohej për referendum dhe Autonomi politike të shqiptarëve, në anën tjetër, zhvilloheshin negociata për pjesëmarrje të subjektit politik në koalicionin qeveritar maqedonas<sup>132</sup>.

Qëndrimet kundërtënëse brenda faktorit politik shqiptar shkaktuan dëm të madh në zhvillimet e mëtutjeshme rreth çështjes shqiptare në Maqedoni. Njëkohësisht, këto zhvillime do të ndikojnë dukshëm në përçarjen e faktorit politik shqiptar në Maqedoni.

---

<sup>130</sup> *Autonomia politike teritoriale e shqiptarëve në Maqedoni që do të përfshinte Kumanovën me rrethinë, disa komuna të Shkupit, Tetovën me rrethinë, Gostivarin me rrethinë, Kërçovën me rrethinë, Dibrën me rrethinë dhe Strugën me rrethinë.*

<sup>131</sup> *Gazeta Koha 9 janar 2013 fq.11*

<sup>132</sup> *Dokumenti, me numër protokolli 0301-262/1, Tetovë, 17 janar, 1992,*

### 3.5. Faktori politik shqiptarë në periudhën 1997-1998

Gjatë vitit 1997 Shqipëria u fut në anarki totale si rezultat i sistemit “piramidal”. Ngjarjet në Shqipëri u reflektuan edhe në Maqedoni. Në pranverë të vitit 1997, Shqipëria u zhyt në një anarki të plotë, si rezultat i falimentimit të sistemit “piramidal”. Në këtë periudhë qarqeve antishqiptare serbe dhe maqedonase ju dha rasti që të keqpërdorin këtë hapësirë kohore për qëllime të veta. Këtu ata do të fillojnë të pregaditen politikisht dhe ushtarakisht duke i koordinuar veprimet e tyre. Këto ngjarje do të reflektohen më shumë në Kosovë kur policia dhe ushtria serbe do të fillojnë të shtojnë veprimet e tyre ushtarake. Mirëpo në këtë periudhë Ushtria Çlirimtare e Kosovës do të shfaqet në skenë me aksionet e saja të sinkronizuara ndaj caqeve serbe. Në Maqedoni këto ngjarje do inicojnë pregaditjen e skenarit të “9 Korrikut” për t’i dhënë fund radikalizimit të kërkesave shqiptare. Mirëpo këtyre tendencave subjekti politik shqiptarë iu përgjigj me anë të bashkimit të dy subjekteve politike shqiptare. Bashkimi i këtyre dy subjekteve politike ndodhi pas zgjedhjeve komunale në vitin 1996 Ky proces u kurorëzua me bashkimin e Partisë për Prosperitet Demokratik të Shqiptarëve dhe Partisë Demokratike Popullore, në Kongresin, e quajtur “Kongresi i Bashkimit”, më 4 korrik 1997, në sallën e Pallatit të kulturës në Tetovë.<sup>133</sup> Ky bashkim i dy partive politike shqiptare ishte shumë shpresëdhënëse për procesin e mëtutjeshëm politik në hapsirat ku jetojnë shqiptarët. Si rjedhojë e rireshtimit të forcave politike shqiptare ky proces do të nxisë shqetësime brenda korpusit politik maqedonas si rjedhojë pasoi skenari i 9-Korrikut. Gjatë ngjarjeve të 9-Korrikut u vranë 3shqiptarë nga Gostivari dhe u burgosën kryetarët e komunave të Tetovës dhe Gostivarit.<sup>134</sup> Përpos vrasjeve dhe burgosjeve shumë qytetarë shqiptarë të Gostivarit dhe Tetovës u burgosën, kidnapuan dhe u maltretuan në mënyra të ndryshme. Qeveria e asaj kohe me kryeministër Branko Cërvenkovskin deklaroi se nuk kanë qenë të informuar për aksionin policor në Gostivar. Nga kjo edhe u dëshmuar për mospërfilljen e faktorit politik shqiptarë si participant në qeveri. Shqiptarët shfrytëzoheshin vetëm si mbulesë dhe jo si faktorë që do të merte vendime në lidhje me çështjet kyçe të shtetit si që ishte Ministria e Punëve të Brendshme të R.M. Pra shqiptarët shfrytëzoheshin vetëm për të arsyetuar opinionin dhe Bashkësinë ndërkombëtare për “karakterin multietnik të shtetit” dhe proklamimin se gjoja shqiptarët i gëzojnë të gjitha të drejtat si një komunitet.

<sup>133</sup> Rexhepi Zeqirja “Zhvillimet politiko-shoqërore të shqiptarët në Maqedoni 1990-2001” faq. 123

<sup>134</sup> Në Tetovë kryetar komune ishte Alajdin Demiri ndërsa në Gostivar Rufi Osmani.



### **3.6. Formacioni Ushtarak (Ushtria Çlirimtare Kombëtare)**

Dalja në skenë e partive shqiptare të cilat në programin e tyre i kishin këto parametra e për realizimin e të cilave nuk do të angazhoheshin denjësisht t'i realizojnë, do t'i sjellin popullit shqiptar dëme shumë të mëdha, bile më të mëdha se në kohën e Jugosllavisë.

Vullneti politik i shqiptarëve, që të jenë qytetarë të barabartë në shtetin që donin ta konsideronin edhe si të tyre, jo rrallë u keqpërdor nga faktori politik maqedonas dhe ai shqiptar. Politika shtetërore maqedonase, pikërisht për këtë çështje, ka rënë në provim, aq më tepër kur çdo kërkesë e shqiptarëve i vishej atributi “radikale”, “maksimaliste” etj. kështu do të ndodhin shumë ngjarje të hidhëta dhe pak gjëra të mira për shqiptarët. Ndodhitë e errëta do të shkojnë deri në finalizim, ndërsa ato të mirat do të mbesin vetëm nisma, ngase partitë shqiptare pasi akomodoeshin në kolltukët qeveritar i harronin nismat.

Paraqitja e luftëtarëve të lirisë në Maqedoni në fshatin Tanushë i gjeti të hutuar si udhëheqësit maqedonas ashtu edhe ata shqiptarë. Maqedonasit që në ditët e para do të mundohen që Ushtrinë çlirimtare Kombëtare ta quajnë si grup terroristësh të infiltruar nga Kosova në Maqedoni dhe si ish-mbeturina të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo TMK-së që nuk kanë gjetur vend në strukturat e atjeshme. Ata disa herë do t'i quajnë edhe kontrabandistë që janë revoltuar pasi u janë prerë rrugët e kontrabandës. Gjithashtu edhe partia shqiptare në pushtet PDSH u gjetën të hutuara nga paraqitja e ushtrisë dhe me dashje apo pa dashje u fut në skemat e të menduarit maqedonisht. Gjithashtu, nuk duhet harruar edhe marshi i PDSH-së në Shkup, që në mënyrë simbolike shprehte dorëzimin e pakusht të shqiptarëve, Trajkovskit.

Mirëpo, kështu nuk mendonte populli, prandaj është me vend thënia se populli kurrë nuk gabon. Ai, edhe kësaj radhe si edhe herave tjera nuk mundi të gabonte sepse në ato male i kishte bijtë dhe bijat e vetë.

Kjo u vërtetua më 14 mars 2001 në Tetovë, kur Shoqatat Joqeveritare si: Forumi për të drejtat dhe liritë e qytetarit, Shoqata e Historianëve Shqiptarë në Maqedoni, Lidhja e Gruas Shqiptare në Maqedoni organizuan protestën “STOP DHUNËS DHE TERRORIT SHTETËROR NË MAQEDONI”, popullata shqiptare e tubuar në sheshin e Tetovës, krismat e Luftëtarëve të Lirisë në kalanë e Tetovës i pritën me duartrokitje, dhe brohoritje UÇK, UÇK, UÇK...

Jehona e UÇK-së u përhap shpejt dhe u shndërrua në kryengritje e cila u shtri nga Tanusha, në fshatrat e malësisë së Shkupit, të Likovës, të Kumanovës e të Tetovës.

Komuniteti ndërkombëtar në fillim të luftës do të jetë shumë i papërgatitur për të menaxhuar këtë krizë të re që i paraqitej. Me të shpejt ë do të bëj një angazhim të madh që t'i kap fijet e luftës në Maqedoni. Si çdoherë duke dashur të ruaj status –quon në Ballkan ku tani pika më nevralgjike ishte Maqedonia, që me të vërtetë do t'i sillte probleme të mëdha jugut të Ballkanit se ku do të hapej “kutia e Pandorës”. Serbia edhe vet ia kishte frikën frontit të Jugut që ishte më serioz se ai i Veriut, për arsye se këtu gërshetohen interesat e disa shteteve ballkanike që kanë pretendime territoriale ndaj Maqedonisë. Në pamundësi që Serbia të intervenojë në Maqedoni, ashtu si veproi me ish-republikat jugosllave do të iniciojë Konferencën e Athinës për ndarjen e Maqedonisë mes Serbisë, Bullgarisë dhe Greqisë. Të gjitha këto rrethana si dhe rrethana të tjera strategjike do ta nxisin faktorin ndërkombëtar që me të ngut të ngjitet maleve dhe të bisedojë me përfaqësuesin politik të UÇK-së zotin Ali Ahmeti, i cili ishte paraqitur haptas dhe po ua tregonte të tjerëve sesi dukej “Maqedonia e qetë dhe romantike”. Por sipas asaj që ndodh ajo nuk ishte as e qetë, e as romantike. Stabiliteti i dukshëm i saj ishte artificial. Ndarjet e thella të brendshme dhe mosbesimi ndërnacional qenë aty gjatë gjithë kohës duke zier nën sipërfaqe.

Maqedonasit dhe gati të gjithë fqinjët sllav mundoheshin të argumentojnë se kriza shqiptare në ish-Jugosllavi ishin shprehje e idealit të Shqipërisë së madhe, siç pretendonin të thonë ata. Duke u nisur nga botimi i një koncepti të ri në Institutin Shiller nga Lordi Oven me titull: “Drejt një politike të re amerikane për Ballkanin”<sup>135</sup>, të cilën politikë e konceptonin ata, si ndihmesë për shqiptarët. Në këtë kohë në Maqedoni bile do të krijohet një klimë e keqe antiamerikane nga maqedonasit, si sulmet ndaj ambasadës amerikane, djegia e flamujve amerikanë dhe atij të NATO-s në mitingjet maqedonase<sup>136</sup>.

Në anën tjetër, faktori shqiptar u gjet në gjendje kaosi dhe jounik. Partitë shqiptare duke mos ditur si t'i përballojnë këto situata i ndryshonin qëndrimet e tyre brenda ditës, dhe merreshin me etiketimet e natyrës brutale. Në të kundërtën, një menaxhim i drejtë i situatës, kërkonte një qasje praktike ndaj problemeve ku duhej një angazhim i plotë i tërë potencialit intelektual dhe politik shqiptar. Faktori shqiptar në këtë situatë duhej t'i prezantoj në mënyrë të drejtë kërkesat

---

<sup>135</sup> *Maqedonia, “Konflikti dhe mediat” IMM, Shkup 2003, fq.44*

<sup>136</sup> *Hiseni Mahir, “Zhvillimet në Maqedoni dhe lindja e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare” Tetovë 2002, fq. 113*

legjitime të popullit që kësaj t'i dëshmonte faktorit ndërkombëtar se aspiratat e Luftëtarëve të lirisë janë për një Maqedoni stabile ku parakusht është harmonia ndëretnike.

Si në çdo luftë edhe në këtë, ndërkombëtarët synojnë që palët e konfliktuara t'i sjellin në tryezën e bisedimeve. Edhe pse me të madhe trumbetohej nga ana e tyre se nuk do të ketë bisedime me “terroristët”, ata që në fillim do të vrapojnë pas tyre që të mësojnë më tepër se çka duan ata. Pavarësisht nga rrethanat e disfavorshme në arenën ndërkombëtare, UÇK falë mençurisë së udhëheqësve të saj, dhe strukturave ushtarake të organizuara dhe të disiplinuar mirë, më shpejtë u bë forcë dinamike dhe përshpejtuese e proceseve dhe ndryshimeve strukturale. Ajo mundësoi që çështja shqiptare në Maqedoni të del në rend të ditës për t'u diskutuar. Kësaj çështje i kontribuoi para së gjithash fitorja e UÇK-së në të gjitha fushëbetet me forcat policore, ushtarake e paramilitare maqedonase.

Rrethanat që u krijuan në Maqedoni, paraqesin momentin e konfrontimit mes dy koncepteve, atij lindor, anti-nato, anti-evropian që përfaqësohet nga elita maqedonase dhe mbarë shtypi maqedonas dhe koncepti perëndimor që përfaqësohet nga ajo shqiptare, që e sheh NATO-n si faktor stabiliteti që pretendon kultivimin e vlerave evropiane, respektimin e dallimeve politike, kulturore, racore, gjinore etj. Për të pasur pas perëndimorët, udhëheqësit luftarak do të dijnë në momente të caktuara për çështje të mëdha të bëjnë lëshime të vogla, duke lëshuar për opinionin e brendshëm dhe të jashtëm komunikata të ndryshme ku ua bënin me dije atyre se qëllimi i fundit i Luftëtarëve të Lirisë nuk është prishja e Maqedonisë, por përkundrazi forcimi i saj si shtet i të barabartëve.

Pasi partitë politike shqiptare në Maqedoni u gjetën të befasuara nga paraqitja e UÇK-së dhe sukseset e saj. Si dhe nga ana tjetër të shtrënguar nga faktori ndërkombëtar që të bëjnë çmos të ndalojnë përhapjen e luftës, rast vendimtar për të menduar njëjtë do të jetë Marrëveshja e prizrenit mes dy liderëve politik dhe atij ushtarak të shqiptarëve në Maqedoni. Në këtë takim mes liderëve politik shqiptar dhe komandës së lartë të UÇK-së, ndihmesë më të madhe do të jap i dërguari i posaçëm i Organizatës për Sigurim dhe bashkëpunim Evropian (OSBE) në Maqedoni, Robert Frovik. Aktiviteti i tij rezultoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Prizrenit mes tre liderëve politik dhe ushtarak të shqiptarëve (Ymeri, Xhaferi dhe Ali Ahmeti). Ky takim nuk duhej të ishte aq madhështor sa që u bë në kushte normale, por në kushtet e atëhershme kur udhëheqësit e partive politike nuk ishin në një vijë me UÇK-në ishte me të vërtetë lehtësuese për shqiptarët. Ky takim ia bëri me dije faktorit ndërkombëtar, sidomos atij të brendshëm

maqedonas, se lufta e ka burimin nga brenda e jo nga jashtë siç i serohej popullatës maqedonase. Këtu u mbyllën të gjitha kalkulimet e palës maqedonase, sepse shkaqet e konfliktit tanimë marrin adresën e saktë e ato janë raporte ndëretnike të pazgjidhura me dekada në Maqedoni.

Marrëveshja e Prizrenit ishte oferta më e sinqertë e shqiptarëve, drejtuar palës maqedonase, por vazhdimi i konfliktit të armatosur dhe eskalimi i tij në luftë të ashpër pas Marrëveshjes së Prizrenit e tregoi fytyrën e vërtetë të udhëheqësish shoviniste maqedonase.

Edhe pse do të tentohet nga ana e ndërkombëtarëve që Marrëveshjen e Prizrenitveç faktorit maqedonas dhe atij ndërkombëtar, ta hedhin edhe partitë shqiptare, për të,parën herë udhëheqësit e PPD-së dhe PDSH-së do t'u rrinë konsekuent nënshkrimeve të tyre.

Tani pas nënshkrimit të marrëveshjes do të zhvillohen dy procese të kundërta brenda dhe jashtë Maqedonisë:

1. Pala maqedonase në pushtet e gjetur në befasi pas heqjes së paravënit PDSH-PPD, në pamundësi të kamuflimit të mëtejshëm të veprimeve antishtetërore dhe terroriste, do të vazhdojë në ofensivën e egër ndaj fshatrave të banuara me shqiptarë në komunën e Likovës, Kiumanovës, të Shkupit dhe të Tetovës, si qëllim të fundit dëbimin e shqiptarëve nga Maqedonia dhe pastrimin etnik për të krijuar rrethana për ndarjen e Maqedonisë siç qe edhe propozimi i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Maqedonisë, e kryesuar nga Gjorgji Efremov<sup>137</sup>.
2. Procesi i krijimit dhe formimit të bindjes në faktorin ndërkombëtar për domosdoshmërinë e ndërhyrjes ushtarake në Maqedoni, pa pjesëmarrjen e forcave ushtarake të shteteve fqinje, me qëllim të ruajtjes së integritetit të saj të cenuar nga Serbia dhe mbajtja e pranisë së tyre derisa nuk kryhet çmilitarizimi dhe demokratizimi i domosdoshëm i saj me çka do të stabilizohet i gjithë rajoni.

Pas Marrëveshjes së Prizrenit 22 maj 2001, në mes Xhaferit, Ymerit dhe Ahmetit, UÇK më 14 qershor 2001, paraqiti edhe projektin për dhënien fund të luftës në Maqedoni. Në fillim të këtij projekti thuhet se UÇK është për ndërprerjen e luftës dhe sigurimin e paqes, për krijimin e një shteti multietnik si dhe për mbushjen e kërkesave të saj. UÇK thekson se për të realizuar këtë, nevojitet një zgjidhje diplomatike dhe një gatishmëri për t'u dhënë fund aksioneve ushtarake ndaj forcave militare maqedonase. Ky projekt shpjegon fushat, se ku duhet të konsistoj marrëveshja, e ato janë tri: rrafshi ushtarak, diplomatik dhe ai politik.

---

<sup>137</sup> Fakti, Shkup, 23 Maj 2001

Këto veprime Ushtria Çlirimtare Kombëtare do t'i propozojë duke u përcaktuar për paqe dhe me qëllim të ndërprerjes së luftës në Maqedoni, duke dashur të kontribuojë në stabilitetin dhe sigurinë e përgjithshme rajonale, t'i hap rrugë zgjidhjes diplomatike dhe duke dashur që të promovojë një model të shtetit multi-etnik të Maqedonisë në kufijtë e saj ekzistues.

Bashkësia ndërkombëtare përmes përfaqësuesit të Unionit Evropian Fransua Leotar dhe atij amerikan Xhejms Perdjju, do të del më 17 korrik 2001, me versionin e vet për zgjidhjen e krizës në Maqedoni, i cili dokument do të jetë i bazuar nga prezantimi i dokumentit të Robert Badinterit më 28 qershor 2001. Dokumenti i quajtur "Versioni i Draft Dokumentit Kornizë" do t'u dorëzohet liderëve të katër partive kryesore politike, si dhe vet kryetarit Trajkovski. Dokumentin në fjalë pala shqiptare nuk do ta hedh në tërësi, por do të cek se parimi i tillë i çështjeve të hapura nuk ndalon luftën në Maqedoni, kurse pala maqedonase do ta pranonte dokumentin bazë të ekspertëve ndërkombëtar, duke propozuar ndryshimin e disa amendamenteve.

Por në anën tjetër partitë politike shqiptare si dhe UÇK, janë deklaruar kundër propozimit të fundit të Fransua Leotar dhe Xhejms Perdjju, ngase ata nuk përfshijnë dy kërkesat kyçe të palës shqiptare: njohjen e popullit shqiptar për popull shtetformues, si dhe gjuhën shqipe të jetë gjuhë zyrtare në të gjitha nivelet shtetërore, dhe jo vetëm në ato lokale.

Pas një bredhje LARTË POSHTË të përfaqësuesve ndërkombëtar dhe të faktorit të brendshëm politik, pas luftërave të ashpra të forcave ushtarake shqiptare dhe atyre maqedonase, dhe pas mosrespektimit të armëpushimeve nga ana e forcave maqedonase dhe UÇK-së, për t'i dhënë hapësirë zgjedhjes diplomatike, me shumë mund do të arrihet Marrëveshja Kornizë, e cila do të nënshkruhet më 13 gusht 2001 në Shkup.

Përmbajtja e Marrëveshjes Kornizë për zgjidhjen e situatës politike e të sigurisë në Maqedoni do të nënshkruhet nga kryetari i Republikës së Maqedonisë, Borios Trajkovski, lideri i VMRO-DPMNE dhe kryeministër Lupço Georgievski, lideri i LSDM-së Branko Crvenkovski, ai i PPD-së Ymer Ymeri dhe lideri i PDSH-së Arben Xhaferi. Gjithashtu, nënshkrime në dokument si dëshmitar zyrtar do të vënë edhe lehtësuesit ndërkombëtar në dialog Fransua Leotar dhe Xhejms Perdjju.

Për arritjen e kësaj marrëveshje qytetarët e Maqedonisë duhet t'u jenë mirënjohës të gjithë diplomatëve, personaliteteve me ndikim, duke filluar nga administrata e SHBA-ve dhe presidentit Bush, ashtu edhe nga Solana, Robertson, Perdjju, Leotar, Frovik... por, më tepër duhet

t'u jenë mirënjohës luftëtarëve shqiptar të UÇK-së dhe udhëheqësit të saj politik zotri Ali Ahmetiot. Në anën tjetër ata politikanë shqiptarë dhe maqedonas, të cilët nuk e kuptuan porosinë e krismës së pushkës së parë në Tanushë, se duhej të shpejtojnë avancimin e të drejtave përmes rrugës paqësore, e bartin përgjegjësinë historike, morale dhe politike për viktimat në njerëz, shkatërrimin e objekteve dhe pasurinë dhe të gjitha traumat njerëzore që i shkaktoi kjo luftë. Nderimi më i madh ndaj luftëtarëve të UÇK-së dhe sidomos ndaj atyre që e humbën jetën, nderimi ndaj familjeve të tyre që kishin synim paqen përmes pushkës!

Më 27 gusht 2001, filloi demobilizimi dhe dorëzimi i armëve nga ana e luftëtarëve të UÇK-së. Vjeshta e vitit 2001, kur UÇK u demobilizua dhe bëheshin hapat e para për risocializimin e tyre, tanimë ish-luftëtarë të UÇK-së, Ali Ahmeti përsëri me bujarinë e madhe që kishte, me të cilën tregoi se luftën e ka bërë për popullin e jo për vete, do t'i thërras partitë politike për të themeluar Trupin Koordinues të partive, me qëllim që zgjedhjet e ardhshme parlamentare t'i presin sa më të përgatitur.

***Kapitulli IV***  
***Kosova në periudhën 1997-1999-UÇK-ja***

#### 4.1. Organizimi i shqiptarëve dhe lufta e tyre e armatosur

Pasi aktiviteti diplomatik i Diplomacisë së Kosovës në këtë periudhë nuk dha rezultate të duhura për zgjidhjen e çështjes së Kosovës atëherë shqiptarët do të zgjedhin ose do të kërkojnë rrugën alternative. Një nga këto alternativa do të jetë formimi i forcës ushtarake e cila zanafillën e ka në **Lëvizjen politike ilegale**, pas **Luftës së Dytë Botërore**, kulmi i se cilës u arrit me demonstratat e vitit 1981, kur studentët, rinia dhe populli i Kosovës, shprehu vendosmërinë për çlirimin e Kosovës. Pjesëmarrësit në demonstratat e vitit 1981, ndonëse u burgosën apo u arratisën, nuk u tërhoqën nga rruga e nisur për liri. Kudo që ishin: si refugjatë politikë në vendet e **Evropës Perëndimore** dhe ata që mundën të mbijetonin në Kosovë, gjatë dhjetëvjeçarit 1981-1990, krijuan organizata të ndryshme, politike. Këto organizata, në themel të programeve të tyre kishin luftën e armatosur çlirimtare. Veprimtarët e tyre ishin patriotë, të mbrujtur me idealet e çlirimit e të bashkimit kombëtar dhe përbënin bërthamën e ushtrisë së ardhshme të Kosovës, rruga luftarake e së cilës kaloi nëpër katër faza kryesore.<sup>138</sup>

**Organizimi.** Në fazën e parë u krijuan grupet e vogla guerile, sipas skemave tepër konspirative të luftës ilegale. Në fazën e dytë u zgjeruan grupet, u rrit numri i luftëtarëve, u njohën komandantët. Në fazën e tretë u krijuan repartet e organizuara nga oficerë profesionistë, që erdhën në Kosovë nga Kroacia, Bosnja, si dhe nga ata që kishin dezertuar nga ushtria jugosllave e disa vullnetarë nga Shqipëria. UÇK-ja mori plotësisht formë të rregullt, me rreshtim organik, me uniformë, me armatim, me kazerma dhe qendra stërvitore etj, brenda në Kosovë dhe jashtë saj. Në fazën e fundit të katërt, struktura organizative u ndërtua me brigada, si njësi më të fuqishme luftarake.<sup>139</sup>

Burgosjet E vitit 1993 ishin goditje e rëndë për organizimin e Luftës Çlirimtare, në këtë kohë nga e tërë Kosova u burgosën 19 pjesëtarë të UÇK-së dhe u akuzuan shumë të rinjë shqiptarë nën akuzën se ata kishin për qëllim që Kosovën dhe pjesët tjera të tokave të formojnë shtet të pavarur ose ti bashkohen Shqipërisë.<sup>140</sup>

<sup>138</sup> Sulo Arifaj, "UCK në mes të përkrahjeve dhe pengesave" Prishtinë 2000 faq 135

<sup>139</sup> Pushkolli Fehmi "vepër e cituar" faq 164

<sup>140</sup> Pushkolli Fehmi; "vepër e cituar" faq 45



**Faza e parë (1981-1990)** ishte faza e kristalizimit të idesë së luftës së armatosur, që u karakterizua nga përpjekjet për organizimin politik dhe për ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në nivelin e përgjegjesisë historike.

**Faza e dytë (pranverë 1991-shkurt 1998)** ishte faza e organizimit konkret të njësiteve të vogla guerile dhe fillimi i aksioneve të armatosura kundër policisë serbe. Në vitin 1991 një grup atdhetarësh të ardhur nga Kosova, Zvicra e vende të tjera, me Adem Jasharin në krye, u stërvitën ushtarakisht për rezistencë të armatosur guerile. Adem Jashari i pari krijoi grupin e Drenicës dhe në vitin 1992 filloi aksionet e para luftarake. Më 5 prill 1993, në kullën e tij u organizua një mbledhje me luftëtarët e njësiteve guerile dhe veprimtarët politikë. Adem Jashari propozoi që të gjitha aksionet të kryheshin në emër të Ushtrisë së Kosovës.<sup>141</sup> Në këtë mbledhje u mor vendimi për emërimin e Adem Jasharit Komandant i Përgjithshëm i Ushtrisë së Kosovës, e cila në vjeshtën e vitit 1994 mori emrin Ushtria Çlirimtare e Kosovës ( UÇK ). Adem Jashari i bashkërendoi veprimet me zonat e tjera, si me grupin e Llapit - që udhëhiqej nga Zahir Pajaziti etj. me grupin e Dukagjinit që drejtohej nga Luan Haradinaj, Ardian Krasniqi etj. Në nëntor të vitit 1994, pas aksionit në Drenas (ish-Gllogoc), UÇK-ja doli me komunikatën e parë, duke marrë mbi vete të gjitha aksionet e kryera që deri atëherë kishin mbetur anonime. UÇK-ja u përmend në shtypin perëndimorë dhe cilësohej si lëvizje individësh të veçuar, lëvizje “atentatorësh” . Në mjetet e informimit serb për disa vite me rradhë përgënjeshtrohej ekzistimi i saj ndonëse emri i UÇK-së citohej se kishte lajmëruar marjen përsipër të aksioneve.<sup>142</sup> Hapur në publik, ajo u shfaq më 28 nëntor 1997, gjatë ceremonisë së varrimit të arsimtarit Halit Geci nga Llausha e Skënderajit, të vrarë nga policia serbe. Në atë ceremoni, në tribunë u ngjiten të veshur me uniformën e UÇK-së luftëtarët e UÇK-së dhe komandantët e ardhshëm: Rexhep Selimi, Mujë Krasniqi dhe Daut Haradinaj.<sup>143</sup> Në shkurt - mars 1998, Adem Jashari me njësitin e tij ushtarak, vuri nën kontrollin e UÇK-së territorin e Drenicës. Forca të shumta ushtarako-policore të armatosura me autobllinda e artileri të rëndë sulmuan Drenicën. Adem Jashari luftoi tri ditë e net nga kulla e tij, së bashku me gjithë familjen (prindër, vëllezër, gra dhe fëmijë). Asnjë nga anëtarët e familjes dhe shumë nga farefisi nuk pranuan të largohen, por luftuan derisa ranë 56 veta: burra, gra dhe fëmijë nga moshja 9 deri 74 vjeç, të gjithë sa u gjendën në kullat e Jasharajve natën e parë të luftimit.

<sup>141</sup> Buja Ramë “Çështja e Kosovës dhe shkatërrimi i Jugosllavisë” Prishtinë, 2007 faq.315

<sup>142</sup> Vepër e cituar ASHSH faq 133.

<sup>143</sup> Krasniqi Jakup “Kthesa e Madhe –Ushtria Çlirimtare e Kosovës” Prishtinë, 2006 faq. 67

**Faza e tretë (mars 1998 - shtator 1998)** filloi pas rënies së Adem Jasharit, kur UÇK-ja u rrit me shpejtësi dhe u shtri menjëherë në të gjitha viset dhe anët e Kosovës. Gjatë kësaj faze UÇK-ja çliroi zona të tëra, krijoi bazat e veta strategjike, u armatos, u krijuan repartet e rregullta, të cilat përgatiteshin në qendrat e stërvitjes, sipas kushteve të një ushtrie bashkëkohore. Në pranverë dhe verë 1998, UÇK-ja vuri nën kontroll degëzimet e rrugëve më strategjike në Kosovën qendrore. Forcat ushtarako-policore serbe u detyruan të tërhiqen nëpër qytetet e mëdha të Kosovës. **Takimi i diplomatit amerikan Richard Holbruk** (qershor 1998) me përfaqësuesit e UÇK-së në Junik, shënoi njohjen e saj nga SHBA-ja dhe, më pas nga Evropa, gjë që u konkretizua më **Konferencën Ndërkombëtare të Rambujesë për Kosovën**, kur UÇK-ja u njoh ndërkombëtarisht, dhe mori rolin udhëheqës në delegacionin shqiptar. Mësymja e madhe serbe në gusht - shtator 1998, i shkaktoi UÇK-së humbje dhe e detyroi të lëshonte një pjesë të madhe të zonave të lira. Ajo u tërhoq në zonat malore. Forcat ushtarake serbe u futën nëpër fshatra dhe në zonat urbane, që mbaheshin nga UÇK-ja, si Rahoveci, Malisheva etj., dhe kryen masakra, djegie e shkatërrime të mëdha, për të larguar popullsinë, që ishte mbështetja kryesore e UÇK-së.

**Faza e katërt (tetor 1998 - qershor 1999)** filloi pas mësymjes serbe, kur UÇK-ja, megjithëse mori goditje të rëndë nuk u asgjësua, siç ishte qëllimi e siç deklaronte Serbia; UÇK-ja u bë dhe më e fortë se më parë; u riorganizua shpejt me formacione më të mëdha, në brigada. Kjo fazë u karakterizua nga zhvillimi i luftimeve në të gjithë hapësirën e Kosovës, pa vija fronti të përcaktuara, duke dhënë goditje më të fuqishme armikut shekullor. Bazat strategjike, Shtabi i Përgjithshëm, spitalet, **radioja "Kosova e lirë" dhe agjencia "Kosovapress" etj.**, u mbrojtën me çdo kusht në Malet e Berishës. Në këtë fazë, krahas mobilizimit vullnetar, me vendim të Shtabit të Përgjithshëm u zbatua edhe mobilizimi i detyrueshëm për luftë. Thirrjes për luftë iu përgjigj vullnetarisht populli, por edhe një pjesë e konsiderueshme të emigruarish, djem e vajza që jetonin e punonin në vendet e **Evropës Perëndimore, në SHBA** e gjetiu. Në **SHBA u krijua "Batalioni Atlantik"**, i cili, pasi u stërvit dhe u armatos jashtë Kosovës, u fut në luftë në frontin e Koshares dhe në atë të Pashtrikut.<sup>144</sup> Strategjia e luftës së Kosovës përbëhet nga dy pjesë: strategjia politike dhe strategjia ushtarake. Strategjia politike përmbante konceptin e ndërgjegjësimit e të mobilizimit të popullit shqiptar të Kosovës për luftën e armatosur kundër pushtimit serb, si e vetmja rrugë për fitoren e lirisë, duke siguruar mbështetjen mbarëkombëtare dhe duke bindur faktorin ndërkombëtar për drejtësinë e luftës. Kjo strategji u përpunua nga

---

<sup>144</sup> Lushi Uk "Batalioni Atlantiku" Prishtinë 2001 faq111

Drejtoria Politike e UÇK-së. SHP i UÇK-së, jo pa vështirësi, ia arriti qëllimit të bindte shqiptarët për mundësitë e mposhtjes së Serbisë me luftë dhe faktorin ndërkombëtar për ta njohur dhe mbështetur luftën e drejt të shqiptarëve. U hodh poshtë çdo akuzë ndaj UÇK-së, si forcë "terroriste", si lëvizje revolucionare "marksiste-leniniste" apo si lëvizje "fundamentaliste islamike". Përpunimi i strategjisë politike, bazuar në parimet universale të dokumenteve ndërkombëtare dhe të zbatuara me korrektësi në fushën e luftës nga UÇK-ja, e cila nuk vriste gra e fëmijë, civilë të paarmatosur, robërit e luftës i trajtonte me humanizëm, në përputhje me normat ndërkombëtare të luftës etj., e bindi botën demokratike për drejtësinë e luftës që zhvillonte dhe siguroi mbështetjen e SHBA-së e të NATO-s si faktorë të fuqishëm të jashtëm për çlirimin e Kosovës. Strategjia ushtarake përmblihte konceptin e vazhdimësisë në rritje të luftës së armatosur, duke kaluar nga njësitet e vogla në njësi të mëdha, derisa e gjithë Kosova të ngrihej në këmbë dhe të shndërrohej në forcë asgjësuese për armikun, për ta detyruar atë të largohej nga toka e okupuar e Kosovës. Me gjithë përpjekjet që u bënë, nuk u arrit që i gjithë populli të përfshihej në luftë për shkakun kryesor se i mungonin armët. Taktika e luftës evoluoi sipas fazave. Në fazën e dytë - luftë sipas taktikës guerile, në fazën e tretë - krijimi i zonave të lira, bllokimi i rrugëve të komunikacionit dhe mbrojtja e zonave të lira nëpërmjet luftës ballore nga pozicione të përgatitura me punime xheniere. Taktika e luftës pozicionale iu imponua UÇK-së nga domosdoshmëria e mbrojtjes së popullsisë prej masakrave serbe. Përdorimi i kësaj taktike, me anën e së cilës u krijuan zona të tëra të lira, ia rriti shpejt autoritetin UÇK-së në Kosovë e në botë. Në fazën e katërt, të mësymjes së madhe serbe për spastrimin rrënjësor etnik të Kosovës, ishte e pamundur të zhvillohej kudo luftë ballore. Prandaj u hoq dorë nga mbajtja me çdo kusht e zonave të lira, përveç bazave strategjike dhe korridoreve të furnizimit. Në këtë fazë u kalua në luftën pa front të rregullt, duke dhënë goditje të fuqishme me reparte e brigada në të gjithë Kosovën. Këtë e diktoi edhe fakti se me fillimin e bombardimeve të NATO-s, forcat serbe u shkoqën, u shpërndanë, u maskuan nëpër qendra të banuara, në shtëpitë dhe pronat e shqiptarëve. Veprimet e UÇK-së, gjatë kësaj kohe, u bashkërenduan me sulmet ajrore të NATO-s.

Në maj 1999 struktura e UÇK-së përbëhej nga: Shtabi i Përgjithshëm dhe 7 Zona Operative:

- Zona Operative Nr.1 e Drenicës me 4 brigada;
- Zona Operative Nr.2 e Pashtrikut me 6 brigada;
- Zona Operative Nr.3 e Dukagjinit me 8 brigada;

- Zona Operative Nr.4 e Shalës me 4 brigada;
- Zona Operative Nr.5 e Llapit me 4 brigada;
- Zona Operative Nr.6 e Nerodimjes me 3 brigada;
- Zona Operative Nr.7 e Karadakut me një brigadë.<sup>145</sup>

Kjo ushtri arriti një efektiv nga 40.000 deri në 50.000 mijë veta. Me këtë forcë UÇK-ja përballoi mësymjen serbe të pranverës 1999 dhe në aleancë me NATO-n, ajo nga toka dhe Aleanca nga ajri, e detyruan ushtrinë serbe ta lëshonte Kosovën. Më 10 qershor 1999, UÇK-ja u fut ngadhënjyeshëm në Prishtinë dhe në qytetet e tjera të Kosovës, duke i sjellë popullit të vet lirinë e ëndërruar në shekuj.

**Logjistika.** Problemi më i vështirë për UÇK-në ishte furnizimi me armë e municione. Ato u siguruan jashtë Kosovës e u futën në Kosovë, duke kapërcyer vështirësi e pengesa të jashtëzakonshme, që kushtuan shumë jetë njerëzish. Një pjesë e vogël u siguruan nga perëndimi e nga tregtarët e vendeve për rreth. Armatimi i UÇK-së ishte armatim i lehtë: automatikë, mitraloza, mortaja dhe topa kundërtanke. Kontributin më të madh për logjistikën e UÇK-së e dhanë populli i Kosovës, djemtë e Kosovës, emigrantë në Perëndim, nëpërmjet financimit të grumbulluar në fondin "**Atdheu në rrezik, Vendlindja thërret**"<sup>146</sup>.

**Drejtimi.** Shtabi i Përgjithshëm u themelua në nëntor të vitit 1994, kur doli komunikata e parë. Në mbledhjen themeluese morën pjesë: Adem Jashari, Xhavit Haziri, Nait Hasani, Azem Sylja, Xhavit Haliti, Sokol Bashota e më vonë iu bashkëngjit edhe Zahir Pajaziti etj, Shtabi i Përgjithshëm u zgjerua dhe u kualifikua me zhvillimin e luftës dhe rritjen e UÇK-së. Ai përbëhej nga dy pjesë kryesore: drejtoria politike e drejtuar nga Hashim Thaçi dhe shtabi ushtarak, i përbërë nga drejtoritë operative: të zbulimit, të logjistikës, të personelit dhe mobilizimit, të ndërlikjes, të financës, të policisë ushtarake, të informimit, etj. Shtabi ushtarak u drejtua nga Komandant i Përgjithshëm i UÇK-së Azem Sylja. Anëtarë të shtabit ishin: Hashim Thaçi, Sokol Bashota, Jakup Krasniqi, Bislim Zyrap, Rexhep Selimi, Kadri Veseli, Ramë Buja, Lahi Ibrahimaj Fatmir Limaj etj. Në përbërje të drejtorisë politike qenë: Adem Demaçi, Xhavit Haliti, Bardhyl Mahmuti, Jakup Krasniqi, Ramë Buja Bilall Sherifi etj. Karakteristikat kryesore të UÇK-së ishte Lufta e drejt dhe përcaktimi për t'u sakrifikuar për lirinë e atdheut. Aktet e saj të heroizmit përbëjnë pika kulmore nga më të lartat që njeh historia jonë kombëtare e kohës së re.

<sup>145</sup> *Krasniqi Jakup "Kthesa e madhe UÇK" Prishtinë 2006, faq 131*

<sup>146</sup> *Elshani Gafur "Ushtria Çlirimtare e Kosovës-dokumente dhe artikuj" Prishtinë 2003, faq, 34*

#### 4.2. Konferenca e Rambujesë-konferenca e parë ndërkombëtare për Kosovën

Pas rezistences ushtarake të forcave të UÇK-së faktori ndërkombëtarë u bind me seriozitetin e luftës për çlirimin e Kosovës. Njëkohësisht më 15 janar 1999 serbët kryen njënjën nga masakrat më të pashpirta mbi popullatën shqiptare. **Ambasadori Amerikan Williams Woker me këtë rast tha** “kam qenë në misione të ndryshme por diçka të këtillë nuk kam parë kurrë”,<sup>147</sup> si rezultat i kësaj situatë diplomacia Amerikane fillon me aktivitetin diplomatik për ndërkombtarizimin e ceshtjes shqiptare me cka për herë të parë u vendos që të thuret një konferencë ndërkombëtare ku në mënyrë të barabartë shqiptarët u ulën në tavolinën e bisedimeve me serbët. Kjo konferencë edhe përkundër propagandës serbe që të pengojë udhëtimin e delegacionit politiko-ushtarak përsëri me ndihmen e diplomacisë Amerikane delegacioni i Kosovës ariti në Rambuje. Marrëveshjet që ishin bërë me **Misionin Diplomatik Vëzhgues Amerikan në Kosovë**, i njohur me shkurtesën **KDOM**, që kishin marrë përsipër përcjelljen e luftëtarëve të lirisë, pjesëtarë të Delegacionit, bënë me dije se Delegacioni duhej të nisej në kohën e paraparë, sepse përgjigjja nga pushtetarët serbë pritej të vinte në çdo çast.<sup>148</sup>

Delegacioni i UÇK – së, nga selia e Shtabit të Përgjithshëm në Divjakë u nis saktë, në ora 11 e 30 minuta, i përcjellë me nderimet më të larta ushtarake që i bëri Njësi Special i Gardës së Nderit pranë Shtabit të Përgjithshëm. Tri makinat e terrenit u nisën për në fshatin Shalë ku Delegacioni, në bazë të marrëveshjes, duhej të takohej me misionarët e **KDOM-it\*** dhe udhëheqësin e tij z. **Shon Bërns\***, për të vazhduar rrugëtimin nën përkujdesjen e tyre dhe me makinat e tyre të blinduara për në Aeroportin e Prishtinës.<sup>149</sup>

**M z. Shon Bërns**, pjesëtarët e delegacionit ishin marrë vesh që, me vete të mbanin edhe armët e lehta personale, për shkaqe të sigurisë akoma më të lartë. Përfaqësuesit e UÇK-së patën insistuar që në Konferencë të paraqiteshin me uniformë ushtarake, meqë edhe përfaqësonin Ushtrinë. Mirëpo, kjo kërkesë nuk u pranua, më shumë nën arsyetimin se nuk posedonin kostume solemne ushtarake, ndërsa ishte e pamundur pjesëmarrja në Konferencë me rroba

<sup>147</sup> Ndrecaj Mikel “vepër ecitur” faq, 330

<sup>148</sup> Sulo Arifaj “UÇK-ja në mes të përkrahjeve dhe pengesave” Prishtinë 2000 faq 73

\*KDOM- Misioni diplomatik vëzhgues në Kosovë

\*Shon Bërns- shef i misionit diplomatik vëzhgues në Kosovë

<sup>149</sup> Buja Ramë “Konferenca e Rambujesë (aspekti juridik, politik e ndërkombëtarë) Prishtinë 2006 faq 43

terreni.

Në mesditën e 6 shkurtit 1999, serbët ishin detyruar nga ndërkombëtarët që të jepnin përgjigje pozitive për lejimin edhe të delegacionit të UÇK-së për të udhëtuar për në Rambuje.

Makinat e blinduara të KDOM-it me ngjyrë portokalli, arritën në fshatin Shalë të Drenicës. Në makinat e KDOM-it amerikan hynë të tre anëtarët e Delegacionit që do të udhëtonin nga Aeroporti i Prishtinës: Azem Syla, Jakup Krasniqi dhe Ramë Buja. Dy anëtarë të tjerë, Hashim Thaçi dhe Xhavit Haliti do të udhëtonin nga Aeroporti i Tiranës.

Në hyrje të Kështjellës mesjetare të Rambujesë, ishte grumbulluar një numër shumë i madh gazetarësh, kameramanësh, fotoreporterësh, të televizioneve, radiove dhe gazetave më prestigjioze, që rrinin në pritje të Delegacionit nga Kosova. Për kohën nuk kishte ngjarje në botë që tërhiqte më tepër vëmendjen e tërë opinionit ndërkombëtar, në këtë kohë, se sa kjo Konferencë. Dhe ky ishte fat i madh për Kosovën e vogël. Sytë dhe vëmendja e tërë diplomacisë botërore ishin drejtuar kah Kosova dhe Konferenca që po mbahej për të dhe për herë të parë me të.

Në ambientet e Kështjellës, një pjesë e delegacionit, ajo që vinte nga istikamet e luftës, ishte e armatosur. Habia e organizatorëve dhe delegacion-pritësve ishte e papërshkueshme, mbase ishte e paperceptueshme për ta, që në gjendje të një sigurie të jashtëzakonshme që mbretëronte që nga aeroporti , rreth Kështjellës dhe brenda saj, të mund të futeshin njerëz të armatosur. Dhe ç'është e vërteta, kjo ishte diçka e jashtëzakonshme për analet e takimeve të tilla, të këtij niveli dhe të këtyre përmasave diplomatike. Por, kjo ndodhi, në saje të marrëveshjes që qe bërë me udhëheqësin e **KDOM-it amerikan**, mikun e madh të shquar të shqiptarëve, **z. Shon Bërns**. Ai njeri, njihnte mirë mentalitetin dhe çmendësinë vepruese të serbëve, fjalën e dhënë dhe të mosmbajtur nga ata, andaj përveç përmasave të tjera të veçanta të sigurisë që ndërmoi për pjesën e delegacionit të UÇK – së, ai lejoi që ata me vete, për siguri shtesë, të bartin armët e tyre të brezit. Delegacioni i Kosovës, me të hyrë në Kështjellë u lajmërua se do të shkonte drejt e në sallën e Konferencës. Ngase, ajo do të fillonte menjëherë, pasi që delegacioni serb, organizatorët dhe kryesuesit, tanimë gjendeshin në sallë në pritje të delegacionit nga Kosova.

Kur hyri në sallë Delegacioni nga Kosova, të tjerët vërtet kishin qenë aty. Të gjithë përfaqësuesit e shteteve të **Grupit të Kontaktit** ishin aty, duke llogaritur edhe dy bashkëkryesuesit e Konferencës, **Ministrin e Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe z. Robin Cook**, si dhe, tre negociatorët, apo ndërmjetësit, ambasadorët; **Kristopher Hill (SHBA)**,

## **Wolfgang Petrich (BE), Boris Majorski (Rusi).**

Me t'u vendosur të Delegacionit të Kosovës në sallë, hyri Presidenti i Francës, **z. Zhak Shirak**. Ai në fjalimin e tij të shkurtër përshëndetës dhe sugjerues, duke i uruar suksese Konferencës, ua kujtoi negociatorëve se, po në këtë vend është bërë pajtimi franko-gjerman.

Franca, siç e dini, ka njohur tmerret e luftës do të thoshte ai. Ajo ka njohur fytyrën e barbarisë, por ka ditur të mjekojë plagët që dukeshin të përjetshme. Ajo ka ditur të dominojë urrejtjet që thuhej se ishin të lashta. Ajo, ju thotë juve sot, se vullneti për paqe është më i fortë se tundimi për luftë. Ky mesazh merr kuptim të plotë këtu, ku, së bashku, Gjenerali **Dë Gol** dhe **Kancelari Adenauer** ndërtnan të ardhmen.<sup>150</sup>

Fjalime përshëndetëse mbajtën edhe **z. Y. Vedrine dhe z. Robin Cook**, duke i përkujtuar ata për rëndësinë e këtyre bisedimeve, dhe për vëmendjen e botës që tani është përqendruar mbi ta, në pritje të suksesit. Me kaq dita e parë e Konferencës mbylli punimet, për të vazhduar në kontakte e takime të ndara me ndërmjetësit.

Delegacioni shqiptar i Kosovës, po këtë natë, pas orës 20.00, edhe pse të lodhur, mbajtën një takim të shkurtër, për t'u dakorduar rreth organizimit të Delegacionit dhe të punëve që dukeshin të jenë të shumta. Në këtë takim të parë, i pari mori fjalën Akademik Rexhep Qosja duke ju drejtuar pjesëmarrësve me këto fjalë: *„para se të flasim për këshilltarët dhe personelin teknik, para se të flasim për çka do tjetër, them, më duket e nevojshme, për më tepër më duket e domosdoshme, që në emrin tim dhe tuajin t'i përshëndes këta djem – pjesëtarë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dua të shpreh gëzimin pse jemi bashkë me ta. Ata na kanë sjellë këtu. Ne këtu, në Francë, vijmë prej Prishtinës – prej kushteve qytetare, kurse ata vijnë këtu prej kushteve luftarake. Kosova ishte në gjunjë e ata e ngritën në këmbë. Ne ishim të përkulur, tepër të përkulur, e ata na drejtuan. Ne shkonim për tokë, e ata na e kthyen nderin dhe dinjitetin. Ne ishim objekt në politikë, e ata me vetëflijet e tyre, me luftën e tyre, na bënë subjekt”*<sup>151</sup>. Ky takim nuk zgjati shumë, meqë akoma nuk kishte arritur z. Hashim Thaçi, me propozimin e atyre të UÇK-së, u la që takimi të vazhdonte të nesërmen në ora 09.00.<sup>152</sup>

Sipas marrëveshjes, të nesërmen, të gjithë anëtarët e delegacionit, në ora 9.00 u gjendën në sallën që ishte përcaktuar nga mikpritësit dhe organizatorët për ambient pune. Delegacioni shqiptar i Kosovës, me të hyrë në sallë, i përgatitur për të bërë konstituimin dhe konsolidimin e

<sup>150</sup> Ramë Buja, "vepër e cituar" faq 31

<sup>151</sup> Qosja Rexhep; "Paqja e përgjakshme Konferenca ndërkombëtare për Kosovën" Tiranë 1999 faq 143

<sup>152</sup> Krasniqi Jakup "vepër e cituar" faq 161

tij, u gjend përballë tre ndërmjetësve ndërkombëtarë, **z. Hill, z. Petrisch dhe z. Majorski**. Ata me vete kishin sjellë draftet e Projektkushtetutës së Kosovës dhe Projektin e Marrëveshjes së Përkohshme për Zgjidhjen e Problemit të Kosovës. Fillimisht elaboruan në pika të shkurta, materialet që sollën. Meqë, materiali ishte i pa përkthyer, ishte në gjuhën angleze, gjuhë kjo zyrtare e komunikimit në Konferencë.

Për zgjedhjen e kryesisë së Delegacionit dhe të kryesuesit, pati ca vështirësi që u tejkaluan me kurajë (kuptohet se kishte dallime konceptuale politike në mes delegacionit shqiptar nga Kosova). Në kryesi u zgjodhën Hashim Thaçi, Rexhep Qosja dhe Ibrahim Rugova. Nga pjesëtarët e UÇK-së dhe LBD-së u propozua Hashim Thaçi të jetë Kryesues i Delegacionit. Propozim ky që u kundërshtua nga ata të LDK-së, të cilët kërkuan që kjo çështje e fillimit të punës rreth këtyre drafteve, të bëhet nesër, sepse, përkthimi kërkonte kohë dhe delegacioni akoma nuk kishte mbaruar punët nismëtare organizative brenda vetes. kjo çështje nuk mori shumë kohë sepse u dakorduan, duke propozuar udhëheqje kolektive të delegacionit. Me propozimin e shumicës, ju la kryesisë treshe të Delegacionit të vendoste për kryesuesin. Dhe, ata vendosën që delegacionin e Kosovës për negociata në këtë Konferencë ta udhëhiqte z. Hashim Thaçi, Kryeshef i Drejtorisë Politike të Shtabit të Përgjithshëm të UÇK-së. Po ashtu, u bë përzgjedhja e njerëzve për grupet e punës, duke pasur parasysh afinitetet e secilit, për kryerje sa më të mirë të punës dhe detyrës së caktuar. Sektorët në të cilët u profilizua delegacioni ishin: Sektori Politik; Sektori për Mbrojtje e Siguri; Sektori për Ekonomi; Sektori për Hartimin e Platformës së për Përbashkët dhe Sektori për Informim.

Të gjitha këto grupe punuan me përkushtim më të lartë e më sipëror që kishte njohur e kaluara jonë në rrafshin e mendësisë politike e diplomatike shqiptare. Në vazhdimësinë e takimit konsolidues, u arrit edhe te pjesa paksa më e lehtë, ku do të duhej të zgjidhej dhe të kompletohej një komponentë që do të ishte shumë e rëndësishme për suksesin e Konferencës -komponenti profesionale.

Më 22 shkurt 1999 i ofrohet mundësia që pjesa e Delegacionit të UÇK-së, të ketë takim me **Komandantin e Forcave të NATO-s për Evropë**, Gjeneralin **Uelsi Klark**. Natyrisht që kjo ofertë pranohet me kënaqësi dhe shpresë për mundësinë e bërjes më shumë për ardhmërinë e UÇK-së dhe për Kosovën. Takimi nuk u zhvillua në hapësirat e **Kështjellës së Rambujesë** për shkak të pengesave që krijoi Qeveria Franceze për Gjeneralin Klark. Por, ai nuk hoqi dorë nga takimi, përkundrazi, ai organizoi një takim shumë të mirë e miqësor për Delegacionin e UÇK-së,



diku në një bazë ushtarake, jo larg Parisit. Ai në këtë takim do t'i drejtohet disa herë Delegacionit të UÇK – së me fjalët: „Nëse serbët nuk do ta nënshkruajnë Marrëveshjen unë do t'i godas forcat e Millosheviçit në Kosovë, për këtë të jeni të sigurt.“<sup>153</sup>

Në këtë takim nga Gjenerali Klark u tha se UÇK-ja duhet të dorëzojë armët e rënda, të mos duket në uniformë dhe të mos bëjë ushtrime klasike ushtarake. Me Gjeneralin Uesli Klark, Delegacioni ynë që takuar edhe në përfundim të vazhdimit të Konferencës së Rambujesë në Paris. Përpjekjet e Delegacionit tonë për çështjen e ardhmërisë së UÇK-së, nuk arritën të futen në Dokumentin e Marrëveshjes.

Pa ndonjë ngarkesë të veçantë, u përzgjedhën edhe grupet profesionale: kushtetues – juridik, judikaturë e administratë, mbrojtje e siguri, ekonomi e financa, duke u përcaktuar kështu edhe për ekspertët përkatës shqiptarë e ndërkombëtarë. Meqenëse numri i atyre që mund të hynin në Kështjellë ishte i përkufizuar, u vendos që aty të jenë vetëm ata që i duhen për çdo kohë Delegacionit.

Ekspertët ndërkombëtarë që ishin bërë nderë e delegacionit dhe i kishin shtuar peshën e seriozitetit në qasje dhe trajtim, ishin: Ambasadori **Moroton Abramowitz**; eksperti amerikan dhe për çështje ndërkombëtare **Mark Weller**.

Punën e delegacionit e ndihmuan me këshilla, sugjerime dhe preferenca shumë të dobishme, nga distanca, edhe shumë ekspertë të tjerë nga Kosova si: Akademik Esat Stavileci, Avokati Bajram Kelemdi, Prof Dr. Ejup Statovci, juristi Sokolo Dobruna, politikologu Mahmut Bakalli, si dhe Muhamet Mustafa, Skender Berisha, Blerim Reka, Ramadan Qehaja etj.. Nga Shqipëria, të gjitha institucionet shtetërore dhe shkencore, duke përfshirë edhe Akademinë e Shkencave, u vunë në shërbim të Konferencës, për suksesin e saj, në të mirë të Kosovës.

Në fund të këtij takimi, u nxorën edhe tri dokumente me rëndësi për punën e mëtutjeshme, ai mbi konkluzionet për parimet e punës së delegacionit dhe për parimin e konsensusit në marrjen e të gjitha vendimeve gjatë konferencës.

### ***Teksti i konkluzioneve - përmbajtja:***

Në Prishtinë e Tiranë në kuadër të grupeve të përcaktuara. Ekspertët shqiptarë që gjendeshin brenda Kështjellës, atëherë kur e kërkonte nevoja, ishin: Prof. Dr. Arsim Bajrami Delegacioni i Kosovës në Konferencën ndërkombëtare për Kosovën në Rambouillet, në

---

<sup>153</sup> Buja Ramë “vepër e cituar” faq 56

mbledhjen e vet të mbajtur më 7 shkurt 1999 vendosi:

**1 Kryesia e Delegacionit të Kosovës të përbëhet nga Hashim Thaçi, Dr. Ibrahim Rugova dhe Akademik Rexhep Qosja.**

**2 Anëtarët e Kryesisë së Delegacionit të vendosin vetë se kush do të jetë Kryesues i delegacionit.**

**3 Vendimet të merren me konsensus.**

**4 Formimin e Sekretarisë së Delegacionit.**

**5 Emërimin e ekspertëve shqiptarë.**

**6 Emërimin e ekspertëve ndërkombëtarë.**

Delegacioni u përcaktua me konsensus rreth synimeve strategjike të Kosovës në këtë Konferencë Ndërkombëtare.

**Synimet strategjike të Delegacionit:**

**1. Vendosja e Kosovës nën mbikëqyrjen e NATO-s;**

**2. Mbajtja Referendumit për Statusin final të Kosovës nën mbikëqyrjen ndërkombëtare në përfundim të fazës kalimtare.**

**3. Ruajtja e subjektivitetit të UÇK-së gjatë dhe pas periudhës kalimtare.**

**4. Ruajtja e integritetit territorial të Kosovës.**

**5. Statusi kalimtar në kuptimin e një vetadministrimi demokratik dhe të pavarur, i tillë që nuk e paragjykon statusin final të Kosovës.**

**6. Tërheqja e të gjitha forcave serbe nga Kosova...etj.<sup>154</sup>**

Delegacioni i Kosovës hartoi edhe platformën orientuese. Përmbajtja e saj ishte me sa vijon:

**1. Tërheqja nga Kosova e të gjitha forcave ushtarake, policore dhe paramilitare të Serbisë.**

**2. Mospranimi i integritetit territorial të „Republikës Federative të Jugosllavisë”.**

**3. Vendosja e trupave të NATO – s sipas modelit të mandatit të IFOR/SFOR gjatë kohëzgjatjes së marrëveshjes kalimtare.**

**4. Transformimi i UÇK – së në një force mbrojtëse me aftësi të kufizuara në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare.**

---

<sup>154</sup> Krasniqi Jakup “vepër e cituar” faq 113

5. *Miratimi i Kushtetutës kalimtare trevjeçare, e cila mundëson themelimin e një qeverie demokratike dhe të efektshme në Kosovë, të përkrahur nga mandati i popullit në zgjedhjet sa më të hershme.*

6. *Pas skadimit të Marrëveshjes Kalimtare (tri vjet nga data e nënshkrimit të saj), populli i Kosovës do të organizoj Referendum për të përcaktuar statusin përfundimtar të Kosovës, në bashkëpunim me Bashkësinë Ndërkombëtare.*

7. *Krijimi i kushteve të nevojshme për të promovuar zhvillimin ekonomik të Kosovës, duke përfshirë këtu Bankën Qendrore të Kosovës dhe kompetencat e institucioneve të Kosovës, për të rregulluar mekanizmat për çështjet ekonomike financiare.*

8. *Riafirmimi i paprekshmërisë së kufijve ekzistues të Kosovës.*

9. *Zgjidhja e vazhdueshme e konfliktit përmes mjeteve ndërkombëtare duke përfshirë mbikëqyrjen e zgjedhjeve nga OSBE – ja, dhe pranimin e Kosovës si entitet i definuar territorial, politik dhe juridik.*

10. *Një marrëveshje e të gjitha palëve për bashkëpunim të menjëhershëm dhe të plotë me Tribunal Ndërkombëtar për krime të luftës në ish- Jugosllavi.*

11. *Garantimi i Marrëveshjes nga ShBA – të, Unioni Evropian, NATO – ja, vendet anëtare të Grupi të Kontaktit dhe OSBE – ja. Identifikimi i Marrëveshjes si traktat ndërkombëtar dhe regjistrimi i saj në OKB.<sup>155</sup>*

12. *Këto dokumente qenë hartuar në rrethana të realitetit të krijuar në Rambuje, në raport me njohuritë poseduese të Delegacionit, nga i tërë materiali që tanimë posedonte Delegacioni.<sup>156</sup>*

#### **Pozicionet e delegacionit të Kosovës ndaj projekt marrëveshjes – nënshkrimi në Paris**

Marrëveshje e ndërmjetme (përkohshme, kalimtare) për paqen dhe vetëqeverisjen në Kosovë (*Interim Agreement of Peace and self-Government in Kosovo*) ishte dokumenti më i rëndësishëm që u prezantua dhe u diskutua në Rambuje, dhe ishte marrëveshja që do të nënshkruhej nga palët pjesëmarrëse. Kjo projekt marrëveshje përbëhej nga dy pjesë:

1. *Pjesa Politike dhe*

2. *Pjesën e sigurisë ose instrumentet e detyrimit.*

Grupi i Kontaktit kishte vendosur që faza e parë e bisedimeve të kushtohej vetëm pjesës

<sup>155</sup> Ramë Buja, *vepër e cituar* faq 56.

<sup>156</sup> Krasniqi Jakup “vepër e cituar” faq 97

politike të marrëveshjes. Vetëm pas arritjes së marrëveshjes për këtë pjesë, do të diskutohej për zbatimin dhe për çështjet e sigurisë.<sup>157</sup>

**Pjesa politike e kësaj marrëveshje ishte përbërë nga 8 kapituj:**

- a. Kushtetuta e Përkohshme e Kosovës.**
- b. Sigurimi Politik dhe Civil.**
- c. Zhvillimi dhe Mbikëqyrja e zgjedhjeve.**
- d. Çështjet ekonomike-ndihma humanitare/rekonstruktimi dhe zhvillimi ekonomik.**
- e. Implementimi 1 - Ombduspersoni.**
- f. Implementimi 2 – Dispozitat përfundimtare.**

Vërejtje kryesore për të cilën u shpenzua më së shumti, ishte ajo rreth referendumit, pas kalimit të afatit trevjeçar. Delegacioni nga Kosova insistonte në futjen e këtij teksti. „*Tri vjet pas nënshkrimit të marrëveshjes, populli i Kosovës, në bashkëpunim me bashkësinë ndërkombëtare, përmes referendumit do të përcaktojë statusin final të Kosovës*“.<sup>158</sup> Delegacioni me ngulm kërkonte heqjen e formulimit të tekstit ekzistues, në të cilën shkruhej: „*Pas tri vjetësh do të bëhet një rishqyrtim gjithëpërfshirës i Marrëveshjes nën patronatin ndërkombëtar me qëllim të përmirësimit të zbatimit të saj dhe me qëllim të marrjes së vendimeve për zbatimin e propozimeve të cilësdo qoftë palë për hapat e mëtejme*“.<sup>159</sup> (neni III, pika 3 e Kornizës së Marrëveshjes).

Negociatat kanë qenë shumë të gjata, të lodhshme dhe shumë insistuese për këtë çështje nga ana e Delegacionit të Kosovës, për të ardhur tek përmbajtja përfundimtare, që nuk ishte tërësisht në favorin e shqiptarëve, e që kishte këtë përmbajtje: „*Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj marrëveshje, do të mbahet një takim ndërkombëtar, për të përcaktuar mekanizimin për zgjidhjen përfundimtare për Kosovën të bazuar në vullnetin e popullit, në opinionet e autoriteteve relevante, të përpjekjeve të çdonjërës palë, të cilat kanë të bëjnë me implementimin e kësaj marrëveshje dhe të aktit final të Helsinkit, si dhe të bëjë një vlerësim përmbajtjesor të Marrëveshjes, dhe të shqyrtojë propozimet nga çdonjëra palë rreth masave plotësuese*“.<sup>160</sup>

<sup>157</sup> Wolfgang Petrich, „Procesi i Rambouillet“ (Fejton në Koha Ditore, 4-17 mars 2002)

<sup>158</sup> Krasniqi Jakup “vepër e cituar” faq 169

<sup>159</sup> Po aty faq 174

<sup>160</sup> Krasniqi Jakup “vepër e cituar” faq.169

Ky formulim, jo vetëm që nuk kënaqi kërkesat e Delegacionit, por e shqetësoi atë gjer në mospranim, edhe pse interpretimet e ekspertëve shqiptarë dhe ndërkombëtarë flisnin për atë se ky formulim nënkupton njohjen indirekte të së drejtës për vetëvendosje të popullit të Kosovës. Kjo pakënaqësi e Delegacionit të Kosovës dhe reagimet e tij, bënë që zonja Ollbrajt, në kundërshtim me parimet e përcaktuara të Grupit të Kontaktit, duke hasur edhe në reagimet e tyre, ta shkruante dhe ta nënshkruante një letër shtesë, ku do të shprehej mbështetja e saj dhe ajo amerikane për referendumin, në fund të periudhës trevjeçare.

### **Vërejtjet rreth draft-marrëveshjes**

#### ***- Kushtetuta e Kosovës***

Drafti i Kushtetutës (Constitution) kalimtare të Kosovës që renditej si Aneksi i Parë i Marrëveshjes, përmbante në vete tërë strukturën organizative „shtetërore“, të të tri sfoneve; *atij legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor*, që në parim ishte i pranueshëm nga Delegacioni i Kosovës.

Kosova me këtë Kushtetutë bëhej me Parlament, President, Qeveri dhe Sistem Gjyqësor të të gjitha niveleve, si dhe me Gjykatë Kushtetuese. Këtu përcaktohej se kush ishte kompetent për ruajtjen e integritetit territorial të Kosovës, e kjo çështje u lihej autoriteteve të Kosovës. Fakt i rëndësishëm i kësaj kushtetute ishte edhe çështja se pushteti buronte nga Marrëveshja, e jo nga dikush tjetër, siç pretendohesh nga pala serbe. Integriteti i RFJ-së këtu garantohej vetëm për periudhën kalimtare.

Vërejtjet dhe ndryshimet që u kërkuan të bëheshin nga pala shqiptare, konsistonin në atë që, të eliminoheshin të gjitha lidhjet e Kosovës me Serbinë, të forcohej pushteti autentik i Kosovës dhe të zvogëloheshin maksimalisht kompetencat e „RFJ-së“.

#### ***- Policia dhe sigurimi publik***

Ky aneks që dhënë për t`u parë nga Delegacioni i Kosovës (jo për t`u analizuar dhe shqyrtuar e për t`iu bërë vërejtje, sepse ishte i panegociushëm) fare në fund të konferencës. Megjithatë, negociatorët shqiptar u morën seriozisht me të dhe bënë vërejtje serioze.

Aneksi, për Kosovën parashihte formimin e një force policore prej 3000 (tremijë) policësh, që do të kenë mundësi të ruajnë rendin dhe qetësinë publike, në një vend të sapodalë nga lufta.

Çështje për të cilën nuk u pajtua Delegacioni ynë negociatorë ishte çështje e numrit të policëve që do të angazhoheshin në këtë formacion, duke argumentuar fuqishëm nevojën e shtimit të kësaj force në 6000 (gjashtëmijë), për t`iu para afruar përmbushjes së nevojave të

kohës.

Kjo forcë policore ishte menduar dhe precizuar në tekst, se do të duhej të jetë e organizuar vetëm në nivel lokal, pa pasur një qendër udhëheqëse në nivel të Kosovës. Edhe për këtë negociatorët tanë shprehën kundërshtitë dhe bënë propozimin, që kjo polici të ketë edhe nivelin qendror të organizmit. Në të kundërtën ajo do të jetë një mekanizëm i shkapërderdhur, i parespektueshëm dhe si i tillë i pasuksesshëm.

Çështje tjera për të cilat u bënë vërejtje ishin edhe çështja e afatit të tërheqjes së policisë pushtuese serbe, që ishte paraparë të zgjaste një vit.

Megjithëkëtë angazhim serioz të Delegacionit rreth kësaj çështje, asnjëra nga këto vërejtje nuk u morr parasysh për t'u futur në Marrëveshjen e Përkohshme për paqe e vetëqeverisje në Kosovë.

#### ***- Vërejtjet në anekset për zgjedhjet, dhe OmbduspersonI***

Vërejtjet që u bënë në këto ankese nuk qenë të shumta.

U intervenua kryesisht në përplotësim sqarues, siç është rasti me paragrafin 1 të nenit III, ku i shtohet tekstit ekzistues edhe kjo pjesë: „Regjistri i votuesve do të përfshijë edhe ata të cilët kanë të drejtë për votim, por që janë zhvendosur brenda përbrenda Kosovës ose jashtë saj si rezultat i represionit ose konfliktit“.

#### ***- Vërejtjet të aneksit për çështje ekonomike***

Rëndësia e definimit të këtyre çështjeve ekonomike, për Kosovën ishte shumë e madhe. Kosova e rrënuar dhe dërrmuar ekonomikisht, nga regjimi pushtues serb. Përkundër rëndësisë së madhe që kishte ky aneks për ardhmërinë e Kosovës, grupi i ekspertëve hartues të këtij aneksi nga Grupi i Kontaktit dhe Konferencës Ndërkombëtare për Kosovën në Rambuje, e kishte bërë atë me fare pak kujdes, duke mos i trajtuar e elaborua as gjërat më të rëndësishme të kësaj lëmie.

I tërë aneksi përmbante vetën 2 nene dhe një faqe e gjysmë tekst. Grupit të punës për çështje ekonomike nga negociatorët tanë i duhej të bënte një punë të madhe, të shpejtë dhe të lodhshme. Grupi i punës, duke u mbështetur në nevojat dhe domosdoshmëritë që do të kishte Kosova në fazën e tranzicionit, rihartoi një aneks të ri sqarues, me të gjitha të dhënat, detyrimet, përgjegjësitë, obligimet, nevojat, mundësitë dhe përkufizimet.

Ky material i rishikuar përmbante dymbëdhjetë nene, por pothuaj asnjë nga vërejtjet e bëra dhe sugjerimet e adresuara, nuk u futën në tekstin përfundimtar të Marrëveshjes.

### - *Vërejtje të veçanta*

Këto vërejtje iu imponuan negociatorëve kosovar, si plotësim i vërejtjeve që tanimë ishin bërë për shkak se pala serbe, për herë të parë, më 16 shkurt 1999, dorëzoi deklaratën e parë të shkruar me vërejtjet e bëra në tre kapitujt e parë të Projektmarrëveshjes. Dhe, atë, duke hedhur poshtë disa pjesë esenciale të marrëveshjes, duke bërë edhe formulime krejt të reja. Kështu, termi administrativ „Kosovë“ ishte zëvendësuar me emrin e vjetër „Kosmet“ – shkurtim për Kosovë e Metohi. Një shkelje e qartë e elementeve bazë (Basic Elements) të pranuar paraprakisht, ishte zëvendësimi i termit „Kushtetutë“ me „Statut“. Më tej, emërtimi „konflikti i Kosovës“ ishte zëvendësuar me „Çështja e Kosmetit“.<sup>161</sup>

Reagimi i palës sonë u bë me 17 shkurtë 1999, duke mos e fshehur ndjenjën e pakënaqësisë në raport me ndërmjetësit ndërkombëtarë, për raportet me delegacionin serb, dhe privilegjet e përkëdhelinë që i bëheshin këtij delegacioni, duke i thyer edhe rregullat e parimit bazë të Konferencës, duke e bartur një pjesë të negociatave nga Kështjella në Beograd. Për shkak të mungesës së njerëzve me kompetencë për të vendosur për çështjet kapitale, në delegacionin përfaqësues serb.

Këtu është fjala për udhëtimin e **K. Hill** në Beograd i cili, siç u mor vesh, ishte vendosur nga Franca dhe Anglia pa e konsultuar fare pjesën tjetër të **Grupit të Kontaktit**. Mbase, për t'u sfiduar pala serbe dhe organizatorët e udhëtimit të z. K. Hill në Beograd, me vendim të përfaqësisë sonë, udhëtoi për në Lubjanë edhe Kryesuesi i Delegacionit të Kosovës z. Hashim Thaçi, për një konsultë...!

Nuk kishte dyshim se për këtë rrjedhë, Delegacioni ynë ndjehej i fyer dhe i papërfillur, në proporcion me angazhimin për t'i dhënë rrugë zgjidhje politike problemit të Kosovës. Dhe e konsideronte të pafrytshëm bashkëpunimin shumë konstruktiv me ndërmjetësit ndërkombëtarë, përderisa një shkresë e palës serbe që tejkalonte edhe kornizat e marrëveshjes së para ardhjes në Rambuje, rrëronte tërë punën e bërë të delegacionit shqiptar. Vërejtjet e 17 shkurtit 1999 konsistonin në këto çështje: në atë të bashkësive nacionale, në regjimin juridik të aplikueshëm në Kosovë, në pjesëmarrjen a mospjesëmarrjen e Kosovës në institucionet e RFJ-së, dhe në atë të pronës publike.

---

<sup>161</sup> Wolfgang Petrich, „Procesi i Rambouillet“, *Koha Ditore* (4 – 17 mars 2002), vazhdimi

### *Vërejtjet në aneksin ushtarak*

Vendimi i **Grupit të Kontaktit** ishte panegociushmëria e këtij aneksi. Përfaqësuesit shqiptarë në Konferencë, të vetëdijshme për këtë, megjithatë insistuan fuqishëm në ushtrimin e ndikimit për të bërë ndryshime edhe në këtë aneks shumë të rëndësishëm të Marrëveshjes.

Ky aneks, parashihte largimin e forcave policore e ushtarake serbe nga Kosova, por, jo plotësisht. Sipas këtij aneksi, në Kosovë do të mbeteshin jo pak forca, 2500 (dy mijë e pesëqind), në kufirin me Shqipërinë 1500 (njëmijë e pesëqind) dhe 1000(njëmijë) të tjera, për ruajtjen e monumenteve të trashëgimisë serbe – siç thuhej aty. Në Kosovë do të vendosej një forcë ushtarake e **Aleancës Veri-atlantike** me 28.000 (njëzetetetëmijë) trupa, që do të identifikoheshin me shkurtesën KFOR.

Pala shqiptare ishte e kënaqur me pjesën e këtij Aneksi ku parashihej vendosja e forcave të **NATO-s (KFOR-it)** në Kosovë. Pakënaqësia në këtë shprehej vetëm tek përqindja amerikane në forcat e KFOR – it. Sipas deklarimeve të presidentit amerikan **Klinton**, kjo forcë do të përbënte 15% të të gjitha forcave. Delegacioni ynë kërkonte pjesëmarrje në përqindje më të madhe të forcave amerikane. Nisur nga qëndrimi refuzues e mohues i palës serbe për këtë aneks, panegociushmëria e tij na del si një qëndrim i peshuar mirë nga Bashkësia Ndërkombëtare. Por, shqetësimi për palën kosovare qëndronte tek e ardhmja e UÇK-së dhe mbetjes së 2500 ushtarëve dhe policëve serbë në kufij e brenda Kosovës. Kjo mbetje e këtyre forcave serbe në Kosovë, shkaktonte shqetësim të madh në radhët e Delegacionit të Kosovës. Edhe pse dihej për panegociushmërinë e këtyre çështjeve, Delegacioni i Kosovës ishte shumë insistues për ta bindur **Bashkësinë Ndërkombëtare** për tërheqjen e plotë të forcave serbe nga Kosova. Megjithatë, qëndrimet e ndërkombëtarëve në këtë rrafsh mbetën të pandryshueshme.

Njëra nga çështjet mbi të cilat nuk mund të kapërcente Delegacioni i Kosovës dhe assesi nuk mund të pranonte atë që ishte përvijuar në tekstin e Marrëveshjes, qoftë edhe në pjesën e panegociushme, siç ishte rasti me aneksin ushtarak, ishte fati i së ardhmes së UÇK-së, dhe çmilitarizimi i saj. Dhe kjo do të duhej të ndodhte katër muaj pas hyrjes në fuqi të Marrëveshjes së Rambujesë (Neni I, paragrafi 1 dhe Neni V).

Përfaqësuesit e UÇK-së, në Delegacionin Shqiptarë, ishin të brengosur në veçanti për këtë çështje, dhe për këtë edhe zhvilluan takime e bisedime të shumta, jo vetëm me personalitetet e Konferencës, por edhe me ata të **SHBA-ve** dhe të **NATO-s**. Insistimi i Delegacionit ishte në ruajtjen e subjektivitetit dhe të vazhdimësisë së UÇK-së, duke kaluar nëpër një proces të



domosdoshëm transformimi, në përputhje me parime të pranueshme dhe konform nevojave të kohës. Insistimi ishte që UÇK-ja të pranohej si forcë e përhershme e armatosur, qoftë edhe duke reduktuar dhe vënë nën kontroll dhe trajnim të përhershëm të **NATO-s**.<sup>162</sup>

Kemi shkruar edhe njëherë më lartë dhe më duhet ta përsëris takimin që u mbajt më 22 shkurt 1999, që pjesa e Delegacionit të UÇK – së, kishte me Komandantin e forcave të **NATO –s** për Evropë, gjeneralin **Uelsi Klark**. Takimi për arsye të njohura më lartë nuk u mbajt në Kështjellë. Por në një bazë ushtarake të **NATO-s**, afër Parisit. Përpjekjet e Delegacionit shqiptarë për çështjen e ardhmërisë së UÇK-së, nuk arritën të futën në **Dokumentin e Marrëveshjes**.

Të dy delegacioneve, më 18 shkurt 1999, iu paraqit versioni i projektit përfundimtar të Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë. Ishte ky një version skandaloz, që dallonte nga draftet tjera dhe që shkaktoi shqetësim të madh në radhët e Delegacionit të Kosovës.

Baza mbi të cilën mbështetej ky version ishte presioni që bënte delegacioni serb dhe drejtpërdrejt Beogradi mbi organizatorët e Konferencës. Në përgjithësi synohej një variant zgjidhjeje që i shkonte për shtati palës serbo – jugosllave në disa pika dhe kërkonte lëshime të mëtejshme nga shqiptarët e Kosovës. edhe pse i hartuar në bazë të atyre pohimeve të lartpërmendura, ky projekt nuk qe i pranueshëm për të dyja palët. Delegacioni serb, po atë mbrëmje paraqiti qëndrimin e tij në lidhje me pjesën politike të projektit, ndërsa për pjesën ushtarake të tij, ata që kishin pranuar të bisedonin ndonjë herë, sepse e kishin hedhur si të papranueshëm apriori. Ndërsa shqiptarët, të indinjuar thellë për këtë mungesë respekti për angazhimin tepër konstruktiv të tyre, e bënë të njohur qëndrimin e tyre në mbrëmjen e kësaj dite, duke u ankuar me të drejtë se bashkëpunimi i tyre ishte i keqpërdorur, duke u shpërblyer pala serbe. Dy ditë para mbylljes së Konferencës, ishte e qartë se bisedimet gjendeshin në një rrugë qorre. Ende nuk ishte arritur asnjë marrëveshje për pikat qendrore dhe as që bëhej fjalë për një zgjidhje të përgjithshme.

Për shqiptarët e Kosovës, Referendumi për Pavarësi dhe çmilitarizimi i UÇK-së ishin dy çështje që nuk viheshin në diskutim. Për Republikën Federative të Jugosllavisë/Serbinë, një forcë ushtarake nën drejtim të **NATO-s**, nuk mund të pranohej në asnjë rrethanë në territorin e saj. Për t'i dalë përpara dështimit të Konferencës duhej gjetur sa më shpejt një rrugëdalje. Kjo mund të

---

<sup>162</sup>. *Ramë Buja, vepër e cituar faq.*

arrihej vetëm duke e shtuar tryshinë mbi të dyja delegacionet dhe duke intensifikuar bisedimet.<sup>163</sup>

Pala shqiptare edhe më 19 shkurt 1999, falë insistimit këmbëngulës të njërit nga tre ndërmjetësit ndërkombëtarë, **z. Petrich**, dorëzoi edhe njëherë propozimet e saj të ripunuara. Delegacioni i Kosovës për të qenë deri në fund sqarues, bëri edhe një Deklaratë për Kryesuesit e Konferencës dhe ata të **Grupit të Kontaktit**, lidhur me propozimin e ri të 18 shkurtit 1999. Për të intensifikuar këto bisedime dhe për ta shtuar tryshinë mbi delegacionet negociatore, në **Kështjellën e Rambujesë** arriti edhe Sekretarja e atëhershme e shtetit të SHBA-ve, **z. Madeleine Albright**. Sekretarja e Shtetit nuk e fshehu aspak se si duhej të arrihej zgjidhja. Ajo rriti tryshinë mbi palën shqiptare të Kosovës për të marrë të paktën miratimin e saj. Albright ua përplasi troç në tryezë formulën e zgjidhjes Delegacionit nga Kosova: „ose nënshkruani tani, dhe atëherë Jugosllavia do të bombardohet, ose nuk pranoni, dhe askush nuk do t`ju ndihmojë!“<sup>164</sup>

I tërë ky presion, që herë herë ishte edhe shantazh, bëhej kryesisht mbi kryesuesin e Delegacionit të Kosovës z. Hashim Thaçi, dhe mbi anëtarë të tjerë të Delegacionit. Më 20 shkurt 1999, u vendos që përfundimi i Konferencës të shtyhet gjer më 23 shkurt, ora 13:00. Kjo shtyrje në kohë ishte përpjekja e fundit për të gjetur rrugëzgjidhje për përmbyllje të suksesshme të Konferencës. Dështimi ishte i papranueshëm edhe për palën ndërkombëtare, sepse në vazhdimësi ishin paraplanifikuar veprime të tjera në raport me Kosovën.

Tryshia u drejtua thujse tërësisht ndaj palës shqiptare të Kosovës: Gjatë natës së 21-22 shkurtit ndërmjetësuesit e **BE-së** dhe **SHBA-ve** dhe grupet e tyre me bisedime të njëpasnjëshme u përpoqën të arrinin miratimin e të dyja palëve për tekstin e marrëveshjes politike. Në orën 05.30 ndërmjetësit ia paraqitën palës shqiptare, delegacionit të Kosovës, një variant i cili përmbante propozimet e tyre të fundit, me përjashtim të fjalës „Referendum“. Në mëngjesin e 23 shkurtit, diku rreth orës 09:30, delegacioneve të lodhura gjer në rraskapitje iu dorëzua versioni i fundit i Marrëveshjes së Përkohshme për Paqe dhe Vetëqeverisje në Kosovë. Së bashku me këtë tekst të Marrëveshjes ishte edhe një shkresë shoqëruese, në të cilën kërkohet nga delegacionet që të bënin të ditur qëndrimin e tyre, më së largu gjer në orën 13.00, kohë kjo në të cilën ishte paraparë që të përfundonte kjo Konferencë.

Delegacioni edhe pse në fillim kishte divergjencë rreth asaj se a duhet të nënshkruhej marrëveshja menjëherë, apo duhej mbështetur ideja e përfaqësuesve të UÇK-së për një shtyrje

<sup>163</sup> Wolfgang Petrich, „Procesi i Ramboillet“, *Koha Ditore* (4 – 17 mars 2002), vazhdimi 4

<sup>164</sup> Ramë Buja, „vepër e cituar“ faq.19

dyjavore të nënshkrimit (derisa të konsultohet populli), në fund arriti konsensus dhe me anë të dy shkresave njoftoi Kryeorganizatorët dhe **zj. Medline Albright**. Këto dy shkresa, në esencë, përmbanin atë se: delegacioni i Kosovës në parim pranon Marrëveshjen, që nënshkrimi të bëhet pas dy javësh, mirëpritje të garancioneve amerikane për UÇK-në dhe garancione për Referendumin. **Konferenca e Rambujesë**, përmbylli punimet saktësisht në orën 16.34 minuta, për t'i vazhduar ato pas dy javësh në Paris.

Shtyrja dyjavore e vënies së nënshkrimit në Marrëveshjen e Përkohshme për Paqe dhe Vetëvendosje në Kosovë, ishte kohë e të ndodhurave të mëdha dhe tragjike për Kosovën, por, njëkohësisht ishte edhe kohë për të cilën edhe është përfol shumë. Kjo shtyrje ishte bërë me arsye shumë të qëndrueshme dhe të argumentuara se për këtë Marrëveshje (që shumëçka linte në mjegull) do të duhej konsultuar populli i Kosovës, subjektet politike dhe ushtarake të saj, që të vihej firma me një ndjenjë më të lehtë përgjegjësie nga Delegacioni i Kosovës.

Shtyrja dyjavore, ishte veprimi më racional që mund të bëhet për të shpëtuar dështimin e pa-alternativë të **Konferencës së Rambujesë**. Për në Paris, nga Kosova, Delegacioni i Kosovës, u nis pas dy jave, në pasditen e 13 marsit 1999, nga aeroporti i Prishtinës. Dallimi tani ishte se, së bashku me Delegacionin (i cili ishte rritur shumë numerikisht, e nuk dihej me leje të kujt dhe përse) udhëtonte edhe Kryesuesi i Delegacionit të Kosovës, z. Hashim Thaçi. Vazhdimi i **Konferencës së Rambujesë** nuk zgjati shumë: nga 14 gjer më 19 mars 1999. Marrëveshja u nënshkrua nga pala shqiptare dhe ajo ndërkombëtare në ditën e 18 marsit 1999. Pala serbe/jugosllave i mbeti besnike obstruksionit, mospërfilljes dhe mosbashkëpunimit me ndërkombëtarët, në veçanti me SHBA-të, dhe nuk e nënshkruajti marrëveshjen, duke marrë mbi supe të gjitha pasojat e mundshme që do të prodhonte ky veprim aspak i mençur politik e dështak në rrafshin diplomatik.

Delegacioni i Kosovës nuk pati më mundësi garantimi e sigurimi për të udhëtuar për në Kosovë, përmes Aeroportit të Prishtinës, sepse, tanimë kishte filluar tërheqja nga Kosova e të gjitha Misioneve Ndërkombëtare, dhe jo vetëm nga Kosovë, por tërhiqeshin edhe shumë përfaqësi diplomatike të shteteve të ndryshme edhe nga kryeqyteti i Serbisë – Beogradi. Sinjale këto të paralajmërimit të fillimit të një faze të re vepruese për zgjidhjen e problemit Kosovë.

Mosnënshtrimi i të gjitha palëve negociatore, pjesëmarrëse në Konferencën e Rambujesë, rezultoi me dështimin e saj. Tani vinte në shprehje dhe në radhë opsioni i fundit, i pa-alternativë, i përdorimit të forcës kundër forcës. Përpjekjet e fundit për ta bindur kreun e së keqes,

Milloshëviqin, për të bërë kthesë në mendësinë e tij gjenocidale dhe për t'i thënë po Marrëveshjes, u bënë përmes **Riçard Holbrukut**, i cili do të kthehej me duar bosh, dhe me bindjen se nuk ka rrugë tjetër përveç intervenimit me forcë. Aksionet goditëse mbi forcat serbe filluan më 24 mars 1999, për të vazhduar gjer në kapitullim të këtyre forcave më 9 qershor 1999, në ditën e nënshkrimit të **Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës**.

Kishte brenda përfaqësisë shqiptare në Rambuje edhe një marrëveshje të brendshme që obligonte për një përgjigje plus. Ishte çështja e bërjes së një Qeverie të Përbashkët, për të cilën ishin dakord të gjithë që këtë qeveri ta kryesonte UÇK-ja. Dhe, për këtë, Shtabi i Përgjithshëm, edhe pse në mungesë të Krye-shefit të Drejtorisë Politike, z. Hashim Thaçi që gjendej me detyrë, në mbledhjen e mbajtur më 26 shkurt 1999, dy ditë pas kthimit nga Rambuje, vendosi që për mandatar të Qeverisë së Marrëveshjes të caktojë z. Hashim Thaçi. Por, kjo qeveri, nuk u konsolidua ashtu siç ishte paraparë. Dominon bindja e arsyeshme se po të ishte konsoliduar mirëfilli kjo Qeveri e Përkohshme, nga të gjitha subjektet e marrëveshjes së nënshkruar në **Kështjellën e Rambujesë**, pozita e Kosovës pas luftës dhe në vazhdimësi, do të kishte qenë shumë më e favorshme në të gjitha sfondet, qoftë në atë zhvillimor, politik, të sigurisë dhe të perspektivës.

Rambuje nuk solli një marrëveshje, por ajo solli intervenimin e **NATO-s** në Kosovë, dhe jo vetëm kaq. **Dokumenti i Rambujesë** mbetet një Dokument i rëndësishëm për Kosovën, dhe për politikën ndërkombëtare në raport me Kosovën.

Kjo Konferencë dhe marrëveshja e saj, edhe pse dështake, dhe si e tillë ajo përkundrazi pati mundësi të ndikojë seriozisht, duke i shtyrë diplomatët dhe hartuesit e dokumenteve të ndryshme ndërkombëtare, pasuese të saj, të reflektojnë me rezonin që karakterizonte këtë Marrëveshje të porealizuar duke i dhënë asaj përmasat, karakterin dhe rëndësinë, që në fakt nuk e kishte. Refleksione të tilla sollën **Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së**, me të cilën administrohet Kosova e pasluftës, e vënë nën mbikëqyrje a kujdestari ndërkombëtare. Edhe pse në esencë dallojnë për nga lloji i aktit ndërkombëtar (**Dokumenti i Rambujesë dhe Rezoluta 1244**), shumë zgjidhje i kanë të njëjta ose thënë më drejtë, rezoluta 1244 e nxjerrë nga Këshilli i Sigurimit është sanksionuar në shumë nene sipas **Marrëveshjes së Rambujesë**.

Rezoluta 1244, pothuajse shumë gjëra esenciale që përmbante Dokumenti i Rambujesë i ka në vete, apo shumë zgjidhje të situatave siç parashihen në Marrëveshjen e Rambujesë. Një dallim me rëndësi ekziston te Rezoluta nga Dokumenti i Rambujesë, afatizimi i periudhës kalimtare,

edhe pse ka edhe shumë dallime tjera.

Edhe marrëveshja e Kumanovës, edhe pse drejtpërsëdrejti nuk i referohet Marrëveshjes së Rambujesë, ka shumë zgjidhje të njëjta me atë që kishte Dokumenti i Rambujesë, si: numri i forcave serbe që do të qëndronin në Kosovë, tërheqja e tyre, zonat e KFOR-it, etj. Edhe marrëveshja për demilitarizimin e UÇK-së, edhe pse më e avancuar për ruajtjen e strukturës së UÇK – së, ishte brenda zotimeve të Dokumentit të Rambujesë dhe Rezolutës 1244.

Në Kosovë në vitin 2002, u nxor akti më i lartë juridiko – politik, në një fazë të pafavorshme, kur Kosova ende nuk kishte organet e veta të mirëfillta, legislative, ekzekutive e gjyqësore. Për ironi, edhe pse me të gjitha rrjedhat zhvillimore të ngjarjeve, ishte tejkualuar Rambujeja, Kosovës nuk i lejohet që dokumentin bazë ta quajë Kushtetutë, së paku si në Rambuje por, Kornizë Kushtetuese. Duke i kornizuar vërtet shumë mundësi veprimi të organeve legjitime shtetërore që lindën më vonë. Ky dokument, po ashtu si edhe ai i Rambujesë kanë ngjashmëri dhe zgjidhje të njëjta, që nga emërtimi i institucioneve, me të vetmin dallim se ndërkombëtarët rezervonin më shumë të drejta se në Rambuje, dhe se me këtë Dokument nuk parashiheshin të drejtat për RFJ-në.

Pothuajse nuk ka dokumente me rëndësi në Kosovë që nuk është në përputhje me këtë Marrëveshje, dhe kjo flet më së miri për Reflektimet e Rambujesë.

### **4.3. Ndërhyrja e NATO-s në Kosovë**

Gjatë bisedimeve dhe kryesisht pas dështimit të përpjekjeve diplomatike, kritika ndaj bashkësis ndërkombëtre u shtua dukshëm. Ndërhyrja e bashkësis ndërkombëtare u bë në atë çast kur konflikti ndodhej tashmë në një gjendje shkallzimi të rrezikshëm. Shkallzimi i dhunës duhej ndaluar sa më parë që të ishte e mundur.

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Kofi Anan më 22 dhe 23 mars 1999 kërkoi që forcat e armatosura jugosllave të ndërprisnin menjëher ofenzivën e tyre në Kosovë. Po më 23 mars, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-së, Javier Solana i dërgoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të OKS-së me anë të së cilës e njoftonte atë për një varg incidentësh të cilat shprehnin një përkeqesim dramatik të veprimeve ushtarake të RFJ-së pas largimit të Misionit Verifikues të OSBE-së në Kosovë. Gjithashtu Sekretari i Përgjithshëm i NATO-së tërhiqte

vëmendjen për katastrofën humanitare e cila si pasojë e përdorimit të tepruar të forcës nga RFJ-ja, ishte në zhvillim e sipër<sup>165</sup>.

Misionet e huaja nga të vendosura në Kosovë, filluan ta lëshojnë Kosovën dhe të largohen me shpejtësinë në drejtim të Shkupit. Pas dështimit të Konferencës në Rambuje filluan pregaditjet intensive të NATO-së për fillimin e aksioneve ushtarake kundër Serbisë të planit të përgaditur më herët dhe të aprovuar nga NATO-ja<sup>166</sup>.

Më 24 mars 1999 pasi nuk kishte mbetur asnjë alternative tjetër për të detyruar Millosheviçin të ndërpriste brutalitetin dhe represionin kundër popullsisë civile që e vazhdonte me shkatrrime të mëdha të çdo gjëje shqiptare nga një vitë, forcat ajrore të NATO-së rrethë orës 18: 15 filluan sulmet kundër Jugosllavisë me objektiva mbrojtjen ajrore, radarët, qendrat ushtarake të komandimit, aeroportet ushtarake. Sekretari i Përgjithshëm i NATO-së Javier Solana të mërkurën në mbrëmje deklaroi: “ Unë u informova nga SACEUR( komandant supreme për Evropën), gjenerali Klark së në këtë moment filluan operacionet ajrore të NATO-së kundër objektivave në RFJ”. Përgjegjësia për goditjen ajrore i takon presidentit Millosheviç i cili ka refuzuar të ndërpresë veprimet e dhunëshme në Kosovë dhe nuk ka pranuar të bisedojë me vullnet të mirë. Veprimet tona drejtohen kundër politikës shtypëse të udhëheqjes jugosllave<sup>167</sup>.

Me rastin e fillimit të sulmit, Presidenti amerikan Bill Clinton në një fjalim drejtuar popullit amerikan argumentoi shkaqet e ndërhyrjes së NATO-së:” Arsyet që ne sulmuam Serbinë janë: humanitare, të perspektivës dhe strategjike<sup>168</sup>”. Gjithashtu presidenti amerikan potencoi se Millosheviçi zgjodhi agresionin në vend të paqes dhe sulmi u ndërmorr pas përpjekjeve të shumta dhe të përsëritura për të gjetur zgjidhjen paqësore për Kosovën. Kryeministri i Britanisë së Madhe, Toni Bleir bëri të njohur po atë mbrëmje kombit të tij se pasi Millosheviçi nuk pranoi të ndalë dhunën e tmerrshme e të pranonte përpjekjet e komunitetit ndërkombëtar për zgjidhjen paqësore të përkohshme të çështjes së Kosovës bota e qytetruar nuk mund të lejojë akte të tilla dhune dhe agresioni në zemër të Evropë<sup>169</sup>. Disa herë Bashkësia Evropiane i ka premtuar Beogradit kthimin në organizatat ndërkombëtare dhe heqjen e sanksioneve nëse arrihet një marrveshje paqësore përgjigja e Beogradit ishte mosrespektim i marrveshjeve dhe grumbullimi i gjithnjë e më i madh i trupave në Kosovë.

---

<sup>165</sup> Shala Xhavit, *Ballkani Gjeopolitika dhe Siguria*, f, 260.

<sup>166</sup> Bajrami Arsim, *E drejta e Kosovës në tranzicion ( E drejta Kushtetuese II)*, f, 90.

<sup>167</sup> Tepshi Qazim, *Kosova dhe diplomacia imponuese*, f, 170.

<sup>168</sup> Shyqyri Hysi, *Historia e trojeve dhe e diaspores shqiptare*, f, 168.

<sup>169</sup> Tepshi Qazim, *veper e cituar*, f, 171.

Presidenti i Rusisë, Boris Jelcin i konsideroi sulemt e NATO-së një gabim tragjik pak minuta para sulmit presidenti Klinton e kishte informuar dhe i kishte kërkuar të mos dëmtohen marrëdhëniet mes dy vendeve, Rusia kërkoi një mbledhje urgjente të Këshillit të Sigurimit dhe tërhoqi ambasadorin e saj nga NATO. Kryeministri i Shqipëris Pandeli Majko duke iu drejtuar kombit shqiptar theksoi se “ Ne do të ofrojmë të gjitha lehtësit që ky operacion të zhvillohet në përputhje me planet e Aleancës për të goditur arsenalin ushtarak serb dhe ne bashkë me aleatët tanë strategjik jemi gati për të paguar këtë çmim e për të përballuar çdo aventur që mund të ndërrmarrë Beogradi kundër sovranitetit të Republikës së Shqipëris. Kryetarët e shteteve e qeverive të Bashkimit Evropian të mbledhur në Berlin në deklaratën e tyre të përbashkët theksuan gadishmërin dhe përgjegjësinë për zhvillimin paqësor të kontinentit se flisnin me një zë për misionin e vështir në Kosovë, se i jepnin mbështetje të plotë NATO-së për të kryer sulmet ajrore me anë të cilave pala serbe do të detyrohet të pranojë kushtet e paqes<sup>170</sup>. NATO e nisi fushatën ajrore me qëllim që të parandalonte një katastrofë humanitare-vrasjen dhe dëbimin e shqiptarëve të Kosovës si dhe të ruante sigurin rajonale duke i imponuar Beogradit planin e paqes për Kosovën në Rambuje<sup>171</sup>. Duke parë se serbët kishin shtuar krimet dhe shkatrrimet kundër popullit shqiptar dhe mijëra të pafajshëm i nënshtroheshin një brutalitet çnjerëzor dhe shpërnguljen me forcë pas djegies dhe shkatërimeve dhe nuk jepnin asnjë shenjë të pranimit të rrugës paqësore të zgjidhjes se krizës.

Që nga fillimi i sulmeve të NATO-së deri më 26 mars 1999, arritën 260 mijë të çvendosur me forcë nga Kosova në Shqipëri, Malin e Zi, ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë, Bosnie, Bullgari, Turçi. Në kufirin midis Kosovës dhe ish- Republikën Jugosllave të Maqedonisë, autoritetet policore e ushtarake të këtij shteti që ka gjysmën e popullsisë shqiptare vononin hyrjen e të shpërngulurve me arsyetimin e regjistrimit sepse policia dhe ushtria serbe u kishin grisur kartat e identitetit dhe çdo lloj dokumenti tjetër deri në dokumentacionin e mjeteve lëvizëse, duke u hequr edhe targat<sup>172</sup>. Trupat serbe përdorën armatim të rëndë, duke vrarë dhe masakruar civilë shqiptar të pambrojtur, gjithashtu Millosheviçi dëshironte të bënte spastrim etnik, makina ushtarake serbe dogji 120.000 shtëpi dhe u dëbuan nga trojet e veta rreth 1 milion shqiptar, në Shqipëri u vendosën 500.000 ( në disa të dhëna të tjera numëri i të shpërngulurve

---

<sup>170</sup> *Po aty, f, 172.*

<sup>171</sup> *Bajrami Arsim, E drejta e Kosovës në tranzicion ( E drejta Kushtetuese II), f, 75.*

<sup>172</sup> *Tepshi Qazim, Kosova dhe diplomacia imponuese, f, 185.*

nga Kosova në Shqipëri jepet nga 600.000-800.000), në Maqedoni 250.000 në Bosnjë 50.000<sup>173</sup>. NATO dhe SHBA përsërisnin se nuk do të lejonin pastrimin etnik dhe gjenocidin sidomos në pragun e Evropës. Këtë katastrof të madhe Serbia e bëri një element kryesor të politikës për të frenuar sulmet e NATO-së. Millosheviçi u dha amnisti terroristëve që të bashkohen me bandat e Arkanit, Mladiçit e Sheshelit për të zbatuar eliminimin e listave të zeza, duke arrestuar dhe eliminuar personalitetet e njohura shqiptare. Nuk dihet për fatin e përfaqësuesve të forcave politike shqiptare, as të që morën pjesë në Konferencën e Rambujes e të Parisit në kërkim të paqes në tokën e tyre. Duke shfrytëzuar rastin e sulmeve ajrore të NATO-së ashtu siç ishte deklaruar hapur dhe siç ishte paralajmëruar nga gjenerali Klark, Serbia Brenda një jave do ta boshatiste Kosovën nga popullsia e saj për ta përdorur pastaj si pazarllëk për ndarjen e saj në çdo proces paqeje. Duke përzënë shqiptarët nga shtëpitë e tyre policia dhe paramilitarët dhe bandat serbe u thonin: "shkoni t'ju mbroj Klintoni, shkoni në Shqipëri atje t'ju mbroj NATO"<sup>174</sup>. Në Bruksel zëdhënësi i NATO-së Xhejmi Shia shprehet se NATO garanton sovranitetin e Shqipërisë, vleron bashkëpunimin e Shqipërisë për përballimin e situatës tepër të rënduar nga të deportuarit dhe thekson se të gjithë shtetet antare do të ndihmojnë në ngritjen e tendave në dërgimin e ndihmave, se forcat që do të shkojnë në Shqipëri do të lehtësojnë operacionin e vështirë të përballimit të situatës së rënduar nga të deportuarit, kryeministri shqiptar Pandeli Majko theksoi se NATO, ka zënë vend të vacant në historinë e popullit shqiptar. Gjatë fushatës ajrore kundër Jugosllavisë NATO-ja bëri gjithsej 38.400 fluturime nga këto në 10.484 u bënë bombardime nga ajri u hodhën gjithsej 26.614 raketa. Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbajtën barrën kryesore ku forcat e saj bënë mbi 60% të numërit të përgjithshëm të fluturimeve dhe mbi 80% të numërit total të bombardimeve, SHBA po ashtu kishte rolin dominues në realizimin e aspekteve më moderne të fushatës ajrore<sup>175</sup>.

Bombardimet ajrore zgjatën plotë 78 ditë nga 24 mars 1999 e deri më 9 qershor të vitit 1999 kur në Kumanov u nënshkrua marrëveshja midis përfaqësuesve të NATO-së dhe gjeneralëve të Serbisë. Forcat serbe vranë dhe masakruan mbi 10.000 civil shqiptar dogjën mbi 100.000 shtëpi, shkatërruan dhe plaqkitën pasurinë e shqiptarëve dhe moren si pengj dhe rob të luftës një numër të madh të shqiptarëve dhe në mënyrë flagërante shkeli Konventat e Gjenevës të cilat

---

<sup>173</sup> Hysi Shyqyri, *Historia e trojeve dhe e diasporës shqiptare*, f. 169.

<sup>174</sup> Tepshi Qazim, *Kosova dhe diplomacia imponuese*, f. 181.

<sup>175</sup> Shala Xhavit, *Ballkani Gjeopolitika dhe Siguria*, f. 270.



përcaktojnë të drejtën e luftës<sup>176</sup>. Me marrvëshjen e Kumanovës u arritë që Brenda 11 ditëve të tërhiqen të gjitha forcat e armatosura jugosllave nga Kosova dhe të hynë trupat e NATO-së më 10 qershor 1999. Trupat e NATO-së ( KFOR-it), në Kosovë u vunë nën komandën e gjeneralit të NATO-së, M. Xheksanit ndërsa si përfaqësues i OKB-së u emërua diplomati francez, B. Kushner<sup>177</sup>.

#### **4.4.Tërheqja e forcave serbe (Marrëveshja e Kumanovës)**

Nënshkrimi i Marrvëshjes tekniko-ushtarake midis ushtrisë jugosllave dhe NATO-s, të cilën e përfaqësonte gjenerali Majk Xheksan shënoi fundin e bombardimeve ajrore të NATO-s dhe pranimin e kushteve që ajo i parashtrori Serbisë për njohje të kapitulimit dhe për tërheqjen e forcave të saja nga territori i Kosovës. Me rastin e arritjes se kësaj marrvëshje nuk është konsultuar asnjë nga subjektet politike dhe ushtarake shqiptare të Kosovës<sup>178</sup>.

Marrvëshja e Kumanovës përcakton modalitete tekniko-ushtarake të tërheqjes së forcave serbe nga territori i Kosovës dhe hyrja e forcave ndërkombëtare të sigurisë. Pas hyrjes së Forcave të NATO-së në Kosovë, Këshilli i Sigurimit më 10 qershor 1999, miratoi Rezolutën 1244 me të cilën edhe formalisht vendosi Kosovën nën administrimin e Kombeve të Bashkuara dhe hapi rrugën për vendosjen e prezencës ndërkombëtare civile dhe ushtarake në territorin e Kosovës<sup>179</sup>.

Marrvëshja përmban gjithsej 6 nene dhe dy shtesa.

Në nenin e parë përcaktohen obligimet kryesore në të cilën pala serbe pajtohet për vendosjen e prezencës civile të Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe pranimin nga ana e saj të vendosjes së Forcës së Sigurimit Ndërkombëtar ( KFOR). Serbia pranon tërheqjen e të gjitha forcave të sigurimit të saj duke përfshirë këtu të gjithë personelin dhe organizatat me aftësi militare të RFJ dhe Republikës së Serbisë nga territori i Kosovës që don të thotë armatën e rregulltë dhe forcat e marinës, grupet civile të armatosura, grupet paramilitare, forcat ajrore, gardën kombëtare, policing kufitare, rezervistet e armatës, policing ushtarake, policin lokale, special etj. Gjithashtu në nenin 1 përcaktohet Zona e Sigurisë Ajrore e cila përfshinë një zonë 25

---

<sup>176</sup> Bajrami Arsim, *E drejta e Kosovës në tranzicion ( E drejta Kushtetuese II)*, f. 76.

<sup>177</sup> Hysi Shyqyri, *Historia e trojeve dhe e diasporës shqiptare*, f. 169.

<sup>178</sup> Bajrami Arsim, *E drejta e Kosovës në tranzicion ( E drejta Kushtetuese II)*, f. 79.

<sup>179</sup> *Po aty*, f.80.

kilometrsin që zgjerohet përtej kufirit rajonal të Kosovës, dhe zona e Siguris Toksore është definuar si zonë 5 kilometërshe që zgjerohet përtej kufirit rajonal të Kosovës Brenda territorit të mbetur në RFJ, kjo përfshin terrenin brenda asaj zone 5 kilometërshe si dhe të sigurohet përkrahja dhe autorizimi i KFOR-it të ndërmarr aksione të tilla siç janë kërkuar duke përfshirë edhe përdorimin e forcës së domosdoshme për të siguruar përkrahjen e kësaj marrveshje dhe mbrojtjen e Forcës së Sigurisë Ndërkombëtare(KFOR), dhe të kontribuojë në ambientin e siguris të prezencës civile ndërkombëtare. KFOR-i do të angazhohet dhe do të operojë pa pengesë brenda Kosovës me autorizim të ndërmarrë të gjitha aksionet e domosdoshme të vendosë dhe të mbaj ambient të sigurt për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Në nenin 2 të Marrveshjes përcaktohen detyrimet e ndaljes së menjëhershme të veprimeve ushtarake dhe kushtet, rrugët dhe dinamika e tërheqjes së forcave serbe dhe jugosllave nga territori i Kosovës dhe në distancë të zonës tokësore dhe ajrore të sigurisë, krahas tërheqjes nga Kosova, forcat serbe dhe jugosllave detyrohen të shënojnë dhe pastrojnë të gjitha fushta e minuara, minat e befasisë dhe pengesat, gjerësa të tërhiqen forcat e RFJ- së do të pastrojnë të gjitha linjat e komunikacionit duke çmontuar të gjitha minat. Më tutje në këtë nen specifikohen saktësishtë afatet e tërheqjes së forcave serbe nga Kosova.

Dispozita e nenit 3,4,5 dhe 6 kanë karakter teknik dhe i referohen mekanizmave të implementimit të marrveshjes. Nënshkrimi i Marrveshjës së Kumanovës mundësoi fillimin e aksionit të vendosjes së Forcës Ndërkombëtare të Siguris në Kosovë (KFOR), dhe largimin e forcave serbe nga Kosova<sup>180</sup>.

Më 10 qershor 1999 pas miratimit të Rezolutës 1244 Këshilli i Aleancës së Atlantikut autorizoi hyrjen në Kosovë të trupave të KFOR-it, më 12 qershorë 1999 në operacionin e quajtur “ Mbrojtësi i Përbashkët”, kjo rezolut i lejonte secilit shtetë antare e OKB-së të vendos trupa në Kosovë praktikishtë nënkuptohej që KFOR-i , ishte e vetmja forcë ndërkombëtare e pranishme. KFOR-i për ta lehtësuar ruajtjen e paqes, bëri ndarjen e territorit të Kosovës në pesë zona. Secila zonë ishte nën kontrollin e një shteti të vetëm të NATO-së. Kështu veriu në rajonin e Mitrovicës u vu nën kontrollin e Francës me 7.000 trupa, jugu në rajonin e Prizrenit ishte nën përgjegjësin e Gjermanisë me 8.000 trupa, rajoni i Pejës në perëndim ishte vënë nën kontrollin e Italisë me 6.000 trupa, ndërsa zona qendërore përreth Prishtinës se dhe pjesa lindore e Gjilanit ishte nën

---

<sup>180</sup> Bajrami Arsim, *E drejta e Kosovës në tranzicion ( E drejta Kushtetuese II)*, f. 80.

përgjegjës in e Mbretëris së Bashkuar me 8.000 trupa dhe zona e Ferizajt dhe Vitisë ishte nën përgjegjës in e Shteteve të Bashkuara me 6.000 trupa<sup>181</sup>.

Vlenë të përmendet se ende pa hyrë forcat e NATO-së disa forca ruse të dislokuar në Bosnjë që ishin pjesë përbërse e misionit SFOR, me shpejtësi zbarkuan në aeroportin e Prishtinës duke rrezikuar kështu shpërthimin e një lufte botërore, falë marrveshjes se nënshkruar në Helsink më 18 qershor u përcaktuan kriteret e pjesmarrjes së rusëve në operacionet e KFOR-it, kontigjenti rus do të ketë 2.850 trupa dhe 750 trupa të tjera në aeroport si baza logjistike, këto njësi do të vepronin në kuadër të sektorit gjerman, amerikan dhe francez<sup>182</sup>.

---

<sup>181</sup> Shala Xhavit, *Ballkani Gjeopolitika dhe Siguria*, f, 281.

<sup>182</sup> Shala Xhavit, *Ballkani Gjeopolitika dhe Siguria*, f, 280.

## *Kapitulli V*

### *Kosova nën Administrimin Ndërkombëtar*

## 5.1. Administrimi ndërkombëtar i Kosovës

Rezoluta e këshillit të Sigurimit të OKB-së 1244, e miratuar më 10 qershor 1999, i cili në të vërtetë ka legalizuar situatën de facto të krijuar nga ndërhyrja e NATO-s, paraqet pikën themelore të referimit të administrimit ndërkombëtare në Kosovë pas mbarimit të luftës. Miratuar sipas Kapitullit VII të Kartës së OKB, kjo rezolutë krijon një rast të pazakontë, “sui generis”, të statusit ligjor për Kosovën.

**Këshilli i Sigurimit dhe Kosova**-Rasti i Kosovës reflekton më së miri këtë diskurs politik të brishtë kur kemi parasysh faktin që mospajtimet në Këshillin e Sigurimit rreth Pakos së Ahtissarit ky i fundit i deleguar/autorizuar special i po këtij mekanizmi ndërkombëtar-OKB-së) ishin shfaqje e një krize të brendshme konceptuale. Gjithsesi, në vitet e fundit, ruajtja e paqes nga OKB-ja është zhvilluar duke tejkaluar edhe kufijtë e vet tradicional, në një numër rastesh OKB-ja ka marrë përsipër edhe detyra ekzekutive duke ushtruar autoritet të përkohshëm qeveritar në territoret që kanë kërkuar ndihmë ndërkombëtare. Kështu, në rastin e Kosovës, UNMIK, ky mision i OKB-se u themelua mbi parimin se në Kosovë nuk eksistonte një autoritet sovran, respektivisht si ish-Jugosllavia ishte de-sovranizuar në Kosovë.

Kurse në nenin 42 të po këtij kapitulli flitet qartë për ndërhyrjen: “Nëse Këshilli i Sigurimit arrin në përfundim se masat e parashikuara në nenin 41 rezultojnë të papërshtatshme apo provohen si të tilla, ai mund të vendos që të ndërmarrë veprime me anë të forcave ajrore, detare e tokësore, si të gjykohet e nevojshme, për të ruajtur apo rivendosur paqen e sigurinë ndërkombëtare. Aksione të tilla mund të jenë demonstrime force, bllokada apo operacione me anë të forcave ajrore, detare e tokësore të shteteve anëtare të OKB-së”.<sup>183</sup>

---

<sup>183</sup> *Karta e Kombeve të Bashkuara, neni 41, Ruajtja apo rivendosja e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare, Albiform Tiranë, 1993*

**Struktura e misionit të OKB-së (UNMIK)**<sup>184</sup> Kur OKB filloi misionin në Kosovë, ishte autorizuar . Kjo rezolutë ka paraparë katër faza të operimit të këtij misioni:

–Kështu, në fazën e parë, UNMIK-u është dashur të kryejë funksionet themelore administrative civile (duke përfshirë rendin dhe ligjin).

–Faza e dytë, përfshin krijimin e institucioneve demokratike për vetëqeverisje lokale.

–Në fazën e tretë, misioni i UNMIK-ut ishte orientuar në lehtësimin dhe ndihmën e një procesi politik të dizajnuar për të përcaktuar statusin e ardhshëm të Kosovës.

–Në fazën e katërt, UNMIK-u është menduar të mbikëqyr kalimin e autoritetit nga institucionet e përkohshme të Kosovës në institucionet e themeluara sipas marrëveshjes politike.

Po ashtu dimensionin e nivelit të bashkëpunimit në mes të OKB-së dhe organizatave rajonale është një tjetër tipar unik i UNMIK-ut.

Në fakt, UNMIK-u ishte dizajnuar si një ndërmarrje e përbashkët e OKB-së dhe dy organizatave evropiane rajonale, domethënë BE-së dhe OSBE-së.

Ky bashkëpunim ishte strukturuar në formën e katër shtyllave, të cilat së bashku përbëjnë UNMIK-un.

Shtylla e I: Policia dhe Drejtësia, është organizuar nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Kombeve të Bashkuara<sup>185</sup> (deri në qershor 2000 kjo shtyllë është quajtur “ndihmë humanitare” dhe u drejtua nga Zyra e Komisionarit të lartë të Kombeve të Bashkuara për Refugjatë UNHCR).

Shtylla e II: administratës civile, ishte drejtuar drejtpërdrejtë nga Kombet e bashkuara, dhe mbulonte ushtrimin e funksioneve themelore administrative, në nivel qendror dhe lokal.<sup>186</sup>

Shtylla e III: demokratizimi dhe ndërtimi i institucioneve, është udhëhequr nga Organizata për Siguri dhe bashkëpunim në Evropë (OSBE-së). OSBE është në krye të demokratizimit dhe qeverisjes së mirë, organizimin e zgjedhjeve, media punët, monitorimin e të drejtave të njeriut, sundimit të ligjit dhe edukimin e policisë, dhe të zhvillimit.<sup>187</sup>

Shtylla IV: rindërtimi dhe Zhvillimi Ekonomik, i drejtuar nga Bashkimi Evropian (BE), e cila përfshin një fushë të gjerë të aktiviteteve lidhur me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik. Këto katër shtylla kanë punuar si qeveri klasike nën udhëheqjen e OKB-së, respektivisht zyrtarit më të lartë civil në Kosovë, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të përgjithshëm (PSSP).

---

<sup>184</sup> UNMIK-u. Misioni i Organizatës Kombeve të Bashkuara në Kosovë. I cili mision udhëhiqej nga Autoriteti i Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së

<sup>185</sup> Shala Xhavit, “Ballkani, gjeopolitika dhe siguria” Tiranë 2009, fq.278

<sup>186</sup> Po aty fq. 279

<sup>187</sup> Po aty

Rezoluta 1244 (paragrafi 6) përcakton se PSSP është i emëruar nga Sekretari i Përgjithshëm, pas konsultimit me Këshillin e Sigurimit dhe është përgjegjës direkt për të. PSSP megjithatë, nuk ka ndonjë fuqi politike/ligjore mbi KFOR-in, për faktin se përbërësit civil dhe ushtarak të misionit të OKB-së në Kosovë janë kryesisht të pavarura.<sup>188</sup>

## 5.2. Negociatat për statusin final

Në fund të vitit 2005 Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të bashkuara, Kofi Anan, emëroi ish-presidentin e Finlandës Martti Ahtissari, si emisar të tij special për të udhëhequr procesin politik të përcaktimit të statusit të ardhshëm të Kosovës. Ky proces i negociatave filloi zyrtarisht në shkurt të vitit 2006 me hapjen e të ashtuquajturave “biseda të Vjenës” në mes të përfaqësuesve të ekipit negociator të Kosovës dhe atij serb, me ndërmjetësim të emisarit specialë dhe të zëvendësit të tij, Albert Rohan nga Austria.

Pas raportit të Ahtissarit të 13 korrikut 2006 mbi procesin politik për statusin e ardhshëm drejt Këshillit të Sigurimit të Kombeve të bashkuara, negociatat kanë lëvizur drejt çështjes kryesore të statusit të Kosovës dhe bisedat përfshijnë zyrtarët më të lartë të të dy palëve.

**Struktura e negociatave** për statusin përfundimtar të Kosovës ishte kompleks. Korniza për negociata ishte përcaktuar nga Këshilli i Sigurimit, bazuar në rekomandimet e ambasadorit Kai Eide dhe të sekretarit të përgjithshëm të OKB-së. Kjo kornizë i kishte rrënjët, në një kuptim të përgjithshëm, te Rezoluta e Këshillit të Sigurimit 1244 (1999).

Kjo rezolutë e kishte afirmuar përkushtimin e secilit shtet që ta respektonte sovranitetin dhe integritetin territorial të RSFJ-së.

Negociatat kishin filluar, kjo pikëpamje u forcua me ankthin se “koha në Kosovë po skadonte” dhe se rajoni i Ballkanit do të mund të futej në rrëmuja të reja. Ishte bindja e shumicës së vendeve perëndimore se, marrë parasysh historinë e freskët, nuk do të ishte shumë reale që Kosova të vendosej sërish nën sovranitetin e Serbisë.

---

<sup>188</sup> Sipas kushteve të rezolutës 1244, si KFOR-i dhe UNMIK-u duhet “të veprojnë në drejtim të qëllimeve të njëjta dhe në mënyrë reciprokisht mbështetëse”.

Përderisa Këshilli i Sigurimit e kishte konfirmuar udhë[heqjen e procesit të statusit nga OKB-ja, në të vërtetë Grupi i Kontaktit do të vepronte si trup kontrollues për negociatat dhe për emisarin e posaçëm të OKB-së, Martti Ahtissari. Grupi i Kontaktit miratoi dhjetë “Parimet Udhëheqëse” për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Këto parime në esencë vendosën linjat e kuqe për t’u imponuar nga ndërmjetësit në negociata. Parimet kishin të bënin me: të drejtat e njeriut, vlerat demokratike, parimet e integritetit euroatlantike, sigurinë, pjesëmarrjen në politikë të grupeve etnike, sigurimi i kthimit të refugjatëve dhe të zhvendosurve, mbrojtja e trashëgimisë kulturore dhe fetare, stabiliteti rajonal dhe zhvillimi ekonomik. Gjithashtu u bë e qartë, prerazi se nuk do të kishte kthim mbrapa në situatën që kishte ekzistuar në Kosovë para ndërhyrjes së NATO-s. Parimet udhëheqëse gjithashtu theksonin se “Cilado zgjidhje që është e njëanshme apo është pasojë e përdorimit të forcës do të ishte e papranueshme”.

Përderisa GK i udhëhiqte negociatat, procesi ishte megjithatë zyrtarisht punë e OKB-së. Sekretari i Përgjithshëm i OKB-së e emëroi jo vetëm emisarin e posaçëm, Matti Ahtissarin, por edhe zëvendësin e tij Albert Rohanin e Austrisë, i cili i udhëhoqi bisedimet. Ndërmjetësit e negociatave ishin të përcaktuar nga një sekretariat, nga zyra e OKB-së e emisarit të posaçëm për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës (UNOSEK).<sup>189</sup>

Puna e hartimit juridik për përcaktimin e formatit të bisedimeve ishte e drejta e sekretariatit gjithashtu ishte përkrahur nga këshilltarë shumë me përvojë. Negociatat e drejtpërdrejta normalisht një shabllon të caktuar. Ndërmjetësit do t’i ftonin delegacionet në Vjenë për një periudhë disa ditësh, duke ua ofruar agjendën për vetëm një sferë (ta zëmë, decentralizimin) që do të duhej shqyrtuar gjatë kësaj periudhe.

Negociatat e drejtpërdrejta zhvilloheshin rreth një tavoline të formës së patkoi në njërin nga pallatet e qytetit të Vjenës. Delegacioni kosovar gjithnjë përmbante nivelin e ministrit dhe të ministrave për t’i mbuluar çështjet e ngritura për secilin sesion negociatash. Prandaj edhe përbërja e ekipit ndryshonte varësisht nga çështja që shqyrtohej. Delegacioni vepronte nën udhëheqjen reprezentative të krijuar enkas për negociim të njohur si “Ekipi i Unitetit”.<sup>190</sup> Gjithashtu Ekipi ishte i përkrahur edhe nga një mekanizëm i krijuar nga “Grupi Politik Strategjik” i përbërë nga përfaqësuesit më të lartë të Kosovës përderisa Kosova përfaqësohej në

---

<sup>189</sup> Sekretari i përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara caktoi ish-presidentin finlandez, Martti Ahtissari, si i dërguar special i OKB-së për Kosovën. Qëllimi i tij ishte të hartonte një propozim gjithëpërmbledhës për të zgjidhur statusin politik të Kosovës.

<sup>190</sup> Grupi i unitetit përbëhej nga: Kryetari Fatmir Sejdiu (LDK); kryeministri Agim Çeku AAK; Kryetari i Kuvendit Kolë Berisha, Hashim Thaçi, lider i PDK-së në emër të opozitës dhe Veton Surroi kryetar i partisë ORA.



nivel të lartë, Serbia kishte zgjedhur për përfaqësimit më të ulët nga radhët e ministrisë së saj të jashtme, krahas përfaqësuesve të trupave të tjera, ekspertëve dhe “përfaqësuesve të vet” të komuniteteve të Kosovës. Çështja e përfaqësimit të komuniteteve të ndryshme të Kosovës çoi deri te një situatë anormale. Përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë kishin një qasje dualiste.

Beogradi ishte kryesisht i fokusuar me gjithë energjinë që të konfirmohej sovraniteti i tij territorial, edhe nëse ishte i gatshëm që ta pezullonte ushtrimin e pushtetit politik edhe një kohë si dhe të pranonte kufizimin e theksuar të pushtetit në afat më të gjatë. Para se t’ia nisin negociatat, kuvendi popullor i Serbisë i dha mandat delegacionit të vet, duke kërkuar mbrojtjen e gjerë të së drejtës ndërkombëtare, dhe duke shprehur: “Çfarëdo përpjekje për ta imponuar një zgjidhje drejt legalizimit të ndarjes de facto të republikës së Serbisë me një shkëputje të një pjese të territorit të saj do të përbënte shkelje të së drejtës ndërkombëtare”.

Prandaj pozicioni i Beogradit ishte i ngurtë i mbështetur mbi parimet strukturore të së drejtës klasike ndërkombëtare, që favorizonte kontekstin territorial dhe kolonial. Gjithashtu Moska i ofroi Serbisë se ajo nuk do të lejonte imponimin e asnjë zgjidhjeje në kundërshtim me vullnetin e saj.

Nëse veprimi kolektiv për ta tejkaluar mungesën e pëlqimit të Serbisë ishte i pamundur, mbase në kombinim perspektiva dukej e veprimit të njëanshëm.

Pozicioni i Kosovës, pavarësisht sa i qartë ishte, nuk i shmangej rrezikut. Shqetësimet e Kosovës në këtë aspekt po ushqeheshin edhe me nivelin e ulët të konsultimeve në mes të dërguarit të posaçëm dhe delegacionit të saj. Kur erdhi ftesa zyrtare për rundin e parë të bisedimeve, nuk kishte pasur informata për formatin e bisedimeve, për agjendën, apo për procesin negociator. Ekzistonte frika se, nëse palët nuk arrinin marrëveshjen atje, atëherë pakoja do të mund të prishe Në mungesë të ekspertëve dhe mjeteve të praktikës diplomatike, Prishtina nuk ka pasur përparësinë e konsultimeve ekstensive preliminare për procesin e negociimit.

**Fillimi i rundit të parë** të negociatave ishte paksa delikate. Në pajtim me parimet e përcaktuara nga ambasadori Eide<sup>191</sup> në raportin e tij të dytë, dërguar sekretarit të përgjithshëm të OKB-së, supozohej se, kur njëherë bisedimet të nisin, ato do të mund të “bllokoheshin” nga

---

<sup>191</sup> Kai Eide, si i dërguar i posaçëm i OKB-së në Kosovë në raportin që i dorëzoi sekretarit të përgjithshëm Kofi Anan shprehej se ka ardhur koha për hapjen e procesit të statusit të Kosovës. Në raportin e z. Eide u bazua Kofi Anan për ti sugjeruar këshillit të sigurimit që të autorizojë bisedimet për statusin përfundimtarë të Kosovës.

cilado palë. Për t'iu shmangur bllokimit, më 12 janar 2006 palëve iu dërgua ftesa “në favor të avancimit të dialogut politik për statusin e ardhshëm të Kosovës” që të bisedonin për çështjet mjaft teknike siç ishte decentralizimi. Ky ishte një hap i mençur, ngase kishte ekzistuar një grup punues teknik për këtë çështje, para se të fillonte procesi negociator i statusit. Gjithsej u mbajtën 15 runde të negociatave të drejtpërdrejta në Vjenë gjatë vitit 2006.

Çështja e decentralizimit mori pothuajse gjysmën e kohës së sesioneve, megjithatë një propozim nga ambasadori Eide kishte qenë për ta bërë transparent procesin dhe të caktoheshin agjendat, formati dhe procedurat e bisedimeve për të dyja palët. Përmbajtja konsistonte në kontestin territorial të komunave, të vetëqeverisjes lokale nga serbët si dhe kompetencat e tyre.

Beogradi kërkonte krijimin e 15 komunave të reja kryesisht për serbët. Pastaj një rëndësi e veçantë iu kushtua edhe trashëgimisë kulturore e fetare. Kosova ofronte një qasje funksionale për këtë çështje. Serbia kërkonte që të merrte kontrollin mbi enklavat dhe kishat me lidhje speciale me Beogradin. Vetëm një sesion iu kushtua problemeve ekonomike. Autoritetet e Kosovës nguronin në ndarjen e pushtetit. Përvoja e Bosnjës e kishte mësuar delegacionin e Kosovës që të ketë kujdes. Mirëpo ndërmjetësit insistonin në ndarjen e pushtetit.

### **Përmbajtja e Pako-s së Ahtissarit**

Përmbajtja e propozimit gjithëpërfshirës të Ahtissarit (A-statuisi, B-Ndërtimi i sistemit politik, C- Të drejtat e komuniteteve, D-Prezenca ndërkombëtare, E-Rekomandimi i të dërguarit të posaçëm). Propozimi gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit të Kosovës, posedon një marrëveshje kornizë të shkurtër dhe 12 anekse. Marrëveshja e pakos ofron elemente për një kushtetutë të ardhshme të Kosovës, udhëzime të detajuara për të drejtat e pakicave dhe çështjet e komuniteteve, decentralizimin dhe çështje të tjera, siç i parasheh prezencën civile dhe ushtarake ndërkombëtare pas tranzicionit.<sup>192</sup>

**Statusi**-dokumenti i njohur si “Pakoja e Ahtissarit”.

Pakoja gjithashtu e qartësoi se Kosova do t'i kishte të gjitha fuqitë e qeverisjes që lidhen për shtetësinë dhe duke mbuluar degët e legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit. Në të kaluarën të gjitha këto të drejta ishin të rezervuara për UNMIK-un.

---

<sup>192</sup> *Propozimi gjithëpërfshirës për marrëveshjen për statusin e Kosovës , Aneksi I, dispozitat kushtetuese, 26 mars 2007, Vjenë*

Pakoja e konfirmoi mundësinë e shtetësisë në disa mënyra të ndryshme. Në formë të padiskutueshme ia dha kapacitetin Kosovës që të vendoste marrëdhënie ndërkombëtare, përfshirë edhe lidhjen e traktateve dhe anëtarësimin në organizatat ndërkombëtare. Në formë specifike kërkonte që Kosova të nënshkruante dhe ta ratifikonte Konventën evropiane për të drejtat e njeriut-një akt që mund ta kryej vetëm një shtet. Pakoja madje insistonte që Kosova të merrte nën kontroll hapësirën e vet ajrore-dhe të funksionon tipik i ushtruar nga një shtet plotësisht sovran.

Për t'iu përgjigjur këtyre duhej pasur parasysh tri çështje themelore:

1. Struktura themelore e shtetit;
2. Dispozitat e veçanta që ishin paraparë në favor të komuniteteve pakicë;
3. Roli i ardhshëm i agjencive ndërkombëtare.

### **Ndërtimi i sistemit politik.**

#### **Të drejtat e komuniteteve-<sup>193</sup>**

**Prezenca ndërkombëtare-** Prezenca ndërkombëtare edhe në këtë propozim të pakos ishte e theksuar. Ajo gradualisht zëvendësonte kompetencat e UNMIK-ut dhe i bartë tek misioni i ardhshëm i tij, i njohur si EULEX dhe zyra e përfaqësuesit civil ndërkombëtar.

**Rekomandimi i të dërguarve të posaçëm-**Më 26 mars 2006, sekretari i përgjithshëm i OKB-së ia dërgoi KS versionin përfundimtar të propozimit gjithëpërfshirës. Propozimi ishte përpiluar pa shprehur shprehimisht statusin, dokumenti kishte edhe një rekomandim për statusin nga i dërguari i posaçëm. Rekomandimet vlerësonin: “Është koha se statusi duhet të zgjidhet”, “Kosova është rast unik që kërkon zgjidhje unike”, “Nuk krijon raste precedent për ndonjë konflikt tjetër të pazgjidhur” e rekomandime të ngjashme.<sup>194</sup> Negociatat për statusin përfundimtar të Kosovës u zhvilluan në katër dimensione: dimensionin në nivelin e Këshillit të Sigurimit. Niveli në Grupin e Kontaktit. Niveli i negociatave në Vjenë. Niveli lokal Kosovë-Serbi.

Plani i Ahtisarit për zgjidhjen gjithëpërfshirëse të statusit të Kosovës u përshëndet me entuziazëm në Kosovë. Periudha 120 ditësh ishte periudha ku duhej të kalonte sipas propozimit gjithëpërfshirës. Nga fundi i kësaj periudhe, mekanizmat ndërkombëtar për zbatimin e marrëveshjes do të merrnin detyrat dhe Kosova do të ishte e lirë që ta shpallte pavarësinë. Të gjitha vendet mike të pavarësisë së Kosovës inkurajonin dhe kërkonin që në Kosovë të ruhej edhe për pak kohë stabiliteti, ngase në rrugë diplomatike Kosovës i garantohej e drejta e shpalljes së pavarësisë. Gradualisht dhe në koordinim të plotë para perdeve Kosova kishte filluar ta

<sup>193</sup> *Pakoja e Ahtisarit, aneksi II, Neni 1.1, Të drejtat e komuniteteve, 2007, Vjenë*

<sup>194</sup> *Pakoja e Ahtisarit, Shqyrtimi i periudhës 120 ditësh në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, 3 prill, 2007*

përgatiste terrenin dhe fuqishëm e mbështetur nga ShBA, Anglia, Franca, Gjermania, Shqipëria, Turqia etj, po dakordoheshin për finalen e rezultatit dhe shpalljen e pavarësisë.

### **5.3. Shpallja e Pavarësisë**

Në fillim të prillit të vitit 2007 Plani i Ahtissarit u diskutua në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Në mbledhje ishte i ftuar edhe vet Ahtisari. Pas mbledhjes maratonë të Këshillit të Sigurimit ai deklaroi: “Unë nuk planifikoj asnjë ndryshim në planin tim”.<sup>195</sup> Ai është mbështetur nga sekretari i përgjithshëm, plani i është dërguar KS-së dhe tani i takon atij që ta vazhdoj. Në kushtet e mosmiratimit të rezolutës kuvendi i Kosovës i mbledhur më 17 shkurt 2008 në një mbledhje të jashtëzakonshme në Prishtinë-kryeqyteti i Kosovës miratoi deklaratën për pavarësinë e Kosovës. Gjermania do të jetë shteti i parë që menjëherë pas shpalljes së pavarësisë do të emërojë ambasadorin e saj në Kosovë.

Akti i shpalljes së pavarësisë së Kosovës do të përmbledh 12 pika që do të quhet edhe si deklarata e pavarësisë së Kosovës Republikë. I gjithë ky proces erdhi pas shumë përpjekjeve historike të popullit shqiptar si dhe mbështetjes permanente të SHBA-ve si dhe mbështetjes së fuqishme nga perëndimi.

Mirëpo shpallja e Kosovës Republikë do të shkatojë indinjatë të thellë tek Rusia, Kina dhe India të cilat pastaj me deklaratën e tyre të përbashkët do të kërkojnë negociata të reja në mes autoriteteve të Prishtinës dhe Beogradit.

Procesi i njohjes së Kosovës është duke vazhduar edhe gjatë ditëve të sotme ku deri më tani mbi 100 shtete shumica prej tyre shtete anëtare të Kombeve të bashkuara kanë njohur formalisht Republikën e Kosovës.

---

<sup>195</sup> Shala Xhavit, “Ballkani gjeopolitika dhe siguria I” Tiranë 2009, fq.386

#### **5.4. Deklarata e pavarësisë**

1. Ne, udhëheqësit e popullit tonë, të zgjedhur në mënyrë demokratike nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran. Kjo shpallje pasqyron vullnetin e popullit tonë dhe është në pajtueshmëri të plotë me rekomandimet e të **Dërguarit Special të Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisaari**, dhe propozimin e tij Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës.

2. Ne shpallim Kosovën një republikë demokratike, laike dhe multietnike, të udhëhequr nga parimet e jodiskriminimit dhe mbrojtjes së barabartë sipas ligjit. Ne do të mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e të gjitha komuniteteve në Kosovë dhe krijojmë kushtet e nevojshme për pjesëmarrjen e tyre efektive në proceset politike dhe vendimmarrëse.

3. Ne pranojmë plotësisht obligimet për Kosovën të përmbajtura në Planin e Ahtisaarit, dhe mirëpresim kornizën që ai propozon për të udhëhequr Kosovën në vitet në vijim. Ne do të zbatojmë plotësisht ato obligime, përfshirë miratimin prioritar të legjislacionit të përfshirë në Aneksin XII të tij, veçanërisht atë që mbron dhe promovon të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre.

4. Ne do të miratojmë sa më shpejtë që të jetë e mundur një kushtetutë që mishëron zotimin tonë për të respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të gjithë qytetarëve tanë, posaçërisht ashtu siç definojnë me **Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut**. Kushtetuta do të inkorporojë të gjitha parimet relevante të Planit të Ahtisaarit dhe do të miratohet nëpërmjet një procesi demokratik dhe të kujdesshëm.

5. Ne mirëpresim mbështetjen e vazhdueshme të bashkësisë ndërkombëtare për zhvillimin tonë demokratik nëpërmjet të pranive ndërkombëtare të themeluara në Kosovë në bazë të **Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999)**. Ne ftojmë dhe mirëpresim një prani ndërkombëtare civile për të mbikëqyrur zbatimin e **Planit të Ahtisaarit** dhe një mision të sundimit të ligjit të udhëhequr nga **Bashkimi Evropian**. Ne, po ashtu, ftojmë dhe mirëpresim **NATO-n** që të mbajë rolin udhëheqës në praninë ndërkombëtare ushtarake dhe të zbatojë përgjegjësitë që i janë dhënë sipas **Rezolutës 1244 të Këshillit të**

**sigurimit të Kombeve të Bashkuara (1999) dhe Planit të Ahtisaarit**, deri në atë kohë kur institucionet e Kosovës do të jenë në gjendje të marrin këto përgjegjësi. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me këto prani në Kosovë për të siguruar paqen, prosperitetin dhe stabilitetin në të ardhmen në Kosovë.

6. Për arsye të kulturës, gjeografisë dhe historisë, ne besojmë se e ardhmja jonë është në familjen evropiane. Për këtë arsye, ne shpallim synimin tonë për të marrë të gjitha hapat e nevojshëm për të siguruar anëtarësim të plotë në **Bashkimin Evropian** sapo që të jetë e mundshme dhe për të zbatuar reformat e kërkuara për integrim evropian dhe euroatlantik.

7. Ne i shprehim mirënjohje **Organizatës së Kombeve të Bashkuara** për punën që ka bërë për të na ndihmuar në rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas lufte dhe ndërtimin e institucioneve të demokracisë. Ne jemi të përkushtuar të punojmë në mënyrë konstruktive me **Organizatën e Kombeve të Bashkuara** gjersa ajo të vazhdon punën e saj në periudhën në vijim.

8. Me pavarësinë vjen detyra e anëtarësisë së përgjegjshme në bashkësinë ndërkombëtare. Ne e pranojmë plotësisht këtë detyrë dhe do t'i përmbahemi parimeve të **Kartës së Kombeve të Bashkuara, Aktin Final të Helsinkit**, akteve tjera të **Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë**, obligimeve ligjore ndërkombëtare dhe parimeve të marrëdhënieve të mira ndërkombëtare që shënojnë marrëdhëniet ndërmjet shteteve. Kosova do të ketë kufijtë e saj ndërkombëtar ashtu siç janë paraparë në **Aneksin VIII të Planit të Ahtisaarit**, dhe do të respektojë plotësisht sovranitetin dhe integrimin territorial të të gjithë fqinjëve tanë. Kosova, po ashtu, do të përmbahet nga kërcënimi apo përdorimi i forcës në cilëndo mënyrë që është jo konsistente me qëllimet e **Kombeve të Bashkuara**.

9. Ne, përmes kësaj Deklarate, marrim obligimet ndërkombëtare të Kosovës, përfshirë ato të arritura në emrin tonë nga **Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK)**, si dhe obligimet e traktateve dhe obligimet tjera të ish-Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë ndaj të cilave obligohemi si ish-pjesë konstituive, përfshirë konventat e Vjenës për marrëdhëniet diplomatike dhe konsullore. Ne do të bashkëpunojmë plotësisht me **Tribunalin Penal Ndërkombëtar** për ish-Jugosllavinë. Ne synojmë të kërkojmë anëtarësim në organizatat ndërkombëtare, në të cilat Kosova do të synojë të kontribuojë për qëllimet be paqes dhe stabilitetit ndërkombëtar.

10. Kosova shpall zotimin e saj ndaj paqes dhe stabilitetit në rajonin tonë të Evropës Juglindore. Pavarësia jonë e sjell në fund procesin e shpërbërje së dhunshme të Jugosllavisë.

Gjersa ky proces ka qenë i dhembshëm, ne do të punojmë pa pushim për t'i kontribuar një pajtimi që do të lejonte Evropën Juglindore të shkojë përtej konflikteve të së kaluarës dhe të farkojë lidhje të reja rajonale të bashkëpunimit. Për këtë arsye, do të punojmë së bashku me fqinjët tanë për të avancuar të ardhmen tonë të përbashkët evropiane.

11. Ne shprehim, në veçanti, dëshirën tonë për të vendosur marrëdhënie të mira me të gjithë fqinjët tanë, përfshirë Republikën e Serbisë, me të cilën kemi marrëdhënie historike, tregtare dhe shoqërore, të cilat synojmë t'i zhvillojmë më tej në të ardhmen e afërt. Ne do të vazhdojmë përpjekjet tona për t'u kontribuar marrëdhënieve të fqinjësisë dhe bashkëpunimit me Republikën e Serbisë duke promovuar pajtimin ndërmjet popujve tanë.

12. Ne, nëpërmjet kësaj, afirmojmë në mënyrë të qartë, specifike dhe të përvokueshme se Kosova do të jetë ligjërisht e obliguar të plotësojë dispozitat e përmbajtura në këtë Deklaratë, përfshirë këtu veçanërisht obligimet e saj nga **Plani i Ahtisaarit**. Në të gjitha këto çështje, ne do të veprojmë në pajtueshmëri në parimet e së drejtës ndërkombëtare dhe rezolutat e **Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, përfshirë Rezolutën 1244** (1999). Ne shpallim publikisht se të gjitha shtetet kanë të drejtën të mbështeten në këtë Deklaratë, dhe u bëjmë apel të na ofrojnë përkrahje dhe mbështetjen e tyre.<sup>196</sup>

---

<sup>196</sup> *Gazeta e përditshme-Koha; (e hënë) 18 shkurt, 2008. f.15.*

## 5.5. Njohjet e para

Deri në fund të vitit 2008, ishin këto të dhëna statistikore për njohjen e Republikës së Kosovës.<sup>197</sup>

Është e njohur nga 53 shtete anëtare të OKB-së në përqindje 27%.

Është e njohur nga 3 shtete anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, apo në përqindje 60%.

Është e njohur nga 5 shtete anëtare të përkohshme të KS të OKB-së , në përqindje 50%.

Është e njohur nga 22 shtete të Bashkimit Evropian, apo në përqindje 81%.

Është e njohur nga 22 shtete të NATO-s, në përqindje 84%.

Është e njohur nga 35 shtete të OSBE-së apo 62%.

Është e njohur nga 33 shtete të Këshillit të Evropës në përqindje 70%.

Është e njohur nga 8 shtete të Konferencës Islamike, apo 14%.

Është e njohur nga 1 shtete të Ligës Arabe apo në përqindje 4%.

Është e njohur nga të gjitha vendet e G7-s.

Shtetet që e kanë njohur Kosovën deri në fund të vitit 2008 përbënte 70.9 % të GDP-së botërore.<sup>198</sup>

---

<sup>197</sup> Shala Xhavit, "Ballkani gjeopolitika dhe siguria I", Tiranë 2009, fq392

<sup>198</sup> Po aty, fq. 393



## Konkluzat përfundimtare

Skatërimi i Jugosllavisë Federative shkaktoi hapjen e një sërë problemeve të vjetra në trevat Ballkanike Duke ndikuar fuqishëm në faktorin e brendshëm dhe në ngritjen e ndërgjegjes kombëtare në shkallën më të lartë si dhe në faktorin e jashtëm, pra në ndërkombëtarizimin e çështjes shqiptare në përgjithësi të çështjes së Kosovës e në veçanti ato në horizontin mbarëshqiptarë hapen si një shpresë e madhe dhe një prespektivë e re. Gjatë periudhës 1981-2008 shqiptarët dhe Kosova përjetuan momentet më të rënda të historisë së vet në veçanti pas ardhjes në pushtet të Slobodan Milosheviqit në vitin 1986 kur Serbia filloi të rënojë gjithçka që ishte ndërtuar si autonomi e Kosovës. Në vitin 1990 ra sistemi i daktaturave në të gjitha vendet socialiste të Evropës sikurse edhe në Jugosllavi. Në Maqedoni me lindjen e pluralizmit politik dolën në skenë forca të ndryshme politike maqedonase dhe shqiptare. Ngjarjet që pasuan më vonë shkaktuan procese retrograde të cilat u përcollën me masa drakonike kundër rinisë kosovare, intelektualëve dhe në përgjithësi kundër popullit shqiptarë të Kosovës. **Në rafshin ndërkombëtarë** u lansua imazhi për pjekurinë politike të Kosovës për mundësinë e tyre organizative për peshën e tyre politike dhe rolin që **mund ta luajnë me sukses mbrenda përbrenda Kosovës**. Faktori ndërkombëtarë filloi të mendojë se si të intervenohet në Kosovë për të parandaluar destabilizimin e rajonit.

Duhet thënë haptazi se gadishmëria e shqiptarëve që të durojnë dhe të vazhdojnë me kursin politik për pavarësi kundërvënia e vendosur e prirë nga UÇK-ja dhe subjektet tjera politike luajtën me këtë rast një rol global historik që ishin faktorë determinant që e sollën NATO-n dhe Evropën në Ballkan. Në kontiunitetin e përpjekjeve, luftrave dhe qëndresës shekullore të popullit shqiptarë për liri e pavarësi si dhe demonstratat e pranverës së vitit 1981 shënojnë një ndër faqet më të ndritura dhe më të rëndësishme të historisë sonë të re.

Duke analizuar faktorin kohë mbi ngjarjet diplomatike dhe politike që ndodhën në Ballkan në shekullin e kaluar dhe në fillim të këtij shekulli, gjithmonë është lidhur me moszgjidhjen e çështjes shqiptare në Ballkan. Prandaj në bazë të hulumtimit të punimit të doktoratures si dhe konsultimin e literaturës përkatëse po i përmend disa nga konkluzat në rafshin diplomatik mbi shqiptarët e Kosovës:

1. Shqiptarët si faktorë shumë i rëndësishëm në Ballkan në peridha të ndryshme diplomatike nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë nga këto fuqi.

2. Rezistenca kombëtare aktive si në rafshin politik e më vonë atë ushtarak i shqiptarëve filloi që me coptimin e trojeve shqiptare dhe përfundon me rezistencën e armatosur në vitin 1999.

3. Vitet 1981 shënuan një kthesë në ngritjen e vetëdijes nacionale jo vetëm të shqiptarëve të Kosovës por edhe në të gjitha trevat e ish-Jugosllavisë, që shënojnë një fazë të re në bashkimin e tyre shpirtërorë e më vonë atë politik.

4. Periudha pas vitit 1981 është periudhë në të cilën fillon ndërkombëtarizimi i çështjes shqiptare në radhë të parë falë diasporës e cila u organizua në forma të ndryshme për të bërë me dije qendrave të vendosjes me anë të demonstratave dhe peticioneve në njërën anë dhe në anën tjetër roli i pamohueshëm i Ibrahim Rugovës që me rezistencë aktive ariti të sensibilizojë faktorizimin e elementit shqiptarë në arenën ndërkombëtare.

5. Përpjekjet diplomatike në fund të viteve '90 kulmuan dhe u përforcuan me rezistencën ushtarake të bashkuar shqiptare rreth UÇK-së. Kjo forcë e përshpejtoi inkuadrimin sa më aktiv të diplomacisë Amerikano-Angleze rreth zgjidhjes së problemit të Kosovës.

6. Të gjitha përpjekjet diplomatike dhe ushtarake rreth zgjidhjes së problemit të Kosovës u kurorizuan falë angazhimit aktiv mbi të gjitha SHBA-ve të cilët seriozisht e kishin kuptuar se populli shqiptarë meriton tretman të barabartë si gjithë popujt tjerë në Ballkan.

7. Diplomacia amerikane nuk përfundoi vetëm me marëveshjen e Kumanovës, por vazhdon të llobojë që shteti i ri i Kosovës të njihet ndërkombëtarisht nga të gjitha shtetet demokratike të botës.

Literatura:

1. *Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës; “Kosova shte ti pavarur dhe sovran”, Prishtinë 2006*
2. *Akademia e Shkencave dhe Arteve të Kosovës; “Statusi i ardhshëm i Kosovës”, Prishtinë 2005*
3. *Akademia e shkencave të RPS të Shqipërisë “ E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi”Tiranë 1990*
4. *Akademia e shkencave( qendra e enciklopedisë shqiptare) Kosova në vështrimin enciklopedik; Toena; Tiranë 1999*
5. *Alush Kamberi, Përndjekjet e mëdha, Shkup, 1999*
6. *Aziri Etem; “Organizimi politik i shqiptarëve në Maqedoni” Shkup 2004*
7. *Bajrami Arsim; “E drejta e Kosovës në tranzicion” Prishtinë 2002*
8. *Berisha Beqir; “Çështja kombëtare shqiptare dhe “ultrakomunistët shqiptarë”, Tetovë 1996*
9. *Buja Ramë; “Konferenca e Rambujesë (aspekti juridik, politik e ndërkombëtarë), Prishtinë 2004*
10. *“Dëbimet e shqiptarëve dhe kolonizimi i Kosovës (1877-1995)” Prishtinë 1997*
11. *Eva Hyskaj Tafili- Tranzicioni politik në Evropën qendrore dhe lindore, Tiranë 2008*
12. *Fischer Joschka Vitet kuq-gjellbër, Koha, Prishtinë; 2008*
13. *Gleny Misha; “Histori e Ballkanit-1804-1999; Granata books, Londër 2000*
14. *Gllareva Fitim ”Diplomacia amerikane në konfliktin e Kosovës 1989-1999,, Prishtinë 2004*
15. *Gruda Zejnullah; “Mbrojtja ndërkombëtare e të drejtave të njeriut” Prishtinë 2000*
16. *Grup autorësh; “Ç’thonë dhe ç’kërkojnë kosovarët” Tiranë 1990*
17. *Grupë autorësh; “Historia e shqipërisë dhe e shqiptarëve”Prizren 2001*
18. *H. Henry& Jr. Perritt; “Ushtria Çlirimtare e Kosovës- Rrëfim prej brenda për një kryengritje”, Prishtinë 2008*
19. *Hasanaj Adem; “Kosova nyja e rendit të ri botërorë”, Tiranë 2000*

20. *Hasani Enver; "Shpërbërja e Jugosllavisë dhe Kosova" Prishtinë 2000*
21. *Instituti i historisë bashkëkohore "Kosova shtet i pavarur dhe sovran"- Prishtinë 2006*
22. *Ismaili Osman; "Partirë politike shqiptare dhe çështja e Kosovës (1989-1998) Prishtinë 2001*
23. *Judah Tim; "Kosova luftë dhe hakmarje" Prishtinë 2002*
24. *Kiçmari Sabri: "Kosova shtet sovran i pavarur" Prishtinë, 2006*
25. *King Lain& Mason Ëhit; "Paqe me çdo kusht", Prishtinë 2007*
26. *Komiteti i Kosovës për informimin e opinionit botëror; "Helmimi i rinisë shkollore në Kosovë" Zvicër, Gusht 1990*
27. *Kraja Mehmet; "Vite të humbura" Tiranë 1995*
28. *Krasniqi Jakup; "Kthesa e madhe" Prishtinë 2006*
29. *Lalaj Ana: "Kosova rruga e gjatë drejt vetëvendosjes" Tiranë 2000*
30. *Lory Bernard; "Europa Ballkanike nga 1945 në ditët tona" Dituria 2007*
31. *Lushi Uk; "Batalioni Atlantiku" :Rilindja, Prishtinë 2001*
32. *Malkolm Noel "Kosova një histori e shkurtër" Prishtinë 1998*
33. *Meier Viktor; "Fundi i Jugosllavisë goditja në Kosovë" Lublanë 2006*
34. *Metais Serge; "Histori e shqiptarëve (nga ilirët deri te Pavarsia e Kosovës)' Fayard 2006*
35. *Ndreca Mikel; "87 vjet terror dhe gjenocid shtetërorë (1912-1999), Prishtinë 2001.*
36. *Petriç Wolfgang & Robert Pihleri; "Rruga e gjatë në luftë" Prishtinë 2002*
37. *Petrich Eölfgang, Kaser K. dhe Pichler R.; "Kosova- mitet, të dhënat, faktet", Viyer, Klagenfurt, 1999*
38. *Pirraku Muhamet; "Për kauzën shqiptare 1997-1999" Prishtinë 2000*
39. *Poulton Hugh, 2000 Èho are the Macedonians?, London, Hurst& Co. 2000*
40. *Prifti Kristaq: "E vërteta mbi Kosovën dhe shqiptarët në Jugosllavi", Tiranë 1990*
41. *Pushkolli Fehmi, " Historia e popullit shqiptarë", Prishtinë 2001*
42. *Pushkolli Fehmi; "Zahir Pajaziti hero i kombit" Prishtinë 2001*
43. *Puto Arben; "Diplomacia e çështje shqiptare", Tiranë 2001*

44. Qosja Rexhep; *“Paqja e përgjakshme, konferenca ndërkombëtare për Kosovën”, Tiranë 1999*
45. Qosja Rexhep; *“Çështja shqiptare historia dhe politika” Tiranë 1998*
46. Qosja Rexhep; *“Populli i ndaluar” Prishtinë 1990*
47. Reka Blerim; *“Kosova në dokumentet e Kongresit Amerikan (1986-1995) Prishtinë 1995*
48. Reuter Jens; *“Shqiptarët në Jugosllavi” Tiranë 2003*
49. Ridgeëay James & Udovički Jasminka; *“Makthi etnik i Jugosllavisë” Albin 1998*
50. Rrullman Peter Hans; *“Ikje masive” Tiranë 1997*
51. Stavileci Esat, *Kosova dhe shqiptarët-ndërmjet kërcnimeve të brendshme dhe premtimeve të jashtme, Prishtinë, 1991*
52. Sulo Arifaj *“UÇK-ja në mes të përkrahjeve dhe pengesave” Prishtinë 2000*
53. Shala Xhavit, *“Ballkani, gjeopolitika dhe siguria”, Tiranë 2009*
54. Shala Blerim; *“Vitet e Kosovës 1998-1999” Prishtinë 2000*
55. Tahiri Edita; *“Konferenca e Rambujesë (procesi negociator dhe dokumentet)”, Pejë 2001*
56. Vinca Agim; *“Popull i pandalur”, Prishtinë 1992*
57. Vukaj Shaqir; *“Rusia dhe Kosova”, Tiranë 2007*
58. Ëalter Laker; *“Evropa në kohën tonë 1945-1992”, Tiranë 1996*
59. Ëeller Mark; *“Shtetësia e kontestuar” Prishtinë 2009*
60. Ëhite George Ë, *2000- Nationalism and Territory: Constructing Group Identity in Southeastern Europe, Lanham, MD, Roëman & Littlefield, 2000*
61. Xhemaili Mustafë, *Pubicistika Kryengritëse - 1980-2000, Prishtinë, 2010*
62. Xhemajli Emrush; *“Lëvizja Popullore e Kosovës-20 vjet veprimtari 1982-2002; Grafoprint, Prishtinë 200*

*Shtypi i Kohës;*

*Gazeta “Nova Makedonija” 1989*

*Revista “Koha”, Prishtinë, dhjetor, 1990*

*Gazeta “Flaka e vëllazërimit“ , 1991,*

*Gazeta “Demokracia autentike” Shkurt 1991*

*Gazeta “Rruga jonë” Lion Francë 1997*

*Revista ekskluzive “Dosja K” Prishtinë Janar 2001*

*Revista “Diplomacia” mars 2003, mars 2004*

*Gazeta Koha Ditore-fejton-Prill 2005*

*Gazeta “Koha” 27 mars 2007*

*Gazeta e përditshme- ‘Koha’; 2008*

*Gazeta Lajm 24. shkurt. 2012*

*<http://rks.gov.net/mpj>*